DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE• Nr. 431 • tetor 2026



Teknologjitë e reja dhe formësimi i qëndrimeve juridike islame

Edebi i marrëdhënies me prindërit

Fëmijët tanë po rriten nga prindërit apo nga ekranet?

DEKLARATË E MYFTIUT TË KOSOVËS ME RASTIN E VENDIMIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË



Të dashur vëllezër e motra,

Vendimi i sotëm i Dhomave të Specializuara të Tribunalit në Hagë është juridikisht i kontestueshëm, i ndikuar politikisht dhe, sipas vlerësimit tonë, në mospërputhje të plotë me standardet e një procesi të drejtë, të paanshëm dhe të barabartë ligjërisht.

Ky vendim, vlerësojmë se rrezikon të shërbejë si një mjet për relativizimin e krimeve të kryera nga Serbia në vendin tonë, krime këto që përbëjnë një kapitull të pashlyeshëm dhe të dokumentuar të historisë sonë të afërt.

As vendimi i sotëm, e asnjë vendim tjetër në të ardhmen, nuk mund ta tjetërsojë të drejtën tonë legjitime për të mbrojtur të vërtetën historike, dinjitetin e viktimave dhe epopenë e luftës sonë për liri dhe pavarësi, e as nuk mund ta zbehë sakrificën sublime të atyre që kontribuuan për çlirimin e Kosovës.

Të dashur qytetarë,

Në këto momente të rëndësishme, si çdo herë tjetër, ne qëndrojmë palëkundshëm në mbështetje të çlirimtarëve tanë. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të tregojnë pjekuri qytetare dhe përgjegjësi të lartë, të ruajnë qetësinë dhe dinjitetin, të jenë pranë çlirimtarëve dhe në krah të vlerave të luftës, dhe të kontribuojnë në forcimin, konsolidimin dhe funksionalizimin e shtetit tonë.

Beteja jonë për drejtësi dhe për mbrojtjen e dinjitetit dhe pafajësisë së çlirimtarëve tanë nuk përfundon këtu. Ne besojmë në pastërtinë e luftës sonë çlirimtare të prirë nga UÇK-ja, besojmë në kontributin dhe integritetin e prijësve dhe udhëheqësve të saj, si dhe në të drejtën e tyre për një proces gjyqësor të drejtë, objektiv, të paanshëm dhe në përputhje me standardet më të larta universale të drejtësisë.

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj!

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnava

Prishtinë, më 16 shtator 2026

Editorial

4 T'i ruajmë vlerat në botën që po ndryshon!
Editorial

Fetare

5 Koncepti kuranor i petkut dhe fenomeni i zhveshjes
Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi

9 Qetësia e zemrës në një botë të trazuar
Evzal Sinani

12 Teknologjitë e reja dhe formësimi i qëndrimeve juridike islame
Dr. Bashkim Aliu

15 Inteligjenca Artificiale dhe shkenca e Fikhut (Jurisprudencës):
Prof. dr. Abdullah Ibrahim Zejd el Kilani





19 Statusi i pasurisë dhe rregullat e trashëgimisë në Islam

Edukim dhe familje

22 Edebi i marrëdhënies me prindërit sipas "El Edeb el Mufred" të Imam Buhariut
Dr. Valon Myrta

28 Fëmijët tanë po rriten nga prindërit apo nga ekranet?
Nada Dosti

Edukim dhe shoqëri

31 Dija dhe karakteri në epokën e inteligjencës artificiale
Haki Sahitaj

34 Këshilla të sahabëve
Dr. Sedat Islami

37 Çfarë mësova nga jeta e Muhamedit a.s. dhe çfarë na mëson ajo sot?
Sadat Topanica

40 Misioni i imamëve dhe dialogu i tyre në revistën "Zani i Naltë" (1923-1928)
Haxhere Shabani

45 Rregullimi i së drejtës për lirinë e ndërgjegjes dhe fesë në Hungari
Ejup Ramadani

Histori dhe civilizim

48 Historia e pandarë shqiptare
Sadik Mehmeti & Ramadan Shkodra

54 Vështrim historik mbi kontributin e revistës "Dituria Islame" në historiografinë shqiptare
PhD cand. Agon Krasniqi

Aktualitet

57 Kriteret e paraqitjes së hoxhallarëve në emisionet televizive
Granit Sadiku

Reportazh

59 Drejt gjurmëve të dijes – studentët bursistë të BIK-ut në seminarin njëjavor në Turqi

Aktivitete

61 Myftiu Tërnava kërkoi nga Prokuroria Speciale zbardhjen e plotë të dokumentit të pretenduar si "Top Secret 2"

DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 431 • viti 40 • Tetor 2026
• Rabiul-Ahir / Xhumadel-Ula 1448
• Çmimi 2 €

Boton
Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia
Kryeredaktor: Dr. Ejup Haziri
Anëtarë:
dr. Bahri Hoxha,
dr. Florentina Tërmkolli,
dr. Muhamed Stublla,
dr. Violeta Smajlaj dhe
Almedin Ejupi.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa
"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë



T'i ruajmë vlerat në botën që po ndryshon!

Jetojmë në një kohë ku njerëzimi po ballafaqohet me ndryshime të mëdha e drastike. Zhvillimi teknologjik, inteligjenca artificiale dhe robotizimi po ndryshojnë jo vetëm sjelljen e njeriut, por edhe mënyrën e komunikimit dhe vetë jetën që bëjmë. Jemi të vetëdijshëm se çfarë mund të bëjë teknologjia, në çfarë niveli ka arritur dhe sa mund të avancojë tutje! Avancimi është i rëndësishëm, sepse njeriut ia lehtëson shumë gjëra dhe jetën ia bën më të lehtë. Përdorimi i teknologjisë, me theks të veçantë në inteligjencën artificiale, mund të lehtësojë shumë gjëra dhe të kryejë shumë punë, për çka meriton të përdoret në dobi dhe shërbim të njeriut. Mirëpo, krahas këtij zhvillimi e kësaj teknologjie të avancuar, çfarë po i ndodh njeriut? Përparimi teknologjik nuk nënkupton domosdoshmërisht përparim njerëzor e human. Nuk ka dyshim se, përmes avancimit teknologjik, njeriu bëhet më i fuqishëm në kontrollimin e botës, por ndoshta më i dobët në kontrollimin e vetvetes.

Rreziku nuk qëndron në faktin se inteligjenca dhe teknologjia janë të dëmshme për njeriun; përkundrazi, ato janë në dobi të njeriut, por rreziku qëndron pikërisht te mundësia që njeriu po ia delegon gjithnjë e më shumë aftësitë e veta teknologjisë. Ndërkaq, Islami e vendos njeriun në qendër të përgjegjësisë morale. Ai thotë: "Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)..." (El Isra, 70). Ky ajet na mëson se vlera e njeriut nuk matet vetëm me anën materiale, por edhe me atë shpirtërore. Vlera e njeriut matet me mëshirë, moral, ndërgjegje, dashuri dhe përgjegjësi. Përderisa ndërtojmë inteligjencë artificiale, të mos humbim inteligjencën e zemrës; ndërsa krijojmë teknologji që mendon, të mos lejojmë që ne të harrojmë të ndiejmë; ndërsa teknologjia na afron me botën, të mos largohemi nga Krijuesi dhe nga njëri-tjetri.

Sfida e kohës aktuale është të mbetemi njerëz të mirë, ta ruajmë anën humane të njerëzimit. Përderisa gjërat po bëhen përherë më të shpejta e më të avancuara, të mos lejojmë që mëshira e humaniteti të bëhen më të rralla. Në kohën kur reklamat na kanë shkallmuar, është e nevojshme që solidariteti të mos mbetet në harresë. Në këto kushte jashtëzakonisht të mira, do të duhej që të jemi në ndihmë të nevojtarit e të mos e humbim aftësinë për të bashkëndier dhimbjen e tjetrit, sepse kur ndiejmë dhimbjen e tjetrit, jemi më humanë, e kur ndihmojmë dikë që ka nevojë, jemi të njerëzishëm, dhe ndihma e Allahut do të jetë me ne në momentet më të vështira për ne, ashtu siç tha i Dërguari i Allahut: "Allahu është në ndihmë ndaj robit të Tij përderisa robi është në ndihmë të vëllait të tij." (Muslimi, 2699). Kur njeriu ia lehtëson barrën dikujt, Allahu ia lehtëson atij rrugën; kur i gjendet pranë nevojtarit, edhe ai nuk mbetet pa përkrahje. Kur dora jonë ngrihet për ta ndihmuar dikë, ne përkrahim jo vetëm jetën e tij, por ngjallim edhe humanizmin e shoqërisë sonë.

Islami e ndërton shoqërinë mbi norma që nuk mund të zëvendësohen nga asnjë algoritëm: mëshirën, drejtësinë, besnikërinë, respektin, faljen, solidaritetin dhe përgjegjësinë ndaj tjetrit. I Dërguari i Allahut e përshkroi marrëdhënien ndërmjet besimtarëve me fjalët: "Besimtari për besimtarin është sikurse ndërtesa, pjesët e së cilës e forcojnë njëra-tjetrën."

Ruajtja e vlerave nuk do të thotë kthim prapa, refuzim i dijes apo frikë nga teknologjia. Teknologjia mund të përshpejtojë një proces, por nuk mund t'i japë atij kuptim moral. Zhvillimi duhet të ecë bashkë me edukimin e karakterit. Kurani e lidh suksesin njerëzor me pastrimin e shpirtit: *"Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten."* (Esh Shems, 9). Sa më shumë të rritet fuqia e njeriut, aq më e madhe duhet të bëhet edhe përgjegjësia e tij.

Islami nuk e vendos njeriun përballë zhvillimit si kundërshtar të tij, por i kërkon atij që dijen, fuqinë dhe mundësitë që i janë dhënë t'i përdorë me përgjegjësi të plotë. *"...e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë... dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty..."* (El Kasas, 77). Kështu, zhvillimi material dhe përgjegjësia shpirtërore nuk duhet të jenë në konflikt. Njeriu mund të ndërtojë, të zbulojë, të shpikë dhe të përparojë, por duhet të kujtojë gjithmonë se dija pa devotshmëri, fuqia pa drejtësi dhe përparimi pa moral nuk e bëjnë domosdoshmërisht njeriun më të mirë.

Nëse teknologjia na jep mundësi dhe fuqi më të madhe, atëherë duhet të kemi edhe vetëpërmbajtje, por edhe përgjegjësi më të madhe; nëse na afron me botën, duhet të kujdesemi që të mos na largojë nga familja e të mos i harrojmë fqinjët, shoqërinë dhe as vetveten. Kjo është beteja e vërtetë e kohës sonë. Dhe kjo është arsyeja pse, në një botë që po ndryshon me shpejtësi, duhet t'i ruajmë vlerat tona – të ruajmë vetveten e familjen, të ruajmë mëshirën, moralin dhe të ruajmë lidhjen me Allahun.

Sepse teknologjia mund të na tregojë se si të jetojmë më lehtë; vetëm besimi dhe morali mund të na mësojnë pse duhet të jetojmë mirë.

Dr. Ejup Haziri



Koncepti kuranor i petkut dhe fenomeni i zhveshjes

Prof. ass. dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Në këndvështrimin kuranor, veshja nuk është vetëm mbulim i trupit, por shprehje e dinjitetit, privatësisë dhe përgjegjësisë morale. Përballë kulturës bashkëkohore të ekspozimit, petku rikthen lidhjen mes modestisë së jashtme dhe devotshmërisë së brendshme. Ai bëhet kështu pjesë e një etike që mbron njeriun në tërësinë e tij.

Një nga fenomenet që e shoqëron historinë e njerëzimit që nga zanafilla e tij dhe ka marrë kuptime të ndryshme në dimensionet antropologjike, etike dhe fetare është kultura e të veshurit dhe fenomeni i zhveshjes. Tregimi kuranor mbi Ademin a.s. dhe Havën,[1] dëshmon se zhveshja nuk paraqet vetëm një gjendje fizike, por lidhet edhe me vetëdijen morale, psikologjike dhe shpirtërore të njeriut. Ky rrëfim tregon se prirja për t'u mbuluar është pjesë e natyrës njerëzore dhe shfaqet paralelisht me ndërgjegjen e njeriut për dinjitetin, turpin dhe përgjegjësinë e tij morale. Në këtë kuptim, mbulimi nuk përfaqëson thjesht një nevojë materiale, por shpreh respektin ndaj privatësisë dhe integritetit të individit, ndërsa zhveshja nënkupton ekspozimin e asaj që në thelb kërkon mbrojtje dhe ruajtje.

Gjatë historisë, qytetërime të ndryshme kanë zhvilluar koncepte dhe norma të ndryshme lidhur me ekspozimin e trupit dhe veshjen. Në Greqinë e Lashtë, zhveshja lidhej kryesisht me idealin estetik dhe përsosmërinë trupore, ndërsa në traditat fetare dhe kulturore indiane, kineze, hebraike dhe të krishtera, veshja dhe mbulimi fituan kryesisht kuptime fetare, simbolike dhe morale.[2] Në këtë panoramë, Islami ofron një qasje gjithëpërfshirëse, duke e trajtuar veshjen jo vetëm si një nevojë fizike, por edhe si një obligim etik dhe fetar. Kurani paraqet petkun si një element të dinjitetit njerëzor dhe e lidh atë ngushtë me vetëdijen për devotshmërinë (takvasë).[3]

Ndërsa në shoqërinë bashkëkohore, ky dimension etik dhe shpirtëror i veshjes është zbehur ndjeshëm. Zhvillimet kulturore dhe ekonomike të epokës moderne, veçanërisht pas revolucionit industrial, kanë ndikuar në transformimin e perceptimit mbi trupin e njeriut, duke e shndërruar atë gjithnjë e më shumë në objekt konsumi dhe ekspozimi publik. Industria e modës, reklamat, rrjetet sociale, kinematografia dhe format e tjera të kulturës vizuale kanë kontribuar në promovimin e zhveshjes si simbol i lirisë individuale, identitetit personal dhe suksesit estetik. Në këtë kontekst, trupi njerëzor shpesh është reduktuar në një instrument të konsumit dhe marketingut, duke e larguar debatin nga dimensioni etik dhe duke e orientuar atë drejt një qasjeje kryesisht komerciale. Në këtë kontekst, trupi i gruas shpesh është trajtuar si objekt estetik dhe ekspozimi, ndërsa trupi i burrit është identifikuar me simbole të forcës dhe pushtetit. Edhe pse këto prirje paraqiten si shprehje e lirisë individuale, ato lidhen ngushtë me mekanizmat e kulturës konsumuese dhe të ekonomisë globale, të cilat e shndërrojnë trupin njerëzor në një mjet marketingu dhe konsumimi. Si pasojë, dimensioni etik dhe shpirtëror i njeriut zbehet gradualisht, ndërsa cenohen vlera themelore si dinjiteti njerëzor, privatësia dhe përgjegjësia morale, duke ndikuar njëkohësisht në dobësimin e normave dhe të kohezionit shoqëror.

> Kurani paraqet petkun si një element të dinjitetit njerëzor dhe e lidh atë ngushtë me vetëdijen për devotshmërinë (takvasë).

KONCEPTI I ZHVESHJES SË TRUPIT NË KURAN

Në Kuran, zhveshja trajtohet kryesisht në kontekstin e zbulimit të pjesëve të turpshme (*sev'e*), të humbjes së mbulimit dhe të lidhjes së kësaj gjendjeje me pasojat e mëkatit. Në këtë kuadër, Kurani përdor edhe termin *teberruxh*, i cili rrjedh nga fjala *burxh*, që nënkupton diçka të lartë, të dukshme dhe të ekspozuar. Në aspektin terminologjik, *teberruxhi* shpreh shfaqjen e qëllimshme të bukurisë dhe stolive në mënyrë që të tërheqë vëmendjen e të tjerëve.[4] Ky koncept përmendet drejtpërdrejt në ajetin kuranor në të cilin thuhet: *"E mos shfaqni bukurinë tuaj, si shfaqej në injorancën e hershme."* (El Ahzab, 33). Në këtë kontekst, *teberruxhi* i referohet ekspozimit të zbukurimeve dhe hijeshisë para personave të huaj, duke tejkaluar kufijtë e privatësisë dhe të normave të modestisë. Për këtë arsye, në terminologjinë kuranore ky

koncept lidhet ngushtë edhe me nocionin e ekspozimit publik (*teshhir*), pasi të dyja shprehin nxjerrjen në pah të asaj që duhet të ruhet brenda kufijve të privatësisë dhe dinjitetit njerëzor.

Në Kuran, çështja e zhveshjes nuk paraqitet thjesht si një gjendje fizike e trupit, por lidhet ngushtë me konceptet e privatësisë, dinjitetit njerëzor, përgjegjësisë morale dhe pozitës ontologjike të njeriut. Tregimi i parë që e trajton këtë fenomen gjendet në historinë e Ademit a.s. dhe Havës, të cilët, sa ishin në Xhenet, u sprovuan përmes ndalimit të një peme të caktuar. Ngjarja përshkruhet në ajetet 20–22 të kaptinës Araf, ku thuhet: *"Shejtani i nxiti ata të dy (i mashtroi), që t'ua zbulojë atyre pjesët e turpshme, që ju ishin të mbuluara dhe tha: "Zoti juaj nuk ua ndaloi juve të dyve atë pemë vetëm që të mos bëheni melaqe, ose të mos bëheni prej të përjetshmëve. Dhe ju betua atyre (duke iu thënë) se: Unë jam këshillues për ju. Atëherë me mashtrim i zbriti (në një nivel të pa lakmueshëm). E kur e shijuan pemën u zbulua vendturpi i tyre dhe filluan ta mbulojnë atë (duke vënë gjeth mbi gjeth) nga gjethet e (pemëve të) xhenetit. Zoti i tyre i thirri (duke iu thënë): "A nuk ua ndalova ju të dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë ju të dyve, se shejtani është armik i hapët për ju?"* (El Araf, 20-22).

Në literaturën e tefsirit, termi *sev'e* i përmendur në ajet interpretohet jo vetëm si emërtim i pjesëve të trupit që duhen mbuluar, por edhe si simbol i cenueshmërisë dhe papërsosmërisë ontologjike të njeriut.[5] Në këtë këndvështrim, ajetet kuranore dëshmojnë se ndërgjegjësimi për privatësinë dhe nevoja për mbulim janë pjesë përbërëse e natyrës njerëzore. Reagimi i Ademit a.s. dhe Havës për t'i mbuluar menjëherë pjesët e zbuluara të trupit me



gjethet e Xhenetit nuk nënkupton vetëm një përpjekje për fshehje, por edhe manifestim të prirjes së lindur të njeriut për të ruajtur dinjitetin dhe privatësinë e tij. Nga kjo perspektivë, zhveshja nuk paraqitet si një gjendje e natyrshme apo e dëshirueshme, por si pasojë e një devijimi nga urdhri hyjnor. Për rrjedhojë, ky tregim përbën një nga bazat themelore të konceptit kuranor mbi turpin, duke dëshmuar se vetëdija për mbulimin dhe ruajtjen e privatësisë është e rrënjosur në vetë natyrën (fitren) e njeriut. Në këtë kontekst, Zoti në Kuranin fisnik thotë: *"O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk, që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues. Po petku i devotshmërisë ai është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, ashtu që ata të përkujtojnë."* (El Araf, 26). Ky ajet i atribuon veshjes një funksion të dyfishtë: nga njëra anë, ajo shërben për mbulimin dhe mbrojtjen fizike të trupit, ndërsa nga ana tjetër simbolizon devotshmërinë (takvanë), e cila përfaqëson mbrojtjen shpirtërore dhe morale të njeriut. Në këtë kuptim, veshja tejkalon funksionin e saj material dhe shndërrohet në një simbol të vetëdijes etike dhe të përgjegjësisë fetare. Mbulimi i trupit përfaqëson dimensionin e jashtëm të modestisë, ndërsa *veshja e takvasë* pasqyron dimensionin e brendshëm të saj, duke dëshmuar se vlera e vërtetë e njeriut nuk qëndron vetëm në paraqitjen e jashtme, por edhe në moralin dhe devotshmërinë e tij. Për këtë arsye, në perspektivën kuranore, mbulimi nuk reduktohet në një kod veshjeje, por paraqet një shprehje të ndërgjegjes fetare dhe të respektit ndaj Allahut të Madhërishëm.

Në të njëjtën kohë, koncepti kuranor i petkut ka edhe një funksion të rëndësishëm individual dhe shoqëror. Ai synon ruajtjen e dinjitetit dhe të privatësisë së individit, promovimin e modestisë në marrëdhëniet ndërpersonale dhe mbrojtjen e rendit moral të shoqërisë. Kjo përgjegjësi nuk kufizohet vetëm te gruaja, por u drejtohet njësoj edhe burrave, të cilët Kurani i urdhëron të ulin shikimin dhe të ruajnë dëlirësinë e tyre.6 Në këtë mënyrë, petku paraqitet si pjesë e një sistemi më të gjerë etik, i cili synon të kultivojë përgjegjësi reciproke, të mbrojë dinjitetin njerëzor dhe të pengojë çdo formë të objektivizimit dhe instrumentalizimit të trupit njerëzor.

PETKU SI ALTERNATIVË KURANORE NDAJ ZHVESHJES SË TRUPIT

Në Kuran, petku nuk përfaqëson vetëm një element të paraqitjes së jashtme, por mishëron një sistem vlerash që lidhet me dëlirësinë, mbrojtjen e privatësisë, identitetin fetar dhe kultivimin e takvasë. Ai paraqitet si pjesë e një sistemi të gjerë normash morale që u drejtohen njësoj burrave dhe grave dhe që dëshmon se përgjegjësia për ruajtjen e moralit dhe të dëlirësisë nuk i ngarkohet vetëm njërës gjini, por konsiderohet një detyrim i përbashkët i të dyja palëve. Në këtë kuadër, Kurani fillimisht u drejtohet burrave besimtarë me fjalët: "*Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ata. Allahu është i Njohur hollësisht për atë që bëjnë ata."*(Nur, 30). Në këtë ajet, urdhri për



"ndalimin e shikimit" nënkupton shmangien e shikimeve që cenojnë moralin dhe privatësinë e të tjerëve, ndërsa urdhri për "ruajtjen e pjesëve të turpshme" nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen e organeve intime, por përfshin në përgjithësi ruajtjen e pastërtisë morale dhe largimin nga çdo sjellje që bie ndesh me normat etike islame. Më pas, i njëjti urdhër u drejtohet edhe grave besimtare: *"Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre."*(Nur, 31). Ky ajet përmban elementet themelore të etikës islame të mbulimit. Sipas interpretuesve të Kuranit, termi *"humur"* i përmendur në ajet i referohet mbulesës së kokës, ndërsa shprehja *"le të venë shamitë mbi kraharorin e tyre"* tregon se mbulimi duhet të përfshijë jo vetëm kokën, por edhe qafën dhe pjesën e kraharorit. Folja *"jadribne"* shpreh veprimin e vendosjes së kujdesshme dhe të plotë të mbulesës, duke nënvizuar karakterin e vetëdijshëm të këtij urdhri.7 Nisur nga kjo, ajetet kuranore që trajtojnë uljen e shikimit dhe petkun nuk vendosin thjesht detyrime individuale për burrat dhe gratë, por synojnë ndërtimin e një vetëdijeje kolektive mbi dëlirësinë, modestinë dhe respektimin e privatësisë. Në këtë kuadër, petku i gruas nuk nënkupton kufizim të rolit të saj shoqëror, por mekanizëm për ruajtjen e dinjitetit dhe integritetit të saj personal.

> "Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ata. Allahu është i Njohur hollësisht për atë që bëjnë ata."(Nur, 30).

Gjatë historisë islame, shumë gra kontribuuan në fushën e dijes, arsimit dhe arkitekturës, ndërsa mbulimi u konsiderua pjesë e dinjitetit dhe identitetit të tyre shoqëror. Në këtë kontekst, ai u kuptua si një element që mbronte personalitetin dhe reputacionin e gruas në hapësirën publike, e jo si një kufizim i rolit të saj. Edhe zgjedhja e materialeve cilësore dhe estetike për veshje pasqyronte këtë qasje, ku eleganca harmonizohej me modestinë. Për këtë arsye, në Islam u kultivua më shumë koncepti i "elegancës së dëlirë" sesa ai i modës së bazuar në ekspozim, ndërsa zbukurimet u rezervuan kryesisht për ambientin familjar, kurse veshja publike ruante karakterin e saj të thjeshtë dhe modest. Njëkohësisht, urdhri drejtuar burrave për uljen e shikimit dhe ruajtjen e dëlirësisë dëshmon se përgjegjësia morale është reciproke dhe se mbrojtja e vlerave etike nuk mbështetet vetëm mbi njërën gjini. Për rrjedhojë, në perspektivën kuranore, petku përfaqëson shprehjen e një vetëdijeje morale dhe fetare, e cila synon të mbrojë dinjitetin e individit, të forcojë përgjegjësinë e ndërsjellë ndërmjet burrit dhe gruas dhe të kontribuojë në ruajtjen e rendit etik dhe të harmonisë shoqërore.

PETKU NDËRMJET SFIDAVE BASHKËKOHORE, IDENTITETIT FETAR DHE EDUKIMIT MORAL

Në kushtet e globalizmit dhe të transformimeve të shpejta kulturore, të rinjtë myslimanë, veçanërisht femrat, përballen me sfida të shumta në ndërtimin dhe ruajtjen e identitetit të tyre fetar. Nga njëra anë, zgjedhja për të mbajtur mbulesën fetare shpesh shoqërohet me perceptime stereotipike, stigmatizim dhe presione që e lidhin atë me prapambetjen ose kufizimin e rolit shoqëror të gruas. Nga ana tjetër, ekspozimi i trupit dhe përshtatja me modelet dominuese të kulturës vizuale paraqiten si standarde të pranimit dhe të integrimit shoqëror. Njëkohësisht, zhvillimi i industrisë së modës dhe i mediave sociale ka ndikuar në ndryshimin e perceptimit mbi petkun islam. Në shumë raste, mbulesa nuk paraqitet më vetëm si shprehje e devotshmërisë dhe e identitetit fetar, por edhe si element i modës, i imazhit publik dhe i konsumit kulturor. Kjo prirje ka krijuar një debat mbi raportin ndërmjet dimensionit fetar të mbulimit dhe paraqitjes



së tij estetike në hapësirën publike. Në veçanti, prania e figurave publike dhe influencuesve në rrjetet sociale ka bërë që, në disa raste, mbulesa të shoqërohet me procese të komercializmit dhe të ndërtimit të markës personale, duke e zhvendosur vëmendjen nga funksioni i saj fillestar etik dhe shpirtëror. Megjithatë, ndikimet e kulturës digjitale nuk kufizohen vetëm me gjininë femërore. Edhe te djemtë e rinj vërehen ndryshime në mënyrën e ndërtimit të marrëdhënieve ndërpersonale, ku përdorimi i rrjeteve sociale dhe formave të reja të komunikimit ka transformuar kufijtë tradicionalë të privatësisë dhe të etikës së ndërveprimit.[8] Këto zhvillime kanë nxitur diskutime të reja mbi mënyrën e ruajtjes së parimeve islame të modestisë, dëlirësisë dhe përgjegjësisë morale në shoqërinë bashkëkohore. Pikërisht në këtë kontekst bëhet e qartë se koncepti islam i petkut nuk mund të kuptohet vetëm si një çështje e veshjes së jashtme, por duhet të shihet si pjesë e një sistemi më të gjerë vlerash morale dhe shpirtërore, i cili synon të orientojë sjelljen e besimtarit në të gjitha dimensionet e jetës.

Në këtë perspektivë, në Islam mbulimi (petku) përfaqëson një qëndrim etik dhe një vetëdije shpirtërore që mbështetet mbi parimin e *"hajasë"* (turpit). Këtë e dëshmon edhe hadithi i Pejgamberit a.s., i cili thotë: "Çdo fe ka moralin e saj, ndërsa morali i Islamit është "haja'ja" (turpi)."9 Në këtë kuptim, "haja" nuk nënkupton vetëm ndjenjën e turpit, por përfaqëson një virtyt që rregullon marrëdhënien e njeriut me Krijuesin, me vetveten dhe me shoqërinë. Turpi në Islam nuk kufizohet vetëm në rregullat e veshjes, por përfshin edhe formimin e personalitetit në tërësinë e tij. Si rrjedhojë, ai lidhet me edukimin e shikimit, të të folurit, të qëllimeve dhe të sjelljes, duke ndërtuar një kulturë të përgjegjësisë morale në të gjitha dimensionet e jetës. Për këtë arsye, edukimi mbi privatësinë, dëlirësinë dhe etikën e marrëdhënieve ndërpersonale duhet të fillojë që në moshë të hershme dhe t'u drejtohet në mënyrë të barabartë si djemve, ashtu edhe vajzave. Dëlirësia (*ʿiffe*) nuk përbën një virtyt të lidhur me një gjini të caktuar, por një vlerë universale, e cila synon të kultivojë dinjitetin, përgjegjësinë dhe integritetin moral të çdo individi. Formimi i kësaj vetëdijeje nuk realizohet në mënyrë spontane, por është rezultat i një edukimi të vazhdueshëm që fillon në familje, si mjedisi i parë ku ndërtohen personaliteti dhe orientimi moral i individit. Në këtë proces, familja, e veçanërisht nëna, luan një rol themelor në transmetimin e normave fetare dhe etike. Kurani i ngarkon prindërit[10] me përgjegjësinë e edukimit të brezave mbi vlerat e shpalljes hyjnore, duke i orientuar ata drejt ruajtjes së dinjitetit dhe të moralit. Në këtë kuadër, edukimi mbi mbulimin nuk kufizohet në mësimin e rregullave që lidhen me veshjen, por synon të kultivojë bindjen ndaj urdhrit hyjnor, respektin për dinjitetin njerëzor dhe ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe shoqërisë. Në këtë mënyrë, petku shndërrohet në një reflektim të bindjes fetare dhe të formimit etik të individit.

Si rrjedhojë, në mësimet kuranore, petku paraqitet si një shprehje e natyrës së pastër njerëzore (*fitre*) dhe e përgjegjësisë etike që rregullon marrëdhënien e njeriut me Allahun, me vetveten dhe me shoqërinë. Ndërsa zhveshja nuk konceptohet vetëm si mungesë e veshjes, por si një gjendje që cenon privatësinë, dinjitetin dhe ekuilibrin moral të individit. Në këtë mënyrë, Kurani ofron një qasje të ekuilibruar ndaj trupit njerëzor, duke refuzuar si objektivizimin, ashtu edhe idealizimin e tij, dhe duke e integruar dimensionin fizik me atë moral e shpirtëror. Në këtë kontekst, nocioni *libasu't takva* "petku (veshja) e devotshmërisë" dëshmon se mbulimi tejkalon dimensionin e tij material dhe shndërrohet në simbol të besimit, bindjes ndaj Allahut Fuqiplotë dhe përgjegjësisë morale. Si i tillë, ai paraqitet si një mekanizëm që mbron jo vetëm trupin, por edhe integritetin shpirtëror të njeriut, duke pasqyruar në jetën praktike marrëdhënien e tij me Krijuesin dhe me vlerat që promovon shpallja hyjnore.

1 Taha, 121.
2 Ferhat Tekin, "Bedenin Teşhiri", 134-138.
3 El Araf, 26.
4 El Hemiri, Shemsu'l'ulum, 1/507.
5 El Maverdi, En Nuket ve'l'ujun, 2/211
6 Nur, 30–31.
7 El Maturidi, Te'vilatu ehli's Sunne, 7/544.
8 Murtaz Mutahhari, Meseletu'l hixhab, 71-72.
9 Ibën Maxhe, Sunen ibën Maxhe, "Zuhd", 17.
10 Tahrim, 6.



Qetësia e zemrës në një botë të trazuar

Evzal Sinani

Brenda njeriut zhvillohet një ndërveprim i vazhdueshëm mes mendjes, zemrës, nefsit dhe shpirtit. Zemra qëndron në qendër të vullnetit dhe orientimit moral, ndërsa qetësia e saj ndikon në mënyrën se si njeriu mendon, zgjedh dhe vepron. Prandaj, ruajtja e zemrës së qetë është një nga sfidat themelore të jetës shpirtërore.

ÇFARË NDODH BRENDA NJERIUT?!

Krijesa njeri është një qenie e jashtëzakonshme, komplekse dhe e mrekullueshme. Megjithatë, rrallëherë na ndodh të ndalojmë dhe të mundohemi të shohim përtej asaj që shihet, të kërkojmë të zbulojmë edhe atë që nuk duket, por është aty. Përqendrimi në dimensionin material të qenies sonë, i nxitur nga forca e përditshmërisë që detyrimisht përthith të madhin e të voglin, bën që zbulesa jonë e vetes të qëndrojë në prapavijë dhe të neglizhojmë dimensionet e tjera themelore të qenies sonë, prezencën e të cilave doemos e has secili në periudha të dhëna të jetës së tij.

Aspekti ynë material i përfaqësuar nga trupi dhe gjymtyrët përfaqëson vetëm mjetin ekzekutiv material. Detyra e trupit tonë, që ne shpeshherë e marrim si absolut dhe dominant, është thjesht zbatuese dhe i nënshtrohet urdhrave të qendrës së komandës. Lidhjen vertikale të trupit dhe gjithë qenies njeri e përfaqëson shpirti (*el ruuh*). Detyra e tij është të kërkojë përjetësinë dhe të adhurojë e të lartësojë të shenjtën. Ushqehet vetëm me punët që e afrojnë kah Krijuesi Fuqiplotë dhe mbetet i shqetësuar derisa të kthehet tek Ai. Vatra e nevojave tona biologjike, impulseve bazike, mbijetesës tokësore dhe epsheve përfaqësohet nga nefsi. Roli i tij natyror është të shtyjë njeriun të kërkojë shkaqet që ruajnë jetën dhe vazhdimësinë e saj, por në formën e tij të pagdhendur kërkon plotësimin e dëshirave në çast dhe pa pyetur për kufijtë moralë apo pasojat.

Por njeriu brenda tij ka edhe dy komponentë themelorë, funksionet e të cilëve mbeten të mjegullta për shumicën prej nesh. Debati rreth funksioneve të secilit nga këto dy dimensione, i ndihmuar nga zbulimet shkencore, duket sikur zbehet dhe qartësohet dilema enigmatike: Kush është kryesori brenda nesh, kush është ai që merr vendimet, mendja apo zemra?

Mendja kryen perceptimin, njohjen, analizën e të dhënave dhe dallimin e së mirës nga e keqja, e të vërtetës nga e pavërteta, e të dobishmes nga e dëmshmja. Llogarit pasojat, ka aftësinë ta kuptojë përgjegjësinë dhe shërben si kusht themelor i ngarkimit me përgjegjësi fetare. Ajo ndriçon rrugën, por nuk ka në dorë fuqinë e vullnetit, e as të zbatimit me forcë. Mund t'i vishet përgjegjësia operacionale, por jo llogaria morale. Po të ishte mendja vendimmarrëse, njeriu që kupton dëmin e shumë prej veprimeve të tij, do të zgjidhte t'i shmangte ato, sepse analiza e saktë logjike sjell përfundimin se janë të dëmshme dhe nuk duhet vepruar, por jo, megjithatë ai kryen sa e sa veprime që i ka perceptuar saktë paraprakisht nëpërmjet mendjes se i bënë keq, janë të dëmshme dhe sjellin pasoja negative. Kjo e sjell mendjen te roli i vërtetë – të qenit këshilltare e vendimmarrësit: zemrës. "Copa e mishit" që po qe e mirë dhe e shëndoshë, është e shëndoshë gjithë qenia.[1]

Mendja kryen perceptimin, njohjen, analizën e të dhënave dhe dallimin e së mirës nga e keqja, e të vërtetës nga e pavërteta, e të dobishmes nga e dëmshmja. Llogarit pasojat, ka aftësinë ta kuptojë përgjegjësinë dhe shërben si kusht themelor i ngarkimit me përgjegjësi fetare.

Zemra është kryesorja e këtij sistemi dhe qendra e vetme e vullnetit, qëllimit (nijetit) dhe vendimmarrjes përfundimtare nga dimensionet e qenies njeri. Ajo mban përgjegjësinë morale para Zotit, është vatra e imanit dhe devotshmërisë. Në të gjenden ndjenjat dhe emocionet. Ajo peshon këshillën e mendjes përballë kërkesave të nefsit dhe jep urdhrin përfundimtar për veprim, që detyrimisht e ndjekin gjymtyrët. *"Vërtet, nuk janë sytë ata që verbohen, por verbohen zemrat që janë në kraharorë!"* (El Haxh, 46). Allahu f.p. në këtë ajet, përveçse sjell dëshmi se zemra është qendra e dallimit moral, perceptimit të thellë dhe vendimmarrjes së lirë, me përcaktimin "që janë në kraharorë" heq çdo dyshim se mund të bëhet fjalë për ndonjë metaforë abstrakte apo për figurë letrare.[2]

Zbulimi i "trurit të zemrës"3 vërteton këtë qëndrim nga aspekti shkencor, por edhe ndihmon në të kuptuarit e mëtejshëm të

ndërlidhjes së funksioneve të komponentëve të njeriut të ndërthurura në ajete kuranore, si kur thuhet: *"A nuk udhëtuan ata nëpër tokë, që të kenë zemra me të cilat të arsyetojnë..."* (El Haxh, 46). Në dritën e kësaj analize, fjala *"arsyetojnë"* (*ja'kiluun* prej *akl –mendje*) nuk tregon se zemra kryen operacione algjebrike, por se ajo është qendra që jep impulsin fillestar, vendos peshën e vlerave dhe dikton drejtimin e ndërgjegjes. Lobi frontal (*en nasijeh*) është instrumenti analitik që skanon dhe përpilon variantet, por ai vendos gjithnjë nën ndikimin e kodit neuroelektrik dhe shpirtëror që i vjen nga themeli: nga vetë zemra.[4,5] Modelet e ritmit kardiak ndryshojnë dhe dërgojnë impulse në tru disa çaste para se lobi frontal të arrijë ta formulojë mendimin logjik. Kur zemra është e trazuar, sinjalet elektrike që ajo i dërgon lobit frontal bëhen kaotike. Si pasojë, lobi frontal bllokohet në funksionet e tij më të larta: aftësia analitike bie, kontrolli i impulseve dobësohet dhe njeriu merr vendime miope. Dobësimi i zemrës sjell dobësimin e fuqisë së mendjes, që eventualisht sjell edhe ekzekutimin e një veprimi të gabuar nga trupi.

ZEMRA E PREHUR NËN BRESHËRINË E KAOSIT – NEVOJA E ZEMRËS SË QETË NË JETË

Qëllimi kryesor i myslimanit të kthjelltë, duke njohur natyrën e brishtë të zemrës që përshkruhet nga vetë etimologjia e saj, atë të rrotullimit dhe ndryshimit të gjendjeve të saj, është të arrijë të mbajë zemrën në prehje, të qetë, për të mundur të realizojë ndërthurjen e përkryer të vendimmarrjes me analizën e ftohtë logjike, që zemra t'i dërgojë lobit frontal sinjale të pastra, harmonike dhe ndërtuese. Allahu f.p. në Kuranin famëlartë, këtë qetësi e quan *"itmi'nan"*.

Sfida për të qetësuar zemrën dhe për të arritur prehjen që do të ndërthurte përsosmërisht qenien tonë ka qenë reale edhe brenda vetë njerëzve më të mëdhenj të njerëzimit. Në ballafaqimin me kaosin e jashtëm të rrethit ku kanë jetuar, ata kanë pasur nevojë të qetësojnë zemrën për të mundur të vazhdojnë rrugëtimin pa prishur gjykimin dhe perceptimin.

Babai i të zgjedhurve të Zotit, Ibrahimi a.s., iu lut Allahut f.p. t'i tregojë si ngjallen të vdekurit, me qëllim të qetësojë zemrën e tij dhe ta kthjellojë analizën e tij logjike që i duhej në shumë raste dhe për të cilën mprehtësi ende shërben si shembull me polemizimet e tij me të zotët e së kotës, si rasti me adhuruesit e idhujve pasi theu putat, ai me tiranin Nemrud, apo tjetri me mbretin zullumqar të Egjiptit, po edhe në analizat e tij vetjake. Të njëjtën sfidë patën nevojë ta tejkalojnë me dëshminë e një mrekullie edhe shokët e Isait a.s. me tryezën, po edhe shokët e imamit të pejgamberëve, Muhamedit a.s., dëshmuan ndihmën e dërgimit të engjëjve në Bedër si myzhde dhe si prehje zemrash, me qëllim që ankthi dhe frika të mos paralizonin perceptimin e tyre logjik të situatës.

> Kaosi i rrethit dhe botës ku jetojmë krijon kaos edhe vetë brenda qenies njeri dhe kjo botë e brendshme e trazuar ka po ashtu nevojë të qetësohet për të qenë njeriu efektiv.



Kaosi i rrethit dhe botës ku jetojmë krijon kaos edhe vetë brenda qenies njeri dhe kjo botë e brendshme e trazuar ka po ashtu nevojë të qetësohet për të qenë njeriu efektiv. Suneti e ka vendosur zemrën si barometër të qetësisë përballë mëkatit. "Edhe nëse njerëzit të japin fetva e fetva, ti pyete zemrën tënde!" – kështu i udhëzonte Muhamedi a.s. shokët e tij, duke i mësuar se "mirësi është ajo me të cilën qetësohet shpirti dhe gjen qetësi zemra, ndërsa gjynahu është ai që të ngjall dyshime, të bren në shpirt dhe ngurron në kraharor."[6]

Megjithatë, realiteti është se kjo qetësi nuk është e lehtë për t'u arritur, po edhe kur arrihet, nuk është e lehtë të mbahet. Myslimani, para se të arrijë tek ajo, duhet t'i anashkalojë pengesat që gjenden rrugës, prishësit e qetësisë që janë të ndryshëm nga natyra, por jo nga qëllimi.

PRISHËSIT E QETËSISË

Relativizimi i absolutes dhe absolutizimi i relatives

Pengesa e parë në rrugën e arritjes së prehjes së zemrës lidhet me konceptin e realitetit të rrethit në të cilin jeton individi. Interaksioni i përditshëm i njeriut me botën materiale që e rrethon e bën atë të krijojë përshtypjen e gabuar të absolutizmit të botës së krijuar. Ky iluzion i rëndë optik dhe shpirtëror e bën të zotin të neglizhojë atributet vepruese të Allahut f.p., pasojë e të cilave ekziston dynjaja. Relativizimi i shkakut dhe absolutizimi i pasojës krijon te njeriu këtë iluzion fatal që krijon perde mes tij dhe realitetit dhe e bën zemrën të dashurohet pas gjërave materiale. Materia ndryshon, plaket, kalbet apo zhduket dhe një zemër e ankoruar në detin e materies së përkohshme përjeton tmerr ekzistencial sa herë që shkëputet nga diçka me të cilën ka qenë e lidhur dhe, kësisoj, nuk e arrin dot *itmi'nanin.*

Dëshira për t'u dukur dhe vetëpëlqimi

Është shumë e rëndësishme që myslimani me veprat e tij të ketë synim Allahun Fuqiplotë.

Madje, çdo vepër që nuk synon kënaqësinë e Tij është pluhur e hi, e pavlerë dhe, në vend të dobisë, i bën dëm vepruesit. E kundërta e sinqeritetit është syefaqësia dhe, ashtu siç sinqeriteti sjell prehje në zemër, syefaqësia i sjell zemrës parehati dhe shqetësime. Etja për t'u dukur, nderuar e lëvduar nga njerëzit e lë zemrën në varësi e ankth të pandërprerë nga gjykimi i të tjerëve.

Ka të atillë që veprojnë me mungesë sinqeriteti, por në thellësi e dinë qartë se qëllimi i tyre është rijaja. Por ka një grup tjetër që janë të bindur se ajo që e bëjnë ata është gjithmonë e drejta dhe se janë të dalluar mbi të tjerët. Këta janë të vetëpëlqyerit. Mashtrimi tinëzar i vetes, duke u ndjerë më i mirë se të tjerët për shkak të devotshmërisë; kjo cilësi e helmon menjëherë paqen e brendshme.[7]

Iluzioni i kontrollit vetjak

Krijuesi ynë bujar na ka ndarë veprat në dy lloje. Ato në të cilat ne kemi të drejtë zgjedhjeje dhe bartim pasojat e vendimeve tona dhe ato në të cilat nuk bartim pasoja, për shkak se nuk kemi të drejtë zgjedhjeje. Nisur nga kjo ndarje e thjeshtë dhe shumë e qartë, njeriu do të duhej të mos lodhej me punët që nuk i ka në dorë dhe të fokusohej në ato në të cilat ka mundësi të bëjë dallimin dhe për pasojat e të cilave do të merret në llogari. Problemi fillon kur njeriu, që është i programuar vetëm për një set të veprave, tenton të ndërhyjë në të tjerat, për të cilat nuk është i konfiguruar. Krijon te vetja iluzionin se është duke bërë planifikimin e rrugës së një anijeje ku nuk është kapiten. Myslimani sot duhet të çlirohet nga vetë-ngarkimi i panevojshëm, te besimi i paluhatshëm në urtësinë e Zotit që do gjithmonë të mirën për të. Rrjedha e universit nuk varet nga kalkulimet tona, prandaj duhet ta rehatojë veten nga planifikimi i pavend, atë që dikush tjetër e bën për ne, ku është arsyeja ta bëjmë përsëri?[8] Mungesa e bindjes së paluhatshme në drejtuesin e anijes së jetës sonë turbullon zemrën dhe është shkaktar që prish rehatinë.

Shpërqendrimi i vëmendjes dhe qëllimeve të zemrës

"Dëgjojeni këtë shembull që ka sjellë Allahu! Janë dy njerëz: njëri ka shumë bashkëpronarë që e kundërshtojnë njëri-tjetrin, ndërsa tjetri ka vetëm një pronar, të cilit i përkushtohet. A janë të njëjtë ata në krahasim?! Lavdëruar qoftë Allahu, por shumica e tyre nuk e dinë këtë!" (Zumer, 29). Ashtu është edhe zemra, po pati një qëllim dhe është e përqendruar në të, e arrin prehjen, po u shpërnda vëmendja e saj në dhjetëra interesa të kësaj bote, e humb njëzimin e saj dhe mbetet në konflikt të brendshëm.[9]

Ndryshkja e pasqyrës nga epshi dhe mëkatet

Dorëzimi ndaj impulseve të ulëta trupore dhe mëkateve vepron si tym i zi mbi pasqyrën e shpirtit, duke bllokuar dritën dhe dallimin e së vërtetës.[10] Kjo e mbulon zemrën me ndryshk dhe prish qetësinë. Allahu Fuqiplotë në Kuran thotë: *"...veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat."* (Mutafifiin, 14). [11]

PËRFUNDIMI

Në vetë thelbin e emërtimit të saj në gjuhën arabe, zemra (*el kalb*) mbart dramën e natyrës së vet më themelore: luhatjen e pareshtur (*et tekalub*). Ajo nuk është një strukturë e ngurtë apo një mekanizëm statik, por një pasqyrë jashtëzakonisht e ndjeshme, e cila lëkundet nga çdo ngacmim i jashtëm dhe çdo impuls i brendshëm. E vendosur midis dy tërheqjeve të fuqishme – gravitetit të dheut përmes impulseve të nefsit dhe thirrjes së lartë të amshimit përmes shpirtit – zemra mbetet në një betejë të vazhdueshme ekuilibri. Kjo natyrë e saj dinamike nuk përbën një mangësi biologjike, por dëshmon ndjeshmërinë e lartë morale dhe peshën e lirisë së vullnetit me të cilën Krijuesi e ka fisnikëruar njeriun.

Myslimani modern, i vetëdijshëm për rëndësinë dhe rolin e zemrës në qenien e tij, duhet të ushqejë zemrën e tij me ushqimin e duhur. Kur zemra kërkon prehje te lëvdata kalimtare e njerëzve, te siguria e rreme e materies apo tek iluzioni i kontrollit absolut të së ardhmes, ajo përpiqet të shuajë etjen e saj ekzistenciale me ujë të kripur. Zemra gjen prehje vetëm atëherë kur mbështetet te një Krijues që nuk lëkundet, një Bukuri që nuk venitet dhe një Urtësi që nuk gabon. Arritja e kësaj prehjeje do të jetë gjithmonë e cenuar nga pengesat, lufta me të cilat është kader i pashmangshëm, bën dallimin mes njerëzve dhe spikat të zgjedhurit, të lumturit, fitimtarët.

---

1 Aludon në hadithin: "Në trupin e njeriut ka një copë mishi, kur ajo është e shëndoshë, i gjithë trupi është i shëndoshë. Kur ajo prishet, prishet i gjithë trupi. Vini re, ajo është zemra!" Shih: Muhamed Ismail el Buhari, Sahih el Buhari. (Damask, Ibën Kethir Publishing, 1993), v. 1, f. 28.

2 Fahruddin er Razi, Et Tefsir el Kebir (Mefatih el Gajb), (Bejrut: Dar Ihja et Turath el Arabi, 1999), vëll. XXIII, f. 235.

3 Koncepti i referohet Sistemit Nervor të Brendshëm Kardiak (ICNS), i dokumentuar nga Dr. J. Andrew Armour. Zemra disponon një rrjet autonom prej rreth 40,000 neuronesh që përpunon informacione të pavarura dhe dërgon më shumë impulse drejt lobit frontal sesa merr prej tij, duke kushtëzuar drejtpërdrejt kthjelltësinë mendore dhe vendimmarrjen.

4 J. Andrew Armour, Neurocardiology: Anatomical and Functional Principles, (Boulder Creek: HeartMath Research Center, 2003), 19-23.

5 Për rolet e dimensioneve shih: Sheref el Kudah, El Hedj en Nebevij fi er Rrakaik, (Aman: Dar el Furkan, 1999), 3-15.

6 Ahmed ibën Hanbel, El Musned, vëll. XXIX, (Bejrut: Muesseset er Risaleh, 2001), 531.

7 Harith el Muhasibi, Er Ri'ajeh li Hukukilah, (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmijjeh, 2001), 342.

8 Ibën Ataullah el Iskenderi, El Hikem el Ataijjeh, (Kajro: Dar es Selam, 2006), f. 14. (Urtësia nr. 4).

9 Ebul Kasim el Xhunejd el Bagdadi, Resa'il el Xhunejd, (Kajro: Dar es Selam, 2004), 164.

10 Ebu Hamid el Gazali, Ihjau Ulumi Din, vëll. III, (Bejrut: Dar el Marifeh, 1982), 14.

11 Do të ishte me vend po të shtohej edhe mekanizimi i adhurimeve dhe lidhja e shpresës me krijesat si pengesa, por për hir të hapësirës u fokusuam vetëm te pengesat që në pikëpamjen tonë janë kryesoret.



Teknologjitë e reja dhe formësimi i qëndrimeve juridike islame

Dr. Bashkim Aliu

Zhvillimi i teknologjisë po krijon çështje të reja që kërkojnë përgjigje juridike islame të menduara, të argumentuara dhe të përshtatura me rrethanat. Sfida nuk është ndryshimi i parimeve të pandryshueshme, por zbatimi i tyre me kompetencë në realitete të reja. Kjo kërkon dijetarë që kuptojnë njëkohësisht burimet fetare dhe botën bashkëkohore.

Zhvillimi i teknologjive të reja, në veçanti i teknologjisë së informacionit (IT), përbën një arsye shumë të fortë për nevojën e formësimit të qëndrimeve juridike islame, të cilat duhet të marrin parasysh si aspektet pozitive, ashtu edhe ato negative. Në këtë kuadër, është e nevojshme të rishikohet rregulla juridike "seddu dheria" (masat preventive ose mbyllja e rrugëve që çojnë në veprime të ndaluara) dhe të rishqyrtohet rregulla juridike "el maslaha el mursele" (interesi i konsiderueshëm ose interesi publik), si dhe "el istihsan" (preferimi).

Kjo kërkon ndërtimin e qëndrimeve juridike për problemet e shtruara nga zhvillimi i teknologjisë, pa abstrahuar aspekte të caktuara dhe pa u përqendruar vetëm në një dimension të tyre. Përballë rrethanave dhe zhvillimeve të kohës, nuk mjafton që diçka të cilësohet si e ndaluar – haram – në fushën e teknologjisë, pa dhënë shpjegimet përkatëse. Përkundrazi, ndërtimi i qëndrimeve juridike duhet të bëhet duke i sqaruar si aspektet pozitive, ashtu edhe ato negative.

> Përballë rrethanave dhe zhvillimeve të kohës, nuk mjafton që diçka të cilësohet si e ndaluar – haram – në fushën e teknologjisë, pa dhënë shpjegimet përkatëse.

Me fjalë të tjera, përshtatja e qëndrimeve juridike fetare me kërkesat e kohës nuk nënkupton se gjithçka lejohet dhe se duhet të pranohet vetëm qasja laike. Përkundrazi, ajo nënkupton një qasje të thelluar, burimore, kompetente dhe adekuate ndaj burimeve fetare. Në këtë kontekst, dijetari mysliman Abdul Mexhid en Nexhari ka thënë: "Zbatimi i ndalimit të kamatës në fushën ekzistuese financiare kërkon një hetim të thelluar të transaksioneve të ndryshme, për të dalluar ato që bëjnë pjesë në këtë kategori nga ato që nuk bëjnë. Pasi të veçohet ribaja (kamata), këto transaksione duhet të studiohen plotësisht për të përcaktuar natyrën dhe vëllimin e tyre, shkaqet e menjëhershme dhe të largëta, dimensionet ndërkombëtare, si dhe pasojat e tyre afatshkurtra dhe afatgjata. Në bazë të vlerësimeve të tilla, zbatimi i dispozitës për ribanë mund të pezullohet përkohësisht për disa transaksione të kësaj kategorie. Mund të konsiderohet e nevojshme një periudhë tranzicioni për t'u përgatitur për një sistem financiar pa interes, i projektuar për të zëvendësuar sistemin ekzistues të bazuar në interes."[1]

Në fakt, juristët islamë që herët kanë rregulluar mënyrën e ndërtimit të qëndrimeve juridike për çështjet e ndryshueshme, të mbështetura në argumente jo të prera, veçanërisht sa i përket lidhjes së tyre me çështjen konkrete për të cilën është zhvilluar debat.

Kjo çështje i ka rrënjët në rregullin juridik të miratuar nga dijetarët islamë, sipas të cilit fetvaja ndryshon në përputhje me ndryshimin e kohës, vendit, situatës dhe personit.

Trashëgimia shkencore islame në fushën e jurisprudencës është mjaft e pasur me shembuj që tregojnë se disa dispozita ndryshojnë si rezultat i ndryshimit të kontekstit dhe rrethanave mbizotëruese.[2] Këtu mund të përmendet ndalesa e të Dërguarit të

Allahut për ruajtjen e mishit të kurbaneve, të cilën ai e kishte vendosur për shkak të nevojave të njerëzve në kushte vështirësie. Më pas, kur rrethanat ndryshuan, ai lejoi që mishi të ruhej.3 Vetë fakti se vitin e ardhshëm e pyetën nëse duhej të vepronin me mishin e kurbaneve ashtu siç kishin vepruar vitin e kaluar tregon se ndryshimi i mundshëm i fetvasë dhe i qëndrimeve, si rezultat i ndryshimit të rrethanave, nuk ishte i panjohur për shokët e të Dërguarit të Allahut – sahabët. Dijetari i shquar Ibën el Kajjim el Xhevzije thekson nevojën për ndërtimin e qëndrimeve adekuate ndaj situatave të reja, në vend që situatat e reja t'u referohen vendimeve të vjetra, me qëllim që të evitohen dëmet që mund të shkaktojë një qasje e tillë.[4] Po ashtu, juristi i famshëm, Imam Maliku, i porosiste nxënësit e tij të mos i mësonin fetvatë përmendsh, por të mësonin rregullat dhe kriteret juridike për të nxjerrë përfundime nga burimet e jurisprudencës islame për çështjet që kërkonin përgjigje fetare. Imam Maliku ua jepte këtë porosi nxënësve të tij, sepse ishte i shqetësuar se "një fetva e shkruar, e cila ishte e rëndësishme për një ngjarje të caktuar, do të zbatohej automatikisht më vonë për një ngjarje të ngjashme, pa marrë parasysh rrethanat shoqëruese që kërkuan një fetva të re."[5]

Këtë çështje e kuptojmë edhe nga elaborimi i Këshillit Evropian për Fetva dhe Gjurmime, në lidhje me "Ligjërimin islam në epokën e globalizmit", ku, ndër të tjera thuhet: "Ligjërimi ynë islam në epokën e globalizmit ka nevojë të menjëhershme për ndryshim dhe zhvillim. Kjo nuk nënkupton ndryshimin e koncepteve të pandryshueshme dhe të objektivave islame, por i referohet ndryshimit të metodave të thirrjes, mënyrave të shpjegimit dhe teknikave të mësimdhënies. Kjo për arsye se jemi mësuar t'i flasim vetvetes dhe që të tjerët të mos e dëgjojnë zërin tonë. Mirëpo, sot ajo që thuhet në një vend arrin në të njëjtin moment në të gjitha anët e botës, sepse bota është shndërruar në një fshat të vogël. Dispozitat legjislative islame që u shpjegohen myslimanëve nuk janë të njëjta me ato që u shpjegohen jomyslimanëve, duke filluar nga doktrina e besimit islam dhe duke vazhduar me çështjet e tjera. Ajo që i thuhet një personi që sapo ka kaluar në Islam nuk është e njëjtë me atë që i thuhet një myslimani që ka lindur në një familje myslimane..."[6]

Teknologjia e re, me zhvillimin e saj të hovshëm gjatë dekadave të fundit, është shtrirë në shumë fusha dhe ka ofruar mundësi të reja veprimi, si në ekonomi, ashtu edhe në politikë, kulturë dhe fusha të tjera, të cilat më parë nuk ishin të njohura. Ky zhvillim dikton edhe mobilizimin e kuadrit fetar në drejtim të aftësimit për të ofruar qëndrime të mbështetura në parimet fetare lidhur me mundësitë e reja dhe format e reja të biznesit, të cilat tashmë kanë karakter transnacional. Kjo për faktin se dijetari islam nuk synon të largohet nga skena botërore dhe të izolohet, e aq më pak të jetë një subjekt inekzistent në botën virtuale.

Së këndejmi, kërkohet integrimi i mënyrave dhe formave të reja të veprimtarive të ndryshme që mundësohen nga teknologjia bashkëkohore, duke i harmonizuar ato me parimet islame.



Lidhur me nevojën për integrimin e metodave dhe arritjeve bashkëkohore, Abdulhamid ebu Sulejmani ka thënë: "Hulumtuesit myslimanë duhet ta çlirojnë veten në mënyrë kreative, gjithëpërfshirëse, kritike, shkencore dhe analitike në të menduar; të zhvillojnë një kuptim të drejtë të perspektivës kuranore mbi njerëzimin dhe çështjet që e rrethojnë atë, së bashku me vlerat dhe parimet e pandryshueshme të kësaj perspektive; ta pajisin veten me njohuri të thella dhe metoda shkencore për studimin e natyrës njerëzore, ligjeve dhe modeleve të universit material dhe të shoqërive njerëzore, potencialeve dhe fuqisë së tyre brenda kontekseteve të caktuara kohore dhe gjeografike; si dhe të përfitojnë nga trashëgimia islame, por edhe nga arritjet shkencore të shoqërisë moderne perëndimore."[7]

Imami i epokës së globalizimit, kudo që të jetë, mund të ketë pas vetes, duke u falur, një xhemat ku ndonjë prej pjesëtarëve ka aksione në ndonjë bursë botërore, kryen transaksione me Bitcoin, është anëtar i bordit të ndonjë kompanie shumëkombëshe ose zotëron aksione në ndonjë kompani të madhe. E gjithë kjo kërkon përgatitje dhe kualifikim të duhur për sa i përket qasjes juridike islame ndaj këtyre mënyrave të reja të biznesit dhe tregtimit, të cilat më herët nuk kanë qenë të pranishme.

Megjithatë, fusha ekonomike, ndonëse është më tërheqësja dhe më e pranishmja, nuk është e vetmja. Këtu kemi edhe sferën



politike, e cila gjithashtu e përdor hapësirën virtuale për ta shtrirë ndikimin e saj në botë. Kjo, po ashtu, nënkupton nevojën për formësimin e qëndrimeve juridike islame edhe për çështje të karakterit politik që qarkullojnë ndër njerëz, edhe nëse nuk lidhen drejtpërdrejt me vendin ku jetojnë.

Nga ana tjetër, në nivel lokal dhe nacional, në veçanti IT-ja është shndërruar në një mekanizëm të fuqishëm të marketingut politik, kështu që ata që janë të aftë në këtë fushë arrijnë rezultate të dukshme politike dhe, për pasojë, ndikojnë edhe në orientimin e opinionit publik. Për këtë arsye, lind edhe pyetja, e cila kërkon trajtim nga aspekti i së drejtës islame: cilët janë kufijtë e përdorimit të kësaj teknologjie nga një politikan mysliman, i cili ka vetëdije fetare dhe udhëhiqet nga parimet fetare, ose, për ta shprehur me vokabularin fetar, "e ka frikë Zotin"? A thua kjo hapësirë e gjerë mediatike transnacionale i jep të drejtë politikanit mysliman ta përdorë si të dëshirojë, pa limite dhe kufij moralë sipas bindjeve të tij, me qëllim që të arrijë rezultatet politike të dëshiruara? Për këtë arsye, kërkohet formësimi i qëndrimeve fetare edhe për këto çështje.

Në këtë drejtim, IT-ja kërkon përgatitje adekuate të predikuesve fetarë edhe për disa çështje të karakterit fetar që shtrohen nga vetë myslimanët, të cilët kanë qëndrime të caktuara që nuk përputhen me qëndrimet e pjesës më të madhe të myslimanëve. Për shkak të mundësive të komunikimit, sot kërkohet sqarim edhe për çështje të ndjeshme, të cilat shtrohen në një shkallë të gjerë, si: shtetësia në vendet jomyslimane, kalifati, el vela vel bera (lojaliteti dhe distancimi në emër të fesë), darul islam dhe darul kufr (vendet islame dhe vendet jomyslimane), festat dhe urimet për pjesëtarët e feve të tjera, mënyra e trajtimit të robërve të luftës etj. Këto dhe shumë tema të tjera, në mungesë të IT-së, nuk kanë qenë aq aktuale dhe nuk janë diskutuar në çdo nivel, por vetëm në nivele të caktuara; gjithashtu, nuk janë diskutuar në këtë format dhe në këto përmasa. Ndërkaq, sot, kur komunikimi është i mundur edhe nga vetë vatrat e krizave dhe frontet e luftës, këto dhe çështje të tjera qarkullojnë gjerësisht në masë.

Në këtë drejtim, Ibrahim Kallën shprehet: "Ndërsa Kurani dhe tradita profetike, si dy burimet themelore të Islamit, kanë vënë parime të qarta dhe, aty-këtu, të posaçme lidhur me parimet themelore të fesë, për sa u përket zakoneve dhe traditave kulturore kanë adoptuar parime të përgjithshme dhe harmonia midis këtyre të dyjave është synuar të arrihet nga individët dhe shoqëritë myslimane. Siç nënvizojnë dijetarët klasikë të fesë, përderisa nuk bien ndesh me parimet themelore të Islamit, të gjitha zakonet dhe traditat kulturore janë të lejuara; pra, në këndvështrimin e fesë, kanë karakter asnjanës. Adoptimi dhe braktisja e tyre i është lënë zgjedhjes së bashkësisë përkatëse."[8]

1 El Naxhar, Abd el Mexhid, 2020, Mëkëmbësia e njeriut ndërmjet shpalljes dhe arsyes, Shkup: Furkan ISM, f. 124.

2 Shih: Siddiki, Muhamed Nexhatullah, 2016, Mekasidu esh sheri'a vel hajat el mua'sire, Damask: Darul Kalem, f. 151.

3 Hadithin e ka transmetuar Buhariu në Sahihun e tij, libri i kurbaneve, kapitulli: "Ç'mund të hahet nga mishi i kurbaneve dhe ç'mund të ruhet prej tij".

4 El Xhevzijje, Ibën el Kajjim, I'lamu-l-muveki'in, vëll. III, f.5, cituar sipas: El Naxhar, Abd el Mexhid, Mëkëmbësia e njeriut ndërmjet shpalljes dhe arsyes, f.122.

5 El Naxhar, vep. e cit., f. 122.

6 Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, 2021, Vendimet dhe Fetvatë e publikuara nga KEFGJ, përktheu: Bashkim Aliu, Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion në Lozanë, Prishtinë, f. 76-77.

7 Ebu Sulejman, Abdulhamid, 2014, Botëkuptimi kur'anor. Një pikënisje për reformë kulturore, Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, f. 47-48.

8 Kallën, Ibrahim, 2021, Islami dhe Perëndimi, përktheu: Rubin Hoxha, Sira, Prishtinë, f. 40.



Inteligjenca Artificiale dhe shkenca e Fikhut (Jurisprudencës):

NJË SHNDËRRIM QYTETËRUES DHE NJË MUNDËSI PËR TË RRËNJOSUR METODOLOGJINË MESATARE (EL VESATIJE)

Prof. dr. Abdullah Ibrahim Zejd el Kilani

Inteligjenca artificiale po hap mundësi të reja për kërkimin dhe analizën në fikhun islam, por nuk mund ta zëvendësojë ixhtihadin dhe gjykimin njerëzor. Sfida kryesore është përdorimi i saj si mjet ndihmës, me verifikim, përgjegjësi dhe vetëdije për kufijtë e saj. Në këtë raport mes teknologjisë dhe dijes qëndron edhe e ardhmja e kërkimit juridik islam.

Përparimi i jashtëzakonshëm në fushën e Inteligjencës Artificiale (IA) përbën një pikë kthese historike për njerëzimin. Përderisa në të kaluarën ajo shihej thjesht si një mjet i pastër teknik, sot ajo zotëron aftësinë për të rishkruar themelet e dijes në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe shkencat e Sheriatit. Integrimi i kësaj teknologjie në fikhun islam nuk është thjesht një luks, por një domosdoshmëri qytetëruese që u shërben qëllimeve të Sheriatit (maksimave ligjore), për qëllim të lehtësimit dhe largimit të vështirësive. Ajo hap horizonte të gjera për të fuqizuar metodologjinë mesatare dhe të moderuar në fushën e fetvave dhe gjyqësorit. Ky artikull shqyrton potencialin e inteligjencës artificiale dhe zbatimet e saj praktike, duke theksuar rëndësinë e përdorimit të saj me vetëdije dhe përgjegjësi në shërbim të fikhut islam.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE SI MJET NJOHËS: NGA KËRKIMI TRADICIONAL TEK ANALIZA E AVANCUAR

Kërkimi në fushën e fikhut ka qenë gjithmonë një detyrë jashtëzakonisht komplekse. Ajo kërkon nga juristi (fekihu) të shqyrtojë qindra, madje mijëra libra dhe përmbledhje të grumbulluara përgjatë shekujve. Kjo sasi kolosale e dijes përfaqëson një thesar të çmuar, por në të njëjtën kohë mbetet një sfidë e madhe për t'u qasur dhe për t'u përvetësuar. Këtu shfaqet roli parësor i inteligjencës artificiale, e cila mund ta ngrejë kërkimin shkencor nga faza e grumbullimit manual në fazën e analizës së lartë të superpërparuar.

> Inteligjenca artificiale nuk mund ta zëvendësojë juristin mysliman në procesin e ixhthihadit (përpjekjes intelektuale), i cili kërkon një kuptim të thellë të konteksteve historike, çështjeve bashkëkohore, të njohura në terminologjinë fetare me termin (en nevazil) dhe qëllimeve të Sheriatit.

Sistemet e inteligjencës artificiale shkëlqejnë në analizimin e teksteve voluminoze dhe në mbledhjen e të dhënave nga burime të shumta me një shpejtësi të rrufeshme. Ato mund të skanojnë mijëra libra dhe artikuj juridikë për të përcaktuar medhhebet (shkollat juridike), mendimet e ndryshme dhe argumentet e Sheriatit. Kjo analizë nuk kufizohet vetëm në nxjerrjen e fjalëve kyçe, por shkon përtej saj, duke kuptuar marrëdhëniet semantike midis teksteve dhe duke identifikuar argumentet mbi të cilat bazohet çdo mendim.

Megjithatë, është thelbësore të kuptohen aftësitë dhe kufizimet e inteligjencës artificiale. Ajo zotëron fuqi në analizë dhe grumbullim, por i mungon aftësia për deduktim (istinbat) dhe krijimtari. Inteligjenca artificiale nuk mund ta zëvendësojë juristin mysliman në procesin e ixhthihadit (përpjekjes intelektuale), i cili kërkon një kuptim të thellë të konteksteve historike, çështjeve bashkëkohore, të njohura në terminologjinë fetare me termin (en nevazil) dhe qëllimeve të Sheriatit. Ajo është një mjet ndihmës dhe jo një zëvendësues i mendjes njerëzore.

MËNYRAT MË TË MIRA PËR TË MARRË REZULTATIN MAKSIMAL NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE

Përfitimi maksimal nga inteligjenca artificiale në kërkimin juridik arrihet duke kuptuar aftësitë dhe kufijtë e saj, si dhe duke përdorur mjetet e saj në mënyrë të saktë dhe të menduar mirë.



Praktikat më të mira mund të përmblidhen në pikat e mëposhtme:

Formulimi i saktë i pyetjeve: Pyetjet duhet të jenë specifike dhe të qarta. Në vend të një pyetjeje të përgjithshme si "Cila është dispozita për namazin?", preferohet të bëhen pyetje specifike si: "Cila është dispozita për namazin e udhëtarit sipas medhhebit maliki?" ose "Cilat janë argumentet mbi të cilat bazohet medhhebi shafi në dispozitën për agjërimin e të sëmurit?" Ky specifikim e drejton sistemin drejt përgjigjeve më të sakta dhe më të fokusuara.

Përcaktimi i burimeve: IA mund të udhëzohet që të bazohet në burime të besueshme dhe të caktuara. Për shembull, mund të kërkohet: "Potenco mendimet e Imam Neveviut në librin *"El Mexhmu"* rreth dispozitës për shitblerjen me këste". Kjo garanton që përgjigjja të jetë e dokumentuar dhe e kufizuar në një referencë juridike të mirënjohur.

Kërkesa për krahasime dhe analizë: Inteligjenca artificiale mund të përdoret për të krahasuar medhhebet e ndryshme juridike. Mund të kërkohet: "Një krahasim midis dispozitës së martesës së përkohshme (Nikah el mut'ah) te hanefitë dhe shiitët, duke përmendur argumentet". Kjo veçori ia lehtëson kërkuesit shqyrtimin e opinioneve të shumta për një çështje të vetme.

Përdorimi i IA si indeks i zgjuar: IA funksionon si një indeks i shpejtë për bibliotekat gjigante të fikhut. Ajo mund të gjejë lokacione specifike të një çështjeje juridike në libra të caktuar, ose të grumbullojë fetvatë e dijetarëve të caktuar rreth një teme. Kjo veçori kursen kohë dhe përpjekje të madhe gjatë kërkimit.

Rishikimi dhe verifikimi i rezultateve: Nuk duhet mbështetur plotësisht në përgjigjet e inteligjencës artificiale. Çdo informacion i ofruar prej saj duhet të rishikohet dhe të verifikohet duke iu referuar burimeve origjinale. IA mund të gabojë në kuptimin e disa termave ose të lidhë tekste që nuk kanë lidhje mes vete. Përgjegjësia fetare dhe morale mbetet mbi supet e njeriut.

Shkurtimisht, mënyra më e mirë për të përfituar nga inteligjenca artificiale në kërkimin e fikhut është përdorimi i saj si një mjet për grumbullimin dhe analizën paraprake të informacionit, dhe jo për deduktim rregullash apo për dhënie fetvash.

ZBATIMET PRAKTIKE NË FUSHËN E FIKHUT: NJË REVOLUCION NË METODOLOGJI

Potenciali i inteligjencës artificiale shkon përtej kërkimit të thjeshtë akademik, duke përfshirë zbatime praktike dhe të drejtpërdrejta në jetën e myslimanëve. Ajo mund të shfrytëzohet me efikasitet në fusha të ndryshme:

Indeksimi dhe analiza e të dhënave tekstuale: Sistemet e IA-së mund të kryejnë një skanim gjithëpërfshirës të të gjithë librave bazikë të fikhut (Umehat el Kutub), nga *"El Mugni"* i Ibën Kudames deri tek *"El Mexhmu"* i Neveviut, si dhe nga librat e katër medhhebeve deri te librat e fikhut ezoterik (dhahiri). Sistemi nuk mjaftohet vetëm me indeksimin, por mund të analizojë tekstet, të kuptojë lidhjet e tyre, të nxjerrë mendimet e ndryshme për një çështje të caktuar dhe të përcaktojë argumentet e çdo opinioni, duke treguar fuqinë apo dobësinë e argumenteve bazuar në një metodologji të rreptë shkencore.

Krijimi i hartave konceptuale (mendore) dhe lidhjeve kognitive: IA mund të ndërtojë harta mendore ndërvepruese që lidhin fetvatë me maksimat ligjore (Kava'id Fikhije) dhe parimet mbi të cilat ato janë ndërtuar. Për shembull, gjatë kërkimit mbi vendimin për "shitblerjet", sistemi mund të shfaqë një skemë të plotë nga e cila degëzohen llojet e shitjeve dhe kushtet e tyre, duke i lidhur ato me rregulla të përgjithshme si: "Parimi bazë te kontratat është lejueshmëria, përveç nëse ekziston një argument për ndalimin e saj". Këto harta ia lehtësojnë studiuesit kuptimin e pamjes së përgjithshme të çështjes.

Analiza e konteksteve historike dhe qëllimore (mekasid): Vlera e vërtetë e inteligjencës artificiale nuk qëndron te vetë informacioni, por tek aftësia e saj për të kuptuar kontekstet historike dhe sociale në të cilat janë dhënë gjykimet. Modelet e IA-së mund të trajnohen për të lidhur fetvatë e lëshuara në një periudhë të caktuar me rrethanat ekonomike ose politike mbizotëruese të asaj kohe. Kjo e ndihmon juristin bashkëkohor të dallojë midis gjykimeve që ishin të lidhura me një zakon (urf) të caktuar apo me një realitet të ndryshueshëm dhe gjykimeve të pandryshueshme. Kjo i shërben shkencës së Maksimave (qëllimeve të Sheriatit) në formën e saj më të lartë.

ZBATIMET PRAKTIKE NË FETVA DHE GJYQËSOR

Përdorimi i inteligjencës artificiale nuk kufizohet vetëm në kërkimin akademik, por shtrihet edhe në zbatime praktike dhe të drejtpërdrejta në jetën e myslimanëve.

Në fushën e fetvasë: Ndihmësi juridik i zgjuar

Mund të zhvillohet një sistem i zgjuar fetvash që nuk funksionon thjesht si një motor kërkimi, por si një asistent ndërveprues i fikhut. Ky asistent mund të pranojë pyetjen e personit, ta analizojë atë në thellësi dhe pastaj të bëjë pyetje shtesë sqaruese për të kuptuar të gjitha dimensionet e çështjes. Për shembull, nëse dikush pyet për dispozitën e tregtimit me aksionet e një kompanie të caktuar, asistenti i zgjuar mund të pyesë për natyrën e punës së kompanisë dhe nëse ajo shet produkte hallall apo haram, për të ofruar një përgjigje sa më të saktë.

Zvogëlimi i ngarkesës mbi myftinitë: Ky sistem mund t'u përgjigjet miliona pyetjeve të përsëritura që mbërrijnë në institucionet e fetvasë, gjë që u mundëson myftinjve të përqendrohen në çështje komplekse dhe në temat e reja bashkëkohore që kërkojnë ixhthihad kolektiv.

Qasja në fetva të besueshme: Platforma mund të ofrojë përgjigjet e saj të shoqëruara me dokumentim të plotë të burimeve, që nga Kurani fisnik dhe Suneti i Pejgamberit e deri te thëniet e imamëve dhe medhhebeve, gjë që rrit besimin te fetvaja.

PËRDORIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE PËR TË RRËNJOSUR METODOLOGJINË MESATARE (TË MODERUAR)

Roli i inteligjencës artificiale nuk kufizohet vetëm në mbledhjen dhe përmbledhjen e informacionit, por ajo mund të jetë një mjet efektiv në rrënjosjen e parimit të mesatarisë dhe moderimit (vasatije). Përmes trajnimit të modeleve gjuhësore në burime të ndryshme që përfaqësojnë shkolla të ndryshme juridike, IA mund t'i ofrojë përdoruesit një pamje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar të mendimeve, në vend që të anojë vetëm drejt një mendimi. Për shembull, gjatë kërkimit të një dispozite fetare për një çështje specifike, sistemi mund të shfaqë mendimet e katër medhhebeve, përveç opinioneve të juristëve bashkëkohorë, duke sqaruar argumentet e secilës palë.

Kjo veçori e ndalon studiuesin të bjerë në kurthin e ekstremizmit apo lëshimeve të pajustifikuara dhe rrit tek ai aftësinë për të krahasuar dhe analizuar përpara se të arrijë në gjykimin përfundimtar. Gjithashtu, IA mund të identifikojë mendimet e rralla (shadhe) ose ekstremiste që bien ndesh me shumicën e dijetarëve (xhumhur) dhe të shpjegojë arsyen e këtij devijimi, gjë që e drejton studiuesin drejt metodologjisë së moderuar që përfaqëson shumicën dërrmuese të juristëve. Në këtë mënyrë, inteligjenca artificiale shndërrohet në një udhërrëfyes njohës, që i shërben mendjes myslimane në rrugëtimin e saj drejt një kuptimi më të thellë dhe më gjithëpërfshirës të Sheriatit.

NË FUSHËN E GJYQËSORIT: ANALIZA E RECEDENTËVE DHE FORCIMI I DREJTËSISË

Inteligjenca artificiale konsiderohet një mjet revolucionar në fushën e gjyqësorit të Sheriatit, veçanërisht në studimin e precedentëve gjyqësorë.

Bazë e zgjuar e të dhënave gjyqësore: Mund të zhvillohet një sistem që grumbullon të gjitha vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjykatat e Sheriatit, duke i analizuar dhe klasifikuar ato sipas llojit të padisë, rrethanave, provave të paraqitura dhe vendimit të marrë.

Forcimi i konsistencës gjyqësore: Kur gjykatësi shqyrton një çështje të caktuar, ai mund të ndihmohet nga sistemi për të marrë përmbledhje të vendimeve të mëparshme në çështje të ngjashme. Kjo e ndihmon atë të arrijë në një vendim të drejtë dhe të përputhshëm me parimet e mëparshme gjyqësore, gjë që zvogëlon kontradiktat midis vendimeve dhe fuqizon parimin e drejtësisë.

Ndihma e gjykatësve në nxjerrjen e provave: Sistemi mund të ndihmojë gjykatësin në nxjerrjen e shpejtë të provave nga tekstet fetare dhe ligjore, si dhe në përmbledhjen e pikëpamjeve të palëve kundërshtare, duke kursyer kohë të çmuar në procesin gjyqësor.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE NDËRMJET DIALOGUT TË THELLË DHE RREZIQEVE TË FSHEHURA: MËSIME NGA REALITETI

Përvoja e dialogut me modelet e inteligjencës artificiale rreth çështjeve të Sheriatit, siç janë dispozitat e xhihadit në suren Et Tevbe, zbulon një të vërtetë të rëndësishme: aftësinë e këtyre sistemeve për të ofruar përgjigje të shumta dhe të sakta në kontekste të ndryshme. Në shembullin e sures Et Tevbe, modeli "Gemini" dha në shikim të parë dy përgjigje të ndryshme lidhur me specifikën e ajeteve dhe përgjithësimin e tyre, por arriti t'i harmonizojë ato pas një udhëzimi njerëzor.



HARMONIZIMI NDËRMJET DY PËRGJIGJEVE: METODOLOGJIA E TEFSIRIT (KOMENTIMIT) DHE DEDUKTIMIT

Sekreti i kontradiktës së dukshme qëndron në dallimin e metodologjisë me të cilën shihet teksti. Përgjigjja e parë bazohej në metodologjinë e interpretimit kontekstual/shkakor (Causal Interpretation), e cila fokusohet në shkakun e zbritjes (Esbab en Nuzul) dhe rrethanat historike të ajetit. Ajetet të cilat flasin për "Lëvizje/udhëtim në tokë" zbritën në një kontekst specifik që lidhej me thyerjen e marrëveshjes nga ana e mushrikëve (idhujtarëve) të Arabisë, prandaj gjykimi ishte specifik për ta. Kjo përgjigje është e saktë nga pikëpamja e tefsirit. Dhe kjo është ajo që kanë specifikuar një numër komentuesish bashkëkohorë si Ibën Ashuri, i cili sqaroi se qëllimi i ajetit ishin idhujtarët arabë të asaj kohe.

Përgjigjja e dytë mbështetej në metodën e prejardhjes juridike (Legal Derivation), e cila e sheh tekstin nga këndvështrimi i mundësisë së prejardhjes së një rregulli të përgjithshëm prej tij. Shumë juristë (fakihë) nxjerrin nga këto ajete detyrimin e "Xhihadit kërkues" ose "Xhihadit sulmues" si një parim juridik parësor, pavarësisht nga shkaku specifik i shpalljes së tyre. Kjo metodologji vlerëson se rëndësia qëndron në universalitetin e shprehjes dhe jo në veçantinë e shkakut.

Prandaj, inteligjenca artificiale, kur iu kërkua të pajtonte dy përgjigjet, nuk bëri gjë tjetër veçse një proces analize metodologjike të bazave mbi të cilat ishte ndërtuar secila përgjigje. Ajo nuk shpiku një zgjidhje, por paraqiti mosmarrëveshjen juridike në thelbin e saj: A ka përparësi interpretimi kontekstual ndaj prejardhjes juridike apo e kundërta? Kjo aftësi për të analizuar metodologjitë është vlera e vërtetë e inteligjencës artificiale në këtë kontekst, me kusht që të ekzistojë mendja njerëzore udhëheqëse që e kupton natyrën e kësaj mosmarrëveshjeje.

ÇËSHTJA E DJALIT QË BËRI VETËVRASJE: NJË NDARJE E QARTË NDËRMJET MENDJES DHE MAKINËS

Çështja e vdekjes së adoleshentit që ndërveproi me programin "ChatGPT" para vetëvrasjes së tij ndryshon rrënjësisht nga përvoja e dialogut rreth ajeteve të xhihadit, megjithëse mbart një mësim të përbashkët. Kompania "OpenAI" u përball me një padi nga dy prindër që e akuzonin atë për shkaktimin e vdekjes së djalit të tyre, duke pohuar se programi "ChatGPT" e kishte inkurajuar atë të bënte vetëvrasje.

Dallimi i kontekstit: Çështja e ajeteve të xhihadit sillej rreth sferës së njohurisë abstrakte, ku përdoruesi ishte një studiues i specializuar që e drejtonte sistemin drejt përgjigjeve specifike. Ndërsa çështja e adoleshentit sillej rreth sferës së realitetit njerëzor tmerrësisht kompleks, ku ndjenjat dhe çrregullimet psikologjike ishin në qendër. Këtu, përdoruesi nuk po kërkonte një informacion, por një ndërveprim emocional ose një zgjidhje për një problem ekzistencial.

Dështimi në dimensionin njerëzor: Rreziku këtu qëndron në faktin se inteligjenca artificiale, me gjithë aftësinë e saj të jashtëzakonshme për të shtjelluar gjuhën, nuk posedon ndërgjegje, empati apo kuptim të vërtetë të realitetit njerëzor. Kur dikush kërkon ndihmë në një moment kritik, inteligjenca artificiale mund të ofrojë informacion të paqëllimshëm, ose madje të dështojë në ndjenjën e rrezikut të situatës, gjë që çon në përkeqësimin e krizës.

Kjo çështje nxjerr në pah një pikë vendimtare: Inteligjenca artificiale mund të jetë një mjet i fuqishëm për ta ndihmuar njeriun në fushat e njohurisë, por ajo nuk mund ta zëvendësojë njeriun në fushat që kërkojnë ndërgjegje, empati dhe urtësi. Myftiu ose gjykatësi, kur trajton një çështje, nuk mjaftohet vetëm me kuptimin e dëshmive dhe argumenteve, por i kupton rrethanat e kërkuesit të fetvasë ose të palëve, merr parasysh gjendjen e tyre psikologjike dhe u ofron atyre këshilla dhe udhëzime.

SFIDA DHE PËRGJEGJËSIA ETIKE: DREJT NJË METODOLOGJIE TË MODERUAR NË PËRDORIM

Me të gjitha këto mundësi dhe rreziqe, ne duhet të jemi plotësisht të vetëdijshëm për sfidat që imponon ky zhvillim.

Anshmëria në të dhëna: Nëse sistemi trajnohet me të dhëna juridike që përfaqësojnë vetëm një medhheb ose një mendim ekstremist, ai do ta riprodhojë këtë anshmëri. Prandaj, pastrimi i të dhënave dhe garantimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirjes së tyre për shkollat e ndryshme juridike është thelbësor.

Gabimi dhe përgjegjësia: Sistemet e inteligjencës artificiale nuk janë të pagabueshme dhe mund të ofrojnë përgjigje të pasakta ose të paplota. Për këtë arsye, rishikimi njerëzor mbetet hapi i fundit dhe themelor, dhe përgjegjësia fetare bie vetëm mbi supet e njeriut.

Investimi në inteligjencën artificiale në çështjet fetare është një hap jetik drejt zhvillimit të metodologjisë juridike dhe promovimit të metodologjisë së moderuar dhe rrugës së mesme. Ai përfaqëson një mundësi për ta paraqitur fikhun islam në një formë moderne dhe lehtësisht të qasshme, që u shërben myslimanëve kudo që ndodhen. Por ky investim duhet të bëhet me urtësi dhe vetëdije, dhe inteligjenca artificiale duhet të mbetet një mjet në dorën e juristit, jo një zëvendësues për mendjen dhe ixhtihadin e tij, sepse urtësia është një gjë e humbur për besimtarin (ai e kërkon kudo që të jetë).

Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe: Vedat Shabani

Burimi: https://wasatyea.com/ar/content



Statusi i pasurisë dhe rregullat e trashëgimisë në Islam

Trashëgimia në Islam nuk është vetëm ndarje e pasurisë, por një sistem që synon drejtësinë, ruajtjen e të drejtave dhe forcimin e lidhjeve familjare. Përmes rregullave të përcaktuara, pasuria kalon ndër breza pa cenuar të afërmit dhe pa u përqendruar në një dorë të vetme. Në këtë mënyrë, dimensioni ekonomik lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë familjare dhe shoqërore.

Sistemi i trashëgimisë në Islam konsiderohet një nga shtyllat më të rëndësishme ligjore që ruan të drejtat pasurore dhe rregullon kalimin e pasurisë ndër breza. Për shkak të rëndësisë së tij, Vetë Allahu i Madhëruar i ka sqaruar në mënyrë të hollësishme shumicën e dispozitave në Kuranin fisnik, për të garantuar drejtësinë dhe për të parandaluar mosmarrëveshjet. Në këtë shkrim do të paraqesim statusin e pasurisë në Sheriat, do të thellohemi në rregullat e trashëgimisë dhe do të shqyrtojmë urtësinë hyjnore të këtij sistemi unik.

STATUSI I PASURISË DHE RËNDËSIA E SAJ NË ISLAM

Pasuria është, pa dyshim, një nga shtyllat mbajtëse të jetës. Përmes saj njerëzit shkëmbejnë shërbime dhe përfitime, bashkëpunojnë për përmbushjen e kërkesave e nevojave dhe ajo konsiderohet stoli e jetës së kësaj bote, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: *"Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote."* (El Kehf, 46).

Pasuria është, pa dyshim, një nga shtyllat mbajtëse të jetës. Përmes saj njerëzit shkëmbejnë shërbime dhe përfitime, bashkëpunojnë për përmbushjen e kërkesave e nevojave dhe ajo konsiderohet stoli e jetës së kësaj bote

Sheriati islam i ka trajtuar çështjet e pasurisë përmes rregullimit dhe udhëzimit në disa fusha:

- Në adhurime – përmes detyrimit të zekatit, i cili është pjesë e pasurisë që i pasuri e nxjerr për të varfrit dhe për interesat e përgjithshme, mbi të cilat mbështetet ekzistenca dhe rregullimi i jetës shoqërore. Me zekatin, shoqëria pastrohet, aq sa është e mundur, nga varfëria; forcohen lidhjet e afërsisë dhe dashurisë ndërmjet të pasurve dhe të varfërve; përhapen mëshira e bashkëpunimi dhe rritet ndjeshmëria e përbashkët.
- Në çështjet e gjendjes personale – përmes sistemit të trashëgimisë, i cili synon shpërndarjen e pasurisë, lidhjen e të afërmve me njëri-tjetrin dhe të brezave të mëparshëm me pasuesit e tyre, në mënyrë që fëmijët të mos privohen nga përpjekjet dhe mundi i prindërve.

RREGULLAT THEMELORE TË TRASHËGIMISË NË ISLAM

Sheriati islam e ka ndërtuar të drejtën e trashëgimisë mbi parime të drejta dhe të urta. Vetë Allahu, në Librin e Tij, ka marrë përsipër përcaktimin e pjesëve dhe shpërndarjen e tyre. Ndër këto rregulla janë:

Baza e përfitimit – Trashëgimia është ndërtuar mbi dy lloje marrëdhëniesh: lidhjen e gjakut, që përfshin prindërit, fëmijët dhe vëllezërit, dhe lidhjen bashkëshortore. Këto janë shkaqet e trashëgimisë.

Heqja e dallimit në vetë të drejtën – Janë hequr dallimet e gjinisë mashkull–femër dhe të moshës së vogël–të madhe në themelin e së drejtës së trashëgimisë. Si i vogli, ashtu edhe i madhi, mashkulli dhe femra, gëzojnë të drejtën themelore të trashëgimisë.

Mospërjashtimi i prindërve dhe fëmijëve – Prindërit dhe fëmijët, rrënjët dhe degët, nuk përjashtohen nga trashëgimia në asnjë rast, edhe pse pjesa e tyre mund të ndikohet nga prania e trashëgimtarëve të tjerë.

Përjashtimi i vëllezërve nga ana e babait – Vëllezërit dhe motrat nuk trashëgojnë kur është i pranishëm babai; megjithatë, prania e tyre ndikon në pjesën e nënës, e cila zbret nga një e treta në një të gjashtën.

Rregulli i shpërndarjes mes meshkujve dhe femrave – Kur ndër trashëgimtarët e së njëjtës shkallë ka meshkuj dhe femra së bashku, mashkulli merr sa dyfishi i femrës, për një urtësi që do të shpjegohet më vonë.

KUSHTET E PASURISË TRASHËGIMORE DHE TË TESTAMENTIT NË ISLAM

Islami e konsideron pasurinë që ndahet ndër trashëgimtarë si pasurinë neto të të ndjerit, pasi të jenë shlyer borxhet dhe të jenë zbatuar testamentet e lëna prej tij.

Për testamentin, Islami ka vendosur rregulla të qarta, ndër të cilat janë:

- Kufijtë e testamentit – Pejgamberi a.s. e ka kufizuar testamentin deri në një të tretën e pasurisë si kufi maksimal. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Sad bin ebi Vekasi r.a., i cili ka thënë: "I thashë: O i Dërguari i Allahut, a ta lë me testament të gjithë pasurinë time?" Ai tha: "Jo." Unë i thashë: "Po gjysmën?" Ai tha: "Jo." Unë i thashë: "Po një të tretën?" Ai tha: "Një të tretën, dhe edhe një e treta është shumë. Vërtet, më mirë është t'i lësh trashëgimtarët tu të pasur sesa t'i lësh të varfër, duke kërkuar lëmoshë nga njerëzit."
- Mosdëmtimi i trashëgimtarëve – Pasuria që trashëgimtarët ndajnë mbi këto parime është ajo që mbetet nga pasuria e trashëgimlënësit pas shlyerjes së borxheve dhe zbatimit të testamentit. Po ashtu, Islami ndalon testamentin për dikë që nuk ka nevojë për të, si dhe çdo testament që u shkakton dëm trashëgimtarëve.

Nga Ibën Abasi transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Dëmtimi në testament është prej mëkateve të mëdha." (Transmetim me zinxhir të ndërprerë; e kanë shënuar Darekutniu, Ukajliu dhe Taberaniu). Për borxhin dhe testamentin dëmtues, Allahu i Lartësuar thotë: "*... pasi të kryhet testamenti e të lahet borxhi, duke mos e dëmtuar askënd. Kjo është porosia e Allahut!*" (En Nisa, 12).

BURIMET E TRASHËGIMISË – AJETET E TRASHËGIMISË NË KURANIN FISNIK

Kurani fisnik, në suren En Nisa, i ka sqaruar në mënyrë të hollësishme pjesët e trashëgimtarëve në tri ajete të qarta dhe përfundimtare:

Në ajetin e 11-të, trajton pjesët e fëmijëve dhe të prindërve në raste të ndryshme.

Në ajetin e 12-të, trajton pjesët e bashkëshortëve dhe të vëllezërve e motrave nga nëna, si dhe thekson shlyerjen e borxhit dhe zbatimin e testamentit pa dëmtim.

Në ajetin e 176-të, trajton rastet e trashëgimisë së vëllezërve dhe motrave kur mungojnë pasardhësit dhe prindërit.

Urtësia e sistemit të trashëgimisë në Islam

Në Islam ka shumë parime dhe dispozita që e shembin tiraninë financiare të kapitalistëve, ashtu siç i japin fund kaosit të skajshëm të atyre që qëndrojnë në anën tjetër. Islami është rrugë e mesme: as tirani, as anarki. Ndërtimi i sistemit të trashëgimisë mbi këto baza përmban një urtësi të thellë, e cila duhet vlerësuar në jetën e burrit dhe të gruas, në familje dhe në shoqëri.



Urtësia në jetën e burrit dhe të gruas

Islami ka marrë parasysh se barrët e gruas, shpenzimet për fëmijët dhe kostot e martesës nuk janë vendosur mbi supet e saj, por mbi burrin. Prandaj, si drejtësi mes tyre, pjesa e burrit është dyfishi i pjesës së saj, në mënyrë që ai të jetë në gjendje t'i përballojë këto përgjegjësi. Dhënia e gjysmës së pjesës së burrit gruas është një masë mbrojtëse dhe parandaluese, për ta ruajtur nga pasojat dhe nga varësia që mund të lindë lidhur me burimin e shpenzimeve të saj.

Urtësia në jetën familjare

Shpërndarja e pasurisë ndërmjet të afërmve dhe bashkëshortëve e shton përkushtimin e zemrave, i lidh ato me njëra-tjetrën dhe bën që çdo individ të kujdeset për të mirën e të tjerëve. Nëse trashëgimia do t'i jepej vetëm një grupi, duke përjashtuar të tjerët, zemrat do të largoheshin dhe familja do të shpërbëhej.

Urtësia në jetën shoqërore

Islami, përmes sistemit të trashëgimisë, ka parandaluar dy rreziqe të mëdha shoqërore:

- Privimi i të afërmve – Ky sistem garanton që anëtarët e familjes të mos privohen nga frytet e përpjekjeve të prindërve dhe të afërmve të tyre, të cilët janë të lidhur mes vete përmes gjakut, farefisnisë dhe bashkëpunimit. Kështu, pasuria trashëgohet nga këta persona të ndërlidhur dhe nuk i jepet vetëm një personi, gjë që do të sillte tirani financiare; por as nuk i kalon shtetit, duke i privuar të gjithë nga frytet e përpjekjeve të prindërve, fëmijëve, bashkëshortëve dhe të afërmve. Ky do të ishte një dëm për shoqërinë, ndikimi i të cilit nuk do të ishte më i vogël, madje mund të ishte edhe më i madh, sesa tirania financiare. Të dyja janë të këqija për shoqërinë; të dyja përbëjnë padrejtësi dhe privim, dhe jeta nuk mund të funksionojë drejt me asnjërën prej tyre.
- Grumbullimi i pasurisë – Sistemi i trashëgimisë e pengon grumbullimin e pasurisë në një dorë të vetme, gjë që e zvogëlon tiraninë financiare dhe parandalon luftën e klasave.

RREGULLIMI I PASURISË – MËNYRAT E FITIMIT HALLALL NË ISLAM

Islami i ka rregulluar çështjet e pasurisë dhe ka sqaruar se ajo fitohet në mënyrë hallall përmes tregtisë, bujqësisë dhe industrisë. Këto tri mënyra i ka quajtur "kërkim i mirësisë së Allahut".

Tregtia – Islami e ka urdhëruar fitimin e pasurisë përmes tregtisë. Allahu ua përmendi kurejshitëve si mirësi udhëtimet e tyre tregtare drejt Jemenit dhe Shamit, të cilat ua kishte lehtësuar, dhe ua kujtoi dhuntinë e Tij. Allahu i Lartësuar thotë: *"(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin kurejsh, - për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë), - i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike."* (Kurejsh, 1–4).

> Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit." (El Hadid, 25).

Bujqësia – Islami e ka urdhëruar gjithashtu fitimin e pasurisë përmes bujqësisë, prej së cilës varet jeta dhe zhvillimi i Tokës. Duke tërhequr vëmendjen ndaj mirësisë së Allahut në përgatitjen e Tokës për mbjellje, Allahu i Lartësuar thotë: *"Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet: - Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk, - pastaj e çajmë Tokën në thellësi - dhe nxjerrim prej saj drithërat, - rrushin e perimet, - ullirin e palmat, - kopshtet e dendura, - pemët dhe gjithë barërat, - që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja."* (Abese, 24–32).

Industria – Islami e ka urdhëruar fitimin e pasurisë edhe përmes industrisë, e cila është një nga shtyllat më të forta mbi të cilat ndërtohen qytetërimet. Në Kuranin fisnik ka aludime për një sërë zejesh dhe industrish të domosdoshme për jetën:

- Industria e hekurit: Allahu i Lartësuar thotë: *"Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit."* (El Hadid, 25).
- Industria e veshmbathjes: Allahu i Lartësuar thotë: *"Ne ju dërguam rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim."* (El Araf, 26).
- Industria e ndërtimit të pallateve dhe godinave: Allahu i Lartësuar thotë: *"Asaj i thanë të hynte në pallat. Kur e pa atë, ajo kujtoi se ishte ujë i thellë dhe përvoli fustanin te këmbët. Sulejmani i tha: "Ky pallat është i shtruar me xhama."* (En Neml, 44).

Kështu, ai që i ndjek me vëmendje aludimet dhe udhëzimet e Kuranit fisnik gjen shumë theksime dhe nxitje lidhur me industri të ndryshme e llojet e tyre.

PËRPJEKJA PËR SIGURIMIN E FURNIZIMIT

Kujdesi i Kuranit ndaj pasurisë arriti deri aty sa urdhëroi përpjekjen për fitimin e saj menjëherë pas përfundimit të adhurimit javor të detyrueshëm, namazit të xhumasë. Ai nuk urdhëroi ndërprerjen e kërkimit të furnizimit, përveçse për këtë adhurim të veçantë. Allahu i Lartësuar thotë: *"O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë!"* (El Xhuma, 9). Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë: *"Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Allahut."* (El Xhuma, 10). Gjithashtu, për fitimin e pasurisë në përgjithësi, Allahu i Lartësuar thotë: *"Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai."* (El Mulk, 15).

MESATARJA NË SHPENZIM – AS SHPËRDORIM DHE AS KOPRRACI

Kurani fisnik ka urdhëruar që pasuria të shfrytëzohet në mënyrë të drejtë dhe ka ndaluar shpërdorimin e saj. Allahu i Lartësuar thotë: *"Edhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes."* (El Furkan, 67). Po ashtu, shpërdorimi i pasurisë dhe koprracia në përmbushjen e të drejtave e detyrimeve janë konsideruar shkak për pendim dhe qortim. Allahu i Lartësuar thotë: *"Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë."* (El Isra, 29).

RRUGËT E NDALUARA NË FITIMIN E PASURISË

Kurani, ashtu siç urdhëroi përpjekjen për fitimin e pasurisë dhe kërkoi mesataren në shpenzimin e saj, ndaloi edhe fitimin e saj nëpër rrugë që nuk sjellin të mira për njerëzit, por përmbajnë të keqe dhe shkatërrim. Ndër këto rrugë të ndaluara janë:

- Kamata, e cila merret duke shfrytëzuar nevojën e të dobëtit dhe nevojtarit.
- Vjedhja, grabitja dhe lypja, të cilat cenojnë sigurinë dhe stabilitetin.
- Tregtia me gjëra të ndaluara, të cilat e prishin mendjen dhe shëndetin, si alkooli dhe mishi i derrit.
- Bixhozi, vallëzimi dhe shitja e nderit, si dhe çdo gjë që e prish moralin dhe e dëmton njerëzillëkun.
- Ryshfeti, i cili i zhduk të drejtat dhe meritën.

Lidhur me këtë dhe gjëra të ngjashme, Kurani fisnik thotë: *"Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos u bëni mitëdhënës te gjykatësit për t'ua përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije njerëzve një pjesë të mallit."* (El Bekare, 188).

PËRKUJDESJA E LASHTË HYJNORE PËR SHENJTËRINË E PASURISË

Kujdesi i Allahut ndaj pasurisë është një ligj hyjnor i lashtë; Ai nuk e ka veçuar atë për një brez e jo për një tjetër, as për një shpallje e jo për një tjetër. Kurani fisnik na ka treguar se Allahu i ndëshkoi disa prej krijesave të Tij, të cilët u rebeluan ndaj urdhrit të Tij në Tokë dhe i hanin pasuritë e njerëzve padrejtësisht. Allahu i Lartësuar thotë: *"Ne ua ndaluam atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e Allahut. Për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta, dhe përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve."* (En Nisa, 160–161).

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Burimi:

مكانة المال وقواعد الميراث في الإسلام - إسلام أون لاين

https://islamonline.net/143567



Edebi i marrëdhënies me prindërit sipas "El Edeb el Mufred" të Imam Buhariut

Dr. Valon Myrta

Marrëdhënia me prindërit në Islam nuk kufizohet vetëm në bindje, por ndërtohet mbi mirënjohjen, mirësinë dhe përkujdesjen e vazhdueshme. Birr el-validejn e shndërron të drejtën e prindit në respekt, shërbim dhe ruajtje të dinjitetit të tij. Kjo përgjegjësi vazhdon edhe kur bindja ka kufij, madje edhe pas vdekjes së prindit.

HYRJE

Njeriu është qenie relacionale. Ai nuk e realizon qenien e vet jashtë marrëdhënies me Zotin, njerëzit dhe botën. Brenda këtij rrjeti lidhjesh, marrëdhënia me prindërit zë një vend të veçantë në arkitekturën morale të Islamit. Konceptet kuranore që e ndërtojnë këtë marrëdhënie lexohen si një lëvizje nga mirënjohja (*shukr*), te mirësia (*ihsan*) dhe prej saj te mirëgjerësia (*birr*). Tri dimensione të së njëjtës vetëdije morale. *Shukri* është njohja e së mirës së marrë; *ihsani* është përgjigjja ndaj saj me mirësi; ndërsa *birr-i* është kthimi i kësaj mirësie në një marrëdhënie të qëndrueshme me prindërit.

Pikënisja është *shukri*: *"Më falëndero Mua dhe prindërit tu"* (Lukman, 14). *Shukri* është të kujtosh dhe të pranosh të mirën që ke marrë nga prindërit: jetën, kujdesin dhe edukimin. Kjo mirënjohje shfaqet në *ihsan*, pra në fjalë të mira dhe vepra mirësie. Kur kjo mirësi bëhet e qëndrueshme, Kurani përdor gjuhën e *birr-it*. Për Jahjan dhe Isain a.s. thuhet se ishin (*berr-en*) ndaj prindërve të tyre (Merjem, 14, 32). *Berr* është ai tek i cili *birr-i* është bërë tipar i karakterit dhe i sjelljes së përditshme.

> Birr el validejn paraqitet te Buhariu si arkitektura e marrëdhënies fëmijë–prind, ndërsa edebi si inteligjenca e saj morale. Në këtë kuptim, birr el validejn është forma prindërore e edebit.

Kjo kornizë udhëheq analizën e 24 temave të para në *"El Edeb el Mufred"*. Në to, Buhariu e konkretizon normën kuranore në fjalë, shërbim, bindje dhe kufijtë e saj, mbrojtje të së drejtës dhe dinjitetit të prindit, pleqëri, dallim fetar, vdekje dhe lidhje që prindi lë pas. Njësia përfshin 46 transmetime: 29 *merfu*, 15 *mevkuf* dhe 2 *maktu*.[1]

Ato ndërthurin hadithin profetik me kuptimin dhe praktikën e sahabëve e të tabiinëve. Jo çdo transmetim i përfshirë në vepër ka të njëjtën shkallë hadithore. Prandaj, studimi dallon ndërmjet vlerës së transmetimit dhe rolit që ai luan brenda temës. Edhe një transmetim i kritikuar nga ndonjë muhadith[2] ka rëndësi për të kuptuar se si Buhariu e ka përzgjedhur dhe organizuar materialin.

Pyetja qendrore e studimit është: çfarë kuptimi moral të marrëdhënies me prindërit del nga titujt, transmetimet dhe renditja e tyre? Për këtë qëllim analizohen titulli i temës, përmbajtja e transmetimit dhe vendi i tyre në renditje. Hipoteza është se kjo renditje, ndonëse jo rreptësisht lineare, shpalos një strukturë që lëviz nga themelimi i së drejtës së prindit te konkretizimi, mbrojtja, kufizimi dhe vazhdimësia e saj. Teza është se *birr el validejn* paraqitet te Buhariu si arkitektura e marrëdhënies fëmijë–prind, ndërsa edebi si inteligjenca e saj morale. Në këtë kuptim, *birr el validejn* është forma prindërore e edebit.

HAPJA KURANORE: NORMA PARA FORMËS

Njësia e *birr el-validejn* hapet me fjalën e Allahut: *"Ne e porositëm njeriun të sillet mirë (husn) me prindërit e vet."* (El Ankebut, 8), e cila nxjerr një normë që i jep kuptim çdo sjelljeje. Lidhja biologjike krijon afërsinë, ndërsa shpallja e njeh atë si të drejtë dhe e kthen në përgjegjësi. Fjala qendrore është mirësia – *husni*. Para se të përcaktojë format konkrete të sjelljes ndaj prindit, ajeti vendos cilësinë morale që duhet ta udhëheqë marrëdhënien. Prandaj, *norma i paraprin formës*.

Vazhdimi i ajetit vendos edhe kufirin e bindjes: *"Nëse ata përpiqen që të më shoqërosh Mua diçka për të cilën ti nuk ke dije, atëherë mos iu bind atyre."* (El Ankebut, 8). Pra, e drejta e prindit nuk është e pakufizuar. Kur kërkesa bie ndesh me një të drejtë më të madhe,

bindja ndalet. Ndërsa një ajet tjetër e plotëson këtë parim: *"Mos iu bind atyre, por shoqëroji në këtë botë me mirësi."* (Lukman, 15). Kështu, teksti kuranor bashkon *kufirin e bindjes dhe vazhdimin e mirësisë*. Bindja (*ta'ah*) është prej formave të *birr*-it, por nuk e përmbledh atë. Po ashtu, jo çdo mosbindje është *ukuk*, por vetëm cenimi i pajustifikuar i së drejtës së prindit.[3] Prandaj, *kufiri i bindjes nuk është kufiri i mirësisë*.

KONKRETIZIMI HADITHOR: FORMA E NORMËS

Renditja e Buhariut sugjeron se *birr-i* është konkretizimi i normës kuranore të *husn-it* në marrëdhënien prindërore. Në El Bekare, 177, *birr-i* përfshin besimin, dhënien e pasurisë, namazin, zekatin, besnikërinë dhe durimin, kurse në El Maide, 2, lidhet me *takvanë*: *"Bashkëpunoni në birr dhe takva."* Maturidiu e përkufizon *birr-in* si emër për çdo të mirë, ndërsa *takvanë* si largim nga çdo e keqe.[4] Maverdiu e lidh me *ihsanin* dhe me *silen* - ruajtjen e lidhjeve ndërmjet njerëzve.[5]

Edhe Suneti e paraqet *birr*-in si vlerë të gjerë morale që rrjedh nga vërtetësia dhe shpie në Xhenet. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Vërtetësia çon te birr-i, ndërsa birr-i çon në Xhenet."[6]; ndërsa në një formulim tjetër e përmbledh: "Birr-i është karakteri i mirë."[7] (Merjem, 14 dhe 32). *Birr*-i paraqitet si mënyrë e të qenit në marrëdhënie që përjashton arrogancën dhe vetëqendërsinë.

Prej këtej dallohen tri nivele të lidhura: *birr* - mirëgjerësia; *barr* - njeriu që e ka përvetësuar këtë vlerë në karakterin e vet; dhe *birr el validejn* – zbatimi i saj në marrëdhënien prindërore.

Kuptimi gjuhësor, gjithashtu, e tregon gjerësinë e *birr*-it. Ragib el Isfahani e lidh atë me gjerësinë e së mirës, sikurse fjala *berr*, nga e njëjta rrënjë, emërton tokën e gjerë.[8] Për këtë arsye, në traditën islame kjo fjalë përdoret për një fushë të gjerë të së mirës.[9]

Në këtë studim, *birr el validejn* kuptohet si *jetësimi moral i së drejtës së prindit, të cilën fëmija e njeh përmes vetëdijes për origjinën, kujdesin dhe sakrificën e tij dhe së cilës kujtesë i përgjigjet duke e shndërruar mirënjohjen në respekt, përkujdesje, ruajtje të dinjitetit, shmangie të lëndimit, ndjeshmëri ndaj cenueshmërisë, respektim të kufirit moral të bindjes, përgjegjësi për pasojat dhe vazhdimësi të së mirës edhe pas vdekjes*.

Brenda kësaj strukture dallohen katër nivele: *edebi* është inteligjenca morale e marrëdhënies; *husn-i* cilësia e saj; *birr el validejn* është realizimi prindëror i kësaj inteligjence dhe cilësie. Fjala e mirë, bindja, shërbimi, përkujdesja, moslëndimi dhe ruajtja e lidhjeve janë format konkrete të tij. Prandaj, *birr el validejn* është forma prindërore e edebit. Edebi i mëson fëmijës jo vetëm *çfarë* të bëjë, por edhe *si*, *kur*, *deri ku* dhe *përse* ta bëjë.

ARKITEKTURA E MARRËDHËNIES FËMIJË–PRIND

Vlera e përkufizimit të mësipërm provohet në organizimin e temave dhe transmetimeve. Këtu tema trajtohet si njësi interpretimi, jo vetëm si klasifikim tematik. Njësia lexohet jo vetëm sipas përmbajtjes së teksteve, por edhe sipas funksionit të secilit



në strukturën e tërësishme. Kështu, transmetimi jep materialin, titulli përcakton këndin e leximit, ndërsa renditja e lidh me atë që e paraprin dhe e pason. Në këtë optikë, 24 temat shpalosin një arkitekturë të *birr*-it, e cila mund të lexohet përmes tetë boshteve:

E drejta: Çfarë pozite dhe përparësie ka prindi?

Kujtesa: Çfarë historie të marrëdhënies duhet të mbajë mend fëmija?

Forma: Si shndërrohet *birr-i* në fjalë dhe veprim?

Mbrojtja: Çfarë shmanget që të mos cenohen e drejta dhe dinjiteti i prindit?

Cenueshmëria: Si ndryshon përgjegjësia kur prindi dobësohet?

Kufiri i bindjes: Deri ku shkon bindja ndaj prindit?

Pasoja: Çfarë pasojash sjell sjellja e fëmijës në marrëdhënie?

Vazhdimësia: Çfarë mbetet nga *birr-i* pas vdekjes së prindit?

Këto boshte janë model analitik dhe jo një klasifikim që i atribuohet Buhariut, si dhe nuk janë ndarje të mbyllura, prandaj një temë ose transmetim mund të prekë më shumë se një bosht.

E DREJTA: MARRËDHËNIA FILLON ME NJOHJEN

Marrëdhënia prindërore i paraprin vullnetit të njeriut. Para se të mund të jepte, ai ishte marrës i jetës, ushqimit, mbrojtjes dhe përkujdesjes. Edebi fillon kur njeriu mëson t'i përgjigjet moralisht një marrëdhënieje që nuk e ka krijuar vetë.



Tema e parë fillon me një hadith që e vendos *birr*-in në hierarkinë e veprave fetare. Kur Abdullah ibën Mesudi r.a. e pyet të Dërguarin a.s. për veprën më të dashur tek Allahu, ai përgjigjet: "Namazi në kohën e tij; pastaj birr-i ndaj prindërve; pastaj xhihadi në rrugën e Allahut."

Birr-i vendoset ndërmjet namazit, që strukturon marrëdhënien e përditshme me Allahun, dhe xhihadit, që kërkon sakrificë përtej vetes. Kujdesi ndaj prindit hyn kështu në hierarkinë e veprave përmes të cilave matet përgjegjësia fetare e njeriut. Hadithi korrigjon edhe prirjen për të kërkuar vepra të mëdha e të dukshme, duke lënë në hije detyrimet e heshtura ndaj të afërmve. Përkujdesja ndaj prindit të moshuar mund të mos ketë dukshmëri publike, por kërkon durim, kohë, kontroll të egos dhe shërbim të vazhdueshëm; pikërisht kjo e bën marrëdhënien shkollë të karakterit.

Parimin e thellon fjala e Abdullah ibën Omerit r.a.: "Kënaqësia e Zotit është në kënaqësinë e prindit, ndërsa zemërimi i Zotit është në zemërimin e prindit." Brenda kufijve të së drejtës prindërore, trajtimi i prindit merr peshë në marrëdhënien e njeriut me Allahun. Kështu, transmetimi i parë përcakton rangun e *birr-it*, ndërsa i dyti peshën morale të së drejtës së prindit.

Vetëm pasi themelohet kjo e drejtë, Buhariu hap temën e dytë me nënën dhe të treten me babanë.[10] Në pyetjen: "Kujt t'i bëj birr?", Pejgamberi a.s. përgjigjet tri herë: "Nënës sate" dhe vetëm më pas: "babait tënd". E drejta e të dy prindërve është e përbashkët në themel, por jo e barabartë në shkallën e përparësisë. Ibën Batali e lidh përparësinë e nënës me tri barrët e saj të veçanta: shtatzëninë, lindjen dhe gjidhënien.[11]

Këtë pozitë e thellon transmetimi për njeriun që kishte vrarë një grua dhe kërkonte rrugë pendimi. Ibën Abasi e pyeti: "A është gjallë nëna jote?" dhe më pas pohoi se nuk njihte vepër që e afronte njeriun tek Allahu më shumë se *birr*-i ndaj nënës.

Tri temat e para vendosin themelin: prindi gëzon të drejtën që buron nga prindëria; kjo e drejtë ka peshë para Allahut; dhe brenda saj ekziston një rend përparësie ndërmjet nënës dhe babait në *birr*, jo domosdoshmërisht në bindje. Juristët kanë qëndrime të ndryshme kur urdhrat e prindërve bien ndesh. Fëmija duhet të ruajë, sa të jetë e mundur, të drejtën e të dyve. Vetëm pasi themelohet kjo e drejtë, mund të flitet për format e realizimit të saj në temat vijuese.

KUJTESA: E DREJTA KA NJË HISTORI

E drejta nuk lind në zbrazëti. Pas saj qëndron një histori. Kësisoj, marrëdhënia prindërore nuk mund të reduktohet në një llogari barazimi sipas logjikës "më dhe kaq, po të kthej po aq", sepse ndryshon konteksti emocional. Në fillimin e saj, njëra palë jepte duke uruar dhe pa pritur kthim, ndërsa tjetra nuk ishte ende në gjendje as të kuptonte se po merrte. Kjo del në pah veçanërisht në temën e gjashtë "*Shpërblimi i prindërve*". Pejgamberi a.s. ka thënë: "Fëmija nuk ia shpërblen dot prindit të tij, përveçse nëse e gjen sklav, e blen dhe e liron." Këtë ide e bën të prekshme rrëfimi i burrit nga Jemeni që e bartte nënën në shpinë gjatë tavafit. Kur e pyeti Ibën Omerin nëse ia kishte shpërblyer të mirën, ai iu përgjigj: "Jo, as edhe një ofshamë të vetme (gjatë lindjes)." Fëmija mund ta bartë nënën në shpinë rreth Qabesë, por nuk mund ta kthejë kohën pas dhe të përjetojë dhimbjen me të cilën ajo e solli në jetë.

Këtu qëndron funksioni i kujtesës. Fëmija duhet të mbajë moralisht të pranishme një periudhë që vetë nuk mund ta kujtojë. Ai që sot ecën vetë, dikur është bartur; ai që sot ushqen, dikur është ushqyer; ai që sot mund të lodhet nga nevojat e prindit, dikur ka jetuar përmes durimit të tij. Pra, e drejta e prindit ka një histori dhe *birr*-i kërkon që fëmija të mos e humbë kujtesën morale të saj.

FORMA: SI SHNDËRROHET BIRR-I NË SJELLJE?

Njohja e së drejtës dhe kujtesa e historisë së saj nuk mjaftojnë pa marrë formë në sjellje. Buhariu e hap temën e pestë, *Butësia në të folur me prindërit*, me këshillën që Ibën Umeri ia dha një burri prej havarixhëve, i cili kërkonte të shlyente veprat e këqija. Pasi mësoi se ai e kishte të gjallë vetëm nënën, i tha: "Nëse i flet butë dhe e ushqen, do të hysh në Xhenet, përderisa u shmangesh mëkateve të mëdha."

Fjala e butë dhe ushqimi vendosen pranë njëra-tjetrës: njëra prek botën emocionale të prindit, tjetra nevojën materiale. *Birr*-i, pra, nuk është vetëm ndjenjë dhe as vetëm përkujdesje praktike. Mund ta ushqesh prindin dhe ta lëndosh me tonin; mund t'i flasësh bukur dhe të mungosh kur ka nevojë.

Këtë kuptim e thellon etheri pasues i Urve bin Zubejrit, i cili fjalën e Allahut: *"Dhe nga mëshira shtrije për ta krahun e mëshirës"*, e shpjegon: "Mos lër pa bërë atë që ata e duan." Kërkesat e lejueshme të prindërve, pra, përmbushen me gatishmëri dhe butësi.

Në fund të njësisë, te transmetimi 44, Buhariu kthehet te hollësitë e formës. Ebu Hurejra r.a., kur sheh një burrë duke ecur me babanë e tij, i thotë: "Mos e thirr me emër dhe mos ec as mos u ul para tij." Tema e fundit, me transmetimet 45 dhe 46, trajton adresimin e babait me kunja, si shprehje e respektit në traditën arabe të ruajtur edhe në Islam. Në të parin, Salimi e thërret babanë e tij, Abdullah ibën Umerin, me kunjin *Ebu Abdurrahman*; në të dytin, Abdullahu e përmend babanë e tij, Umerin, me kunjin *Ebu Hafs*.

Kjo kthesë është domethënëse: njësia nis me normën e madhe kuranore dhe përfundon me mënyrën e të folurit, të ulurit dhe të ecurit, duke treguar se *norma e madhe merr formë në gjestin e vogël*.

MBROJTJA: ÇFARË DUHET SHMANGUR QË PRINDI TË MOS CENOHET?

Mbrojtja ka dy nivele: të mos e cenosh vetë prindin dhe të mos bëhesh shkak që cenimi t'i vijë nga të tjerët. Marrëdhënia nuk ndërtohet vetëm duke përcaktuar të mirën që duhet bërë; ajo mbrohet edhe duke përcaktuar dëmin që duhet shmangur.

Në temat 6-8 dhe 14-16, përmes transmetimeve 13–17 dhe 27–31, Buhariu shpalos hartën e plagëve që fëmija mund t'ua shkaktojë prindërve. Disa janë të drejtpërdrejta, të tjera mbërrijnë te ta tërthorazi. Atij që i kishte lënë prindërit duke qarë, Pejgamberi a.s. i tha: "Kthehu tek ata dhe bëji të qeshin, ashtu siç i bëre të qajnë." Ibën Umeri e rendit shkaktimin e pajustifikuar të kësaj dhimbjeje ndër mëkatet e mëdha: "E qara e prindërve është prej ukuk-ut dhe mëkateve të mëdha."

Në transmetimin e Ebu Bekres r.a., Pejgamberi a.s. e rendit *ukuk*-un ndaj prindërve ndër mëkatet më të mëdha, pranë shirkut, për të treguar rëndesën e tij. Në këtë kuadër, Buhariu nuk sjell vetëm ndalimin e mallkimit të prindërve, por edhe përgjegjësinë për t'u bërë shkak që ata të fyhen, si kur njeriu fyen prindin e tjetrit dhe ky ia kthen duke fyer prindërit e tij. Fjala e hedhur kundër tjetrit kthehet mbi shtëpinë prej së cilës ka dalë. Fëmija bëhet përgjegjës jo vetëm për cenimin që kryen vetë, por edhe për atë që ua sjell prindërve përmes të tjerëve.

Fjala, toni, braktisja dhe përçmimi mund ta cenojnë thellë marrëdhënien edhe pa lënë plagë fizike. Kështu, cenimi nuk fillon vetëm kur fëmija ngre dorën apo zërin kundër prindit; ai fillon sa herë që bëhet shkak i lotit, pikëllimit, poshtërimit ose prishjes së imazhit të tij. Kjo nuk do të thotë se çdo lot ose pakënaqësi e prindit e bën fëmijën fajtor; përcaktues është shkaktimi i pajustifikuar i dhimbjes ose cenimi i të drejtës. *Ukuk*-u, kështu, është *cenim i pajustifikuar i së drejtës dhe dinjitetit të prindit*, jo çdo mosbindje.

CENUESHMËRIA: KUR PËRGJEGJËSIA RRITET

Jo të gjitha fazat e marrëdhënies kërkojnë të njëjtën masë kujdesi. Nevoja, sëmundja, pleqëria e ndryshojnë ekuilibrin: ai që dikur mbante, tani mund të ketë nevojë të mbahet. Këtë përmbysje të roleve e shpreh tema 6, *Shpërblimi i prindërve*, veçanërisht transmetimi 14, në dialogun e Ebu Hurejrës me nënën e tij. Ai i thoshte: "Allahu të mëshiroftë, ashtu siç më rrite kur isha i vogël." Ajo i përgjigjej: "Allahu të mëshiroftë, ashtu siç u solle mirë me mua kur u plaka."[12] Kujdesi i marrë në fëmijëri kthehet në përgjegjësi ndaj prindit në pleqëri.

Këtë kuptim e thekson drejtpërdrejt tema 10, *Ai që i arrin prindërit, por nuk hyn në Xhenet*, përmes transmetimit 21. Pejgamberi a.s. e qorton ashpër atë që e arrin pleqërinë e njërit ose të dy prindërve, por nuk e fiton Xhenetin përmes përkujdesjes ndaj tyre.

Kurani e lidh pikërisht këtë fazë me një kujdes të veçantë: *"Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë pranë teje, mos u thuaj as 'uf'."* (El Isra, 23). Fjalëza *uf* përfaqëson shenjën minimale të bezdisë. Nëse ndalohet ajo, çdo formë më e rëndë lëndimi ndalohet edhe më fort.

Dobësia e prindit nuk ia zvogëlon të drejtën, por ia rrit fëmijës përgjegjësinë. Dikur dobësia e fëmijës thërriste mëshirën e prindit; tani dobësia e prindit duhet të zgjojë mëshirën e fëmijës. *Sa më e madhe nevoja e prindit, aq më shumë birr-i kalon nga respekti në përkujdesje aktive.*

KUFIRI I BINDJES: DERI KU SHKON TA'AH?

Pesha e së drejtës prindërore shtron domosdoshmërisht pyetjen për kufirin e saj.

Tema 4, *Birr-i ndaj prindërve edhe nëse bëjnë padrejtësi*, përmban transmetimin 7 të Ibën Abasit. Meqë senedi i tij është kritikuar, ai nuk mund të mbajë i vetëm një normë juridike. Megjithatë, titulli ngre një pyetje thelbësore: a shuhet e drejta e prindit sapo ai sillet padrejtësisht? Përgjigjja më e qartë vjen nga parimi kuranor: edhe kur prindi kërkon atë që nuk lejohet, urdhri për shoqërim me mirësi mbetet. Pra, kuptimi i hadithit është i saktë: *padrejtësia e prindit nuk e anulon birr-in ndaj tij*. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se prej *birr*-it është edhe durimi i vetë padrejtësisë. Norma islame thekson qartë se "dëmi ndalet", pavarësisht se kush e shkakton atë. Prandaj, fëmija e mbron veten prej padrejtësisë pa e shndërruar këtë në *ukuk*, përderisa ruan kufijtë e respektit dhe nuk kalon vetë në padrejtësi.

Përgjigjja më e qartë për kufirin e bindjes vjen nga tema 9, *T'u bëhet birr prindërve përderisa nuk ka mëkat*, që përfshin transme-

timet 18–20. Vetë titulli vendos kufirin: përderisa nuk ka mëkat. Brenda saj, urdhri profetik drejtuar Ebu Derdasë, "bindju prindërve", konkretizohet me dy transmetime vijuese. Ai që kishte lënë prindërit duke qarë për hixhret urdhërohet të kthehet dhe t'i bëjë të qeshin, ndërsa atij që kërkon vullnetarisht të marrë pjesë në xhihad i thuhet: "Tek ata bëje xhihadin tënd." Juristët e kanë zbatuar të njëjtin parim edhe te udhëtimi: ai që përmban rrezik serioz nuk ndërmerret pa lejen e prindërve, ndërsa udhëtimi i sigurt lejohet nëse fëmija nuk i lë pa përkujdesjen që u nevojitet.[13]

> "Tri lutje janë të pranuara, pa dyshim: lutja e të dëmtuarit, lutja e udhëtarit dhe lutja e prindit kundër fëmijës së tij."

Ky dallim bëhet edhe më i qartë në raport me prindin jomysliman. Tema 12, përmes transmetimit 23, kufizon kërkimin e faljes prej Zotit për prindin e vdekur mushrik; ndërsa tema 13, përmes transmetimeve 24–26, ruan detyrimin e *birr*-it ndaj tij pavarësisht besimit. Dallimi fetar nuk e anulon mirësinë. Rasti i Sad ibën ebi Vekasit me nënën që e ndalte nga feja e përmbledh këtë parim kuranor: *"Mos iu bind atyre (në mëkat), por shoqëroji në këtë botë me mirësi."* (Lukman, 15). Brenda një ajeti qëndrojnë së bashku dy urdhra: mosbindja në mëkat dhe vazhdimi i mirësisë. Të njëjtin parim e dëshmon edhe rasti i Esma bint Ebi Bekrit r.a. me nënën e saj mushrike, ku urdhërohet ta mbajë lidhjen me të. Këtë vijë e plotëson tema 18, ku Ebu Hurejra r.a. përpiqet ta ftojë nënën e tij të krishterë në Islam. Kur ajo thotë diçka që e lëndon për Pejgamberin a.s., ai nuk e ndërpret marrëdhënien me të, por kërkon prej Pejgamberit që të lutet për udhëzimin e saj. Pas lutjes së tij, ajo e pranon Islamin. Këtu shfaqet edhe një dimension tjetër i *birr*-it ndaj prindit, kujdesi për të mirën shpirtërore të prindit. Kështu, temat formojnë një vijë të plotë: nuk ka bindje në mëkat, por marrëdhënia, mirësia dhe kujdesi vazhdojnë. *Kufiri i bindjes nuk është kufiri i mirësisë.*

Prej këtej dallohen tri nocione: 1) *ta'ah* është bindja ndaj kërkesës së lejueshme të prindit brenda kufijve të së drejtës së tij; 2) *birr* është fusha më e gjerë e mirësisë, respektit dhe përkujdesjes; 3) *ukuk* është cenimi i pajustifikuar i së drejtës së prindit. Prandaj, jo çdo mosbindje është *ukuk*.

Nëse kërkesa përmban mëkat, dëm ose cenim të së drejtës së një pale tjetër, bindja nuk kërkohet. *E drejta e prindit nuk e shfuqizon të drejtën e një pale tjetër; refuzohet kërkesa, jo marrëdhënia, sepse edhe mënyra e refuzimit mbetet nën normën e birr-it.* Përmbushja e të drejtave të prindërve është *farz ajn*, por kjo nuk u jep atyre autoritet të pakufizuar mbi jetën e fëmijës. Bindja lidhet me kërkesat që burojnë nga të drejtat reale të prindit – si respekti, përkujdesja, mbështetja dhe shmangia e dëmit –, jo me çdo dëshirë ose preferencë të tij. Prandaj, kërkesat që kufizojnë zgjedhjet e ligjshme personale të fëmijës, pa mbrojtur ndonjë nevojë ose të drejtë reale të prindit, nuk janë vetvetiu detyruese. Bindja kërkohet për aq sa kërkesa është brenda së drejtës së prindit dhe nuk përmban mëkat, dëm të konsiderueshëm ose padrejtësi ndaj fëmijës apo të tjerëve.

PASOJA: MARRËDHËNIA KA JEHONË

Sjellja ndaj prindit nuk mbyllet në çastin kur kryhet; në strukturën e Buhariut ajo paraqitet si marrëdhënie me pasoja.

Tema 11 titullohet: *Atij që u bën birr prindërve, Allahu ia shton jetën*. Transmetimi nr. 22 ka sened të kritikuar dhe mbi të nuk mund të mbështetet i vetëm një pohim i tillë për zgjatjen e jetës. Megjithatë, vendosja e tij në këtë pozitë tregon idenë tematike se *birr*-i nuk paraqitet si veprim pa jehonë. Ana tjetër shfaqet në temën *Ndëshkimi i ukuk-ut ndaj prindërve*. Hadithi nr. 29 nuk e përmend drejtpërdrejt *ukuk*-un, por flet për padrejtësinë *(bag'j-in)* dhe prerjen e lidhjeve farefisnore si mëkate, ndëshkimi i të cilave mund të përshpejtohet edhe në këtë botë. Transmetimi nr. 30 e përmend drejtpërdrejt *ukuk*-un në mesin e mëkateve më të mëdha. Edhe pse senedi ka vërejtje, kuptimi i hadithit mbështetet nga transmetime të tjera. Kjo tregon rëndësinë e dallimit ndërmjet funksionit tematik të një transmetimi dhe fuqisë së tij hadithore.

Një formë tjetër e pasojës shfaqet te lutja e prindit. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Tri lutje janë të pranuara, pa dyshim: lutja e të dëmtuarit, lutja e udhëtarit dhe lutja e prindit kundër fëmijës së tij." Buhariu e pason këtë me rrëfimin e Xhurejxhit, i cili nuk iu përgjigj thirrjes së nënës dhe u përball me pasojën e lutjes së saj.

Kështu, marrëdhënia fëmijë-prind lë pasoja morale dhe jetësore përtej momentit të veprimit.

VAZHDIMËSIA: ÇFARË MBETET PAS VDEKJES?

Në pamje të parë, vdekja mund të duket si kufiri përfundimtar i marrëdhënies. Por pikërisht këtu Buhariu hap një fazë tjetër të *birr*-it. Pyetja shtrohet drejtpërdrejt: "A ka mbetur diçka nga birr-i ndaj prindërve të mi pas vdekjes së tyre?"

Transmetimi nr. 35 përmend lutjen, istigfarin, përmbushjen e zotimeve, nderimin e miqve dhe ruajtjen e lidhjeve farefisnore. Meqë senedi është i kritikuar, këto kuptime nuk mbështeten vetëm në të. Transmetimet 36-39 japin mbështetje më të fortë për ngritjen e gradës së të vdekurit për shkak të istigfarit të fëmijës për të, për lutjen e fëmijës së mirë dhe sadakanë në emër të prindit. Pra, vdekja nuk e shuan *birr*-in, vetëm ia ndryshon formatin në të cilat ai vazhdon.

Buhariu e zgjeron vazhdimësinë e *birr*-it edhe përtej veprave që i drejtohen vetë prindit. Në temat 20-22 ai kalon te njerëzit që prindi ka dashur. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Vërtet, prej formave më të larta të birr-it është që njeriu të mbajë lidhjet me njerëzit që babai i tij i ka dashur." Meqë senedet e transmetimeve nr. 40, 42 dhe 43 janë kritikuar, ato mbeten me interes për të kuptuar shtrirjen tematike të njësisë, ndërsa pesha kryesore normative mbështetet në transmetimin nr. 41, kuptimi i të cilit vërtetohet



edhe në Sahihun e Muslimit.[14] Më pas, Buhariu paralajmëron kundër ndërprerjes së këtyre lidhjeve dhe e përmbyll këtë vijë me temën domethënëse: *"Dashuria trashëgohet."*

Kjo tregon se prindi nuk lë pas vetëm pasuri apo detyrime, por edhe një botë marrëdhëniesh. Miqtë, lidhjet dhe kujtimet janë pjesë e kësaj bote, të cilat fëmija thirret t'i ruajë.

Kështu, *birr*-i pas vdekjes së prindit vazhdon në tri rrafshe: shpirtëror, përmes lutjes dhe istigfarit; material, përmes sadakasë dhe përmbushjes së detyrimeve; dhe shoqëror, përmes ruajtjes së lidhjeve të prindit. Pra, *vdekja nuk është fundi i birr-it; është ndryshimi i formës së tij*.

PËRFUNDIME

Ky studim dëshmon se njësia *birr el validejn* në *"El Edeb el Mufred"* zotëron koherencë të plotë tematike. Titujt e temave, përzgjedhja e transmetimeve dhe renditja e tyre ndërtojnë një koncept të integruar të marrëdhënies fëmijë-prind. Nga analiza dalin këto rezultate shkencore:

· Titulli orienton mënyrën se si transmetimi lexohet dhe lidhet me tërësinë. Kjo e bën të nevojshëm leximin e titullit, transmetimit dhe renditjen si një strukturë të vetme.

· Tetë boshtet – e drejta, kujtesa, forma, mbrojtja, cenueshmëria, kufiri i bindjes, pasoja dhe vazhdimësia – janë modele analitike të nxjerra nga korpusi, jo një klasifikim i Buhariut.

· *Birr-i* është më i gjerë se bindja (*ta'ah*) dhe lidhet me kërkesën e ligjshme brenda së drejtës së prindit. Kur bindja ndalet për shkak të mëkatit, dëmit ose cenimit të një të drejte tjetër, *birr-i* vazhdon në formën e respektit, mirësisë dhe moslëndimit. Prandaj, *ukuk*-u nuk është çdo mosbindje, por cenimi i pajustifikuar i së drejtës së prindit. Mirësia vazhdon edhe kur bindja ndërpritet.

· Fuqia hadithore duhet dalluar nga funksioni tematik. Transmetimet me sened të kritikuar nuk përdoren të vetme për themelimin e normave juridike; megjithatë, vendosja e tyre mbetet relevante për analizimin e ndërlidhjeve që plotësojnë kuadrin etik dhe ilustrojnë zbatimin moral të *birr*-it, ndërsa kuptimet e tyre vlerësohen në dritën e teksteve më të forta.

· *Birr el validejn* është forma prindërore e edebit. Ai e shndërron njohjen e së drejtës në sjellje, mirënjohjen në përgjegjësi dhe lidhjen familjare në disiplinë morale që vazhdon edhe përtej jetës së prindit, sa kohë që mbetet e gjallë kujtesa dhe trashëgimia e tij.

1 Muhamed b. Ismail el Buhari, El Edeb el Mufred, red. Muhamed Fuad Abdulbaki, bot. 3 (Bejrut: Dar el Besha'ir el Islamijje, 1409/1989), nr. 1–46.

2 Muhamed b. Ismail el Buhari, El Edeb el Mufred, hadithet i verifikoi Muhamed Nasiruddin el Albani, bot. 2 (Dar es Siddik, 1421 h./2000), 13-29.

3 Ahmed b. Ali b. Haxher el Askalani, Feth el Bari bi sherh Sahih el Buhari, red. Muhibuddin el Hatib (Bejrut: Dar el Ma'rife, 1379 h.), 10:406; shih edhe Bedruddin Mahmud b. Ahmed el Ajni, Umdet el Kari sherh Sahih el Buhari (Bejrut: Dar Ihja et Turath el Arabi, pa vit), 22:86.

4 Muhamed bin Muhamed el Maturidi, Te'vilatu Ehli's Sunne, red. Mexhdi Muhamed Baslum, 10 vëll. (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmijje, 1426/2005), 3:444.

5 Ali b. Muhamed el Maverdi, Edeb ed Dunja ve ed Din, red. Mustafa es Sekka, bot. 4 (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmijje, 1398/1978), 184–185.

6 Muhamed b. Ismail el Buhari, Sahih el Buhari, red. Muhamed Zuhejr b. Nasir en Nasir, 9 vëll. (Bejrut: Dar Tavk en Nexhat, 1422 h.), 8:25, nr. 6094; Muslim b. el Haxhaxh en Nejsaburi, Sahih Muslim, red. Muhamed F. Abd el Baki, 5 vëll. (Bejrut: Dar Ihja et Turath el Arabi, pa datë), 4:2012, nr. 2607.

7 Muslim b. el Haxhaxh en Nejsaburi, Sahih Muslim, red. Muhamed Fuad Abd el Baki (Bejrut: Dar Ihja et Turath el Arabi, pa datë), 4:1980, nr. 2553.

8 Err Rragib el Isfahani, Mufredatu elfadh el Kur'an, red. Safvan Adnan Davudi (Damask: Dar el Kalem; Bejrut: El Dar esh Shamijje, 2009), 114.

9 Shih përdorimet kryesore të rrënjës b-r-r në Kuran, veçanërisht El Bekare, 177 dhe El Maide, 2; krahaso Ali Toksari, "BİRR," TDV İslâm Ansiklopedisi, vëll. 6 (Stamboll: Türkiye Diyanet Vakfı, 1992), 204–205.

10 Në temën e dytë dhe të tretë, Buhariu sjell transmetime të ngjashme, por me dallime në metn dhe sened që ofrojnë të dhëna me interes për studiuesit e hadithit, por analiza e tyre del jashtë kufijve të këtij studimi.

11 Ali b. Halef ibën Battal, Sherh Sahih el Buhari, red. Ebu Temim Jasir b. Ibrahim, bot. 2 (Riad: Mektebet er Rushd, 1423/2003), 9:189.

12 Dialogu është edhe në transmetimin 12, por me sened të kritikuar.

13 Alauddin ebu Bekr ibën Mesud ibën Ahmed el Kasani el Hanefi, Bedaiu es sanai fi tertib esh sherai, bot. 2 (Bejrut: Dar el Kutub el Ilmijje, 1406 h./1986), 7:98. Ai përcjell mendimin e disa dijetarëve hanefi sipas të cilëve lejohet udhëtimi për dije edhe pa lejen e prindërve, për arsye se ata jo vetëm që nuk dëmtohen, por mund të përfitojnë nga frytet e dijes së fëmijës. Për këtë arsye, një veprim i tillë nuk merr cilësimin e ukuk-ut.

14 Muslim b. el Haxhaxh en Nejsaburi, Sahih Muslim, red. Muhamed Fuad Abd el Baki (Bejrut: Dar Ihja et Turath el Arabi, pa datë), 4:1979, nr. 2552.



Fëmijët tanë po rriten nga prindërit apo nga ekranet?

Nada Dosti

Epoka digjitale po e ndryshon thellësisht marrëdhënien mes prindërve dhe fëmijëve. Ekranet nuk e zëvendësojnë familjen, por përdorimi i pakontrolluar i tyre mund ta dobësojë praninë, komunikimin dhe rolin edukues të prindit. Sfida kryesore sot është ta ruajmë familjen si hapësirën e parë të formimit, sigurisë dhe vlerave.

Roli i familjes gjatë kalimit nga familja tradicionale te familja në epokën digjitale ka ndryshuar shumë. Më shumë kohë e shpenzuar në pajisjet digjitale, qoftë nga prindërit, qoftë nga fëmijët, përkthehet në më pak kohë të kaluar së bashku, pra në më pak kohë cilësore si familje.

Po çfarë thonë të dhënat? Statistikat globale sot (2024-2026) tregojnë se mesatarja globale e kohës së ekranit te fëmijët dhe adoleshentët në vitin 2024 ishte 6 orë e 40 minuta në ditë, ndërsa në ShBA arriti edhe në 7 orë e 3 minuta. Pra, nga viti 2013 deri në vitin 2024, koha ditore e ekranit është rritur me rreth 31 minuta globalisht. Ndërsa të dhënat rajonale (Ballkani/Evropa) tregojnë se të paktën 50 për qind e 15-vjeçarëve në vendet e rajonit kalojnë të paktën 30 orë në javë (rreth 4-4,5 orë/ditë) në pajisje digjitale. Ndërsa për Evropën Perëndimore, koha e ekranit duket të jetë më e ulët se mesatarja globale. Për Ballkanin, një hulumtim mbi TikTok-un tregoi një tjetër shqetësim: mosha minimale e kërkuar për hapjen e një llogarie në TikTok nuk i ka penguar mijëra fëmijë nën 13 vjeç në Ballkan të kenë qasje në aplikacion, dhe prindërit e mësuesit hasin vështirësi të qëndrojnë në krye të këtyre rreziqeve.

Edhe pse ekranet, qoftë televizive, si dhe digjitale, nuk do ta zëvendësojnë kurrë rolin e prindërve, ato mund ta dobësojnë këtë rol, duke e zbehur dhe reduktuar sa më shumë. Duke qenë se familja është "shkolla e parë" për çdo fëmijë, ajo është struktura e cila transmeton vlerat, gjuhën, normat sociale; nëse kjo familje zëvendësohet nga ekranet digjitale, atëherë përçuesi i vlerave (ose antivlerave në këtë rast) dhe i normave sociale, por gjithashtu edhe mësuesi i gjuhës mëmë do të jenë pikërisht këto ekrane. Të gjithë e kemi vënë re se si disa fëmijë më parë mësojnë fjalë në anglisht, ose e mësojnë anglishten shumë më herët – çdo brez akoma më herët se brezi paraprak – vetëm falë kohës së kaluar në ekran. Sado që kjo mund të duket një gjë pozitive në pamje të parë, së bashku me mësimin e anglishtes, fëmija ekspozohet në prapavijë ndaj shumë rreziqeve të tjera, siç janë antivlerat, të cilat përcillen në formë subliminale (të fshehur).

> Edhe pse ekranet, qoftë televizive, si dhe digjitale, nuk do ta zëvendësojnë kurrë rolin e prindërve, ato mund ta dobësojnë këtë rol, duke e zbehur dhe reduktuar sa më shumë.

Megjithatë, nuk mund të themi se gjithë problemi qëndron te digjitalja në vetvete, por te mungesa e kontrollit, te përdorimi i papërgjegjshëm. Para smartfonave ekzistonin ekranet televizive, të cilët gjithashtu i mbanin fëmijët dhe adoleshentët të ngjitur pas tyre. Për dallim nga ekrani i televizorit, ai nuk ishte/është interaktiv, dhe gjithashtu përdorimi i tij gjithmonë ka qenë shumë herë më i kontrolluar nga ana e prindërve.

CILI ËSHTË KONKRETISHT ROLI I PRINDËRVE NË DITËT E SOTME, NË EPOKËN DIGJITALE?

"Ekranet e prindërve" janë gjithashtu një sfidë më vete kur bëhet fjalë për dobësimin e rolit të prindërve. Kjo gjithashtu tregon një lidhje të dobët, por të rëndësishme me sjelljen e fëmijës.

Dy studime kryesore në këtë aspekt janë: "Technoference: Parent Distraction With Technology and Associations With Child Behavior Problems" (Shpërqendrimi i prindërve prej teknologjisë dhe lidhja e këtij shpërqendrimi me



problemet e sjelljes së fëmijëve) dhe "Patterns of Mobile Device Use by Caregivers and Children During Meals in Fast Food Restaurants" (Modelet e përdorimit të pajisjeve celulare nga kujdestarët dhe fëmijët gjatë vakteve në restorantet fast-food).

Në studimin e parë, u hulumtuan 170 familje amerikane me fëmijë të vegjël (mosha mesatare 3 vjeç), duke mbledhur të dhëna nga vetë prindërit (nëna dhe babai njëkohësisht). Gjetjet kryesore qenë se "Përdorimi problematik i teknologjisë nga prindërit parashikoi më shumë "technoference", pra ndërprerje të ndërveprimit prind-fëmijë të shkaktuar nga telefoni. Kjo technoference e nënës, në veçanti, parashikoi probleme sjelljeje te fëmija: si sjellje eksternalizuese (agresivitet, hiperaktivitet), ashtu edhe internalizuese (ankth, tërheqje sociale), të raportuara nga të dy prindërit.

Ndërsa studimi i dytë, një studim vëzhgues (jo i raportuar vetë), ku studiuesit vëzhguan drejtpërdrejt sjelljen e prindërve dhe fëmijëve gjatë vakteve në restorante fast-food. Gjetjet kryesore tregojnë se 73 për qind e prindërve përdorën telefonin gjatë vaktit me fëmijën e tyre. Kur prindi ishte i zhytur në telefon, fëmijët shpesh reagonin me sjellje "kërkuese vëmendjeje" (provokim, zhurmë) për ta rikthyer fokusin te vetja, një model i qartë i asaj çka Bowlby do ta quante sinjal i pa-marrë përgjigje. Dhe meqë jemi te Bowlby, le të ndalemi pak te teoria e tij: John Bowlby (psikiatër dhe psikoanalist britanik, vitet 1950-60) shpjegon pse ndërveprimi i hershëm prind-fëmijë ka rëndësi biologjike, dhe jo vetëm emocionale. Ai shpjegonte se fëmijët lindin me një nevojë të programuar biologjikisht për t'u lidhur me një kujdestar (zakonisht prindin). Sipas tij, kjo nuk është thjesht "dashuri", është një mekanizëm mbijetese: fëmija i pambrojtur duhet të mbajë afër vetes dikë që e mbron dhe i plotëson nevojat.

Dhe çka na sjell ndërmend kjo teori neve myslimanëve? Na risjell në vëmendjen tonë hadithin i cili flet rreth natyrshmërisë së njeriut: Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Secili i porsalindur lind në natyrshmërinë islame (fitre), por prindërit e tij e bëjnë jahudi, të krishterë ose zjarrputist."1 Hadith i cili shpjegon rolin e prindërve në formësimin e identitetit te ky individ i ardhshëm, por edhe ndikimin që prindërit ose kujdestari i kësaj foshnjeje do të ketë që në fazën si i porsalindur. Prandaj, dhe sipas traditës profetike, ekziston një ritual i tërë që shoqëron fazën e ardhjes së foshnjës në këtë botë, duke nisur nga këndimi i ezanit, vendosja e një hurme të shtypur në gojë, prerja e flokëve, dhënia e sadakasë, prerja e kurbanit etj.

Le të rikthehemi përsëri te Bowlby: nëse konsiston teoria e tij konkretisht? Sipas tij, procesi i lidhjes së fëmijës me prindin apo kujdestarin funksionon kështu:

Sinjalet e fëmijës, të qarat, buzëqeshja, ndjekja me sy, janë mënyra për të tërhequr vëmendjen e kujdestarit.

Përgjigjja e prindit: kur prindi përgjigjet me ngrohtësi, në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohën e duhur, fëmija mëson një mësim thelbësor: bota është e sigurt, dikush kujdeset për mua.

Përsëritja e këtij cikli mijëra herë në vitet e para krijon atë që Bowlby e quajti "baza e sigurt" (secure base), një lloj "harte të brendshme" emocionale që fëmija e mban gjatë gjithë jetës.

Pra, baza e sigurisë emocionale ndërtohet përmes ndërveprimeve mikroskopike, të përsëritura: kontakti me sy, toni i zërit, koha e reagimit, prekja. Këto janë pikërisht ato çka ekrani nuk mund t'i zëvendësojë, sepse celulari ose tableti nuk është në gjendje të lexojë e më pas të përkthejë nevojat emocionale të fëmijës, e lëre pastaj t'u përgjigjet, aq më tepër në kohë reale. Digjitalja vetëm



e bombardon me dopaminë, nevoja për të cilën pastaj kthehet në varësi. E megjithatë, përsëri problemi këtu nuk është vetëm te digjitalja, sepse në vend të telefonit apo tabletit mund të ishte një ekran televiziv ose lojëra elektronike. Problemi qëndron te mungesa e prindit dhe e reagimit në kohë reale ndaj nevojave dhe kërkesave të fëmijës.

Thënë kjo, ekspertët në fund të studimeve të tyre sugjerojnë dy gjëra kryesore që mund të zbusin ndjeshëm efektin negativ të teknologjisë te prindërimi: e para është rëndësia e "co-viewing", kur prindi shikon ose luan së bashku me fëmijën, dhe e dyta, kontrollimi dhe kufizimi i përdorimit, duke e drejtuar fëmijën ose adoleshentin drejt një përdorimi me masë të kohës së ekranit dhe përdorimit për arsye të dobishme. Dhe mbi të gjitha, koha cilësore e kaluar së bashku është zgjidhja përfundimtare për të përmirësuar rolin e prindit në epokën digjitale. Dhe për një kohë cilësore në familje, dijetarët islamë, bazuar në traditën profetike, gjithashtu këshillojnë të mbledhurit së bashku në sofër, si dhe faljen e namazit së bashku si familje. Disa shokë të Pejgamberit a.s. i thanë: "O i Dërguar i Allahut, ne hamë, por nuk ngopemi." Ai u tha: "Ndoshta ju hani veç e veç?" Ata thanë: "Po." Atëherë Pejgamberi a.s. u tha: "Mblidhuni rreth ushqimit tuaj dhe përmendni emrin e Allahut (thoni Bismilah), që t'ju shtohet bereqeti në të."2 Gjithashtu, Pejgamberi a.s. ka thënë: "Namazi me xhemat është më i vlefshëm se namazi i individit (vetëm) për njëzet e shtatë shkallë."3 Ndonëse ky hadith vlen primarisht për xhaminë, parimi i xhematit aplikohet edhe në shtëpi me familjen kur nuk jemi në xhami. Pejgamberi a.s. gjithashtu ka thënë: "Bëni një pjesë të namazeve tuaja në shtëpitë tuaja dhe mos i shndërroni ato në varreza (ku nuk falet namaz)."4 Harmonia familjare shtohet kur burri udhëheq namazin si imam dhe bashkëshortja me fëmijët falen pas tij; kjo krijon një lidhje të fortë shpirtërore dhe shërben si edukim praktik për fëmijët (të cilët, siç e përmendëm, lindin në fitreh).

Bibliografia

- American College of Pediatricians. (2025, September 20). Media use and screen time – its impact on children, adolescents, and families - American College of Pediatricians. American College of Pediatricians -. https://acpeds.org/media-use-and-screen-time-its-impact-on-children-adolescents-and-families/
- Bowlby, J. (1969). Attachment and loss: Vol. 1. Attachment. Basic Books.
- CHOC - Children›s Health Hub. (2024, August 27). The effects of screen time
- on children: The latest research parents should know.
- https://health.choc.org/the-effects-of-screen-time-on-children-the-latest-research-parents-should-know/
- McDaniel, B. T., & Radesky, J. S. (2018). Technoference: Parent distraction
- with technology and associations with child behavior problems.
- Child Development, 89(1), 100-109. https://doi.org/10.1111/cdev.12822
- Radesky, J. S., Kistin, C. J., Zuckerman, B., et al. (2014). Patterns of
- mobile device use by caregivers and children during meals in fast food
- restaurants. Pediatrics, 133(4), e843-e849. https://doi.org/10.1542/peds.2013-3703
- Ross, S. (2025, August 9). Daily media use among children and teens up dramatically from five years ago. KFF. https://www.kff.org/racial-equity-and-health-policy/daily-media-use-among-children-and-teens-up-dramatically-from-five-years-ago/

1 Sahihu i Buhariut, nr. 1293 dhe Muslimi, nr. 2658.
2 Sunen Ibën Maxhe, nr. 3286.
3 Sahihu i Buhariut, nr. 645.
4 Sahihu i Muslimit, nr. 212.



Dija dhe karakteri në epokën e inteligjencës artificiale

Haki Sahitaj

Inteligjenca artificiale po e sfidon arsimin modern të rishqyrtojë vetë kuptimin e edukimit. Në një kohë kur makinat mund të prodhojnë dije, theksi rikthehet te karakteri, gjykimi dhe përgjegjësia. Pikërisht këtu, mendimi i Imam Gazaliut fiton një aktualitet të ri.

"TESTI PËR DITURINË E MIRËFILLTË ËSHTË NË VETË NJERIUN."1- S. M NAKIB EL ATTAS

Zhvillimi i shpejtë i inteligjencës artificiale (AI) ka vënë në pikëpyetje disa prej supozimeve themelore mbi të cilat është ndërtuar arsimi modern. Nëse një sistem artificial tani mund të shkruajë ese, të përmbledhë libra, të formulojë argumente dhe të prodhojë përgjigje që, në nivel formal, ngjajnë me punën e një studenti ose studiuesi, atëherë lind një pyetje e thellë: çfarë duhet të jetë qëllimi i edukimit njerëzor? Sistemet arsimore dhe mësimdhënësit po alarmojnë se AI ka krijuar një krizë në sistemin universitar. Shumë institucione arsimore tani janë në hall se si të dallojnë punën origjinale dhe kreative të nxënësve nga ajo çfarë mund t'u ofrojë inteligjenca artificiale. Tani propozohen teknologji të reja që mund ta dallojnë një material studimi të përpiluar nga AI nga ai i vetë njeriut. Por a do të jetë zgjidhje programe të reja teknologjike për AI, apo vetë AI-ja po na tregon diçka më shumë në kohën tonë?

Një artikull nga Michael Grove dhe Tom Harrison, "Educating What AI Cannot",[2] po tregon se, në fakt, AI po na tregon se AI nuk ka shkaktuar krizë, siç po mendohet, por ajo po na tregon për një krizë që tashmë ka qenë në sistemin arsimor modern. Universiteti modern ka rrezikuar ta reduktojë edukimin në prodhimin, matjen dhe certifikimin e njohurive dhe aftësive, ndërkohë që AI po tregon se e vetmja gjë që nuk mund të automatizohet lehtësisht është karakteri, gjykimi, përgjegjësia dhe urtësia praktike. Prandaj, thonë ata, a mos po ia tregon rrugën e vërtetë AI-ja edukimit bashkëkohor, ku edukimi moral duhet të rikthehet në qendër të arsimit të lartë?

Dhjetë shekuj më parë, një nga nxënësit e talentuar të Imam Gazaliut i shkroi një letër mësuesit të tij se, pavarësisht se kishte mësuar shumë shkenca të ndryshme, ai po ndihej i çorientuar se çfarë duhet të bënte me gjithë këtë dije dhe qindra libra përreth. Imam Gazaliu i kthen përgjigje me një libër që njihet me titullin *Ejjuhe'l veled*.[3] Në këtë vepër, Gazaliu i drejtohet nxënësit të tij duke e paralajmëruar se konceptimi i dijes që kufizohet në akumulimin e informacionit e bën të natyrshëm këtë huti. Për Gazaliun, njeriu mund të zotërojë një sasi të madhe njohurish dhe, megjithatë, të mos ketë arritur qëllimin e vërtetë të dijes.

Një nga idetë qendrore të *Ejjuhe'l veled* është se dija nuk mund të justifikohet vetëm përmes sasisë së saj. Imam Gazaliu nuk e mohon rëndësinë e studimit; përkundrazi, vetë struktura e veprës i drejtohet një nxënësi që ka kaluar vite duke kërkuar dije. Problemi fillon në momentin kur njeriu beson se vetë zotërimi





i njohurive është i mjaftueshëm për përsosmërinë ose vlerën e tij si njeri. Për Gazaliun, ekziston një hendek i mundshëm midis asaj që njeriu di dhe asaj që ai është. Një person mund të njohë parimet morale, por të mos jetë i moralshëm; mund të flasë për urtësinë, por të mos jetë i urtë; mund të ketë dije fetare, por kjo dije të mos e ketë transformuar karakterin e tij. Për këtë arsye, dija duhet të kalojë nga niveli teorik në atë praktik. Vlera e saj matet edhe nga ndikimi që ushtron mbi jetën dhe sjelljen e njeriut.

Kjo kritikë merr një aktualitet të veçantë në epokën e inteligjencës artificiale. Grove dhe Harrison argumentojnë se AI e ka bërë më të dukshme një problem që arsimi modern e kishte tashmë: prirjen për ta identifikuar edukimin me produktet e matshme të tij. Një ese, një provim, një raport ose një projekt shpesh trajtohen si dëshmi të drejtpërdrejta të dijes së studentit. Por nëse AI mund të prodhojë disa prej këtyre produkteve në mënyrë të besueshme, atëherë vetë produkti nuk është më provë e mjaftueshme e të mësuarit.

Këtu shfaqet një paralelizëm i rëndësishëm me Gazaliun. Nëse Gazaliu paralajmëron kundër dijes që nuk shndërrohet në veprim ose nuk vjen si rezultat i veprimit, AI detyron universitetin bashkëkohor të përballet me një fenomen tjetër: prodhimin e pamjes së dijes pa garantuar procesin e të mësuarit. Një tekst mund të jetë i saktë, elegant dhe bindës, por kjo nuk dëshmon domosdoshmërisht se personi që e dorëzon atë ka menduar, ka gjykuar ose është formuar intelektualisht përmes procesit. Teza kryesore e Grove dhe Harrison është se AI mund të kryejë ose imitojë shumë prej detyrave që tradicionalisht janë lidhur me inteligjencën akademike, por ajo nuk mund të edukojë karakterin njerëzor në vend të njeriut. Pikërisht për këtë arsye, autorët argumentojnë se arsimi i lartë duhet t'i kushtojë një rëndësi më të madhe zhvillimit të virtyteve morale, intelektuale, qytetare dhe praktike.

> Edukimi nuk është vetëm një proces i mbushjes së mendjes me njohuri. Ai është një proces i formimit të vetes. Disiplina, vetëkontrolli, sinqeriteti dhe përputhja midis dijes dhe veprimit janë elemente thelbësore të këtij procesi.

Kjo nuk nënkupton se karakteri është një lloj "shtese" morale që mund t'i bashkëngjitet arsimit pasi studenti të ketë fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme. Përkundrazi, argumenti i artikullit sugjeron se karakteri është pjesë e vetë mënyrës se si njeriu përdor dijen. Një person mund të jetë teknikisht shumë i aftë, por nëse nuk ka gjykim, përgjegjësi dhe integritet, aftësia e tij mund të përdoret në mënyra të dëmshme ose të papërgjegjshme.

Në *Ejjuhe'l veled*, edukimi nuk është vetëm një proces i mbushjes së mendjes me njohuri. Ai është një proces i formimit të vetes. Disiplina, vetëkontrolli, sinqeriteti dhe përputhja midis dijes dhe veprimit janë elemente thelbësore të këtij procesi. Imam Gazaliu e paralajmëron nxënësin e tij se kërkimi i dijes dhe leximi i shumtë mund të ketë vetëm motive të përkohshme ose të dukshme, siç janë mburrja, fitimi i ndonjë pozite, paga e lartë, por, në anën tjetër, mund të synohet ngritja e virtyteve, morali i lartë dhe veprimi me atë dije sipas parimeve të Sheriatit.[4] Nëse nxënësi ose studenti është i prirë nga synimet e para, atëherë ai e përdor dijen drejt atyre. Kështu, kopjimi, mashtrimi dhe plagjiatura bëhen të pashmangshme. Në rastin e dytë, ai synon një riorientim të të gjitha dhuntive të vetes me atë që di.

Nëse do ta përkthenim këtë ide në gjuhën e debatit bashkëkohor mbi AI-në, mund të thoshim se pyetja nuk është vetëm: "A mund ta përdorë studenti AI-në?" Pyetja më e rëndësishme është: "Çfarë lloj personi bëhet studenti përmes mënyrës se si e përdor AI-në?" Kjo zhvendosje është thelbësore. Në vend që AI të trajtohet vetëm si problem i plagjiaturës ose i integritetit akademik, ajo mund të shihet si një provë për karakterin. Përdorimi i teknologjisë kërkon gjykim: kur është e përshtatshme ta përdorësh, kur duhet ta kufizosh, si duhet të verifikosh informacionin që prodhon dhe, mbi të gjitha, kush mban përgjegjësi për rezultatin përfundimtar?

Këtu hyn në lojë koncepti i urtësisë praktike. Grove dhe Harrison sugjerojnë se edukimi

duhet të zhvillojë aftësinë e studentit për të gjykuar në situata konkrete, ku nuk ekziston gjithmonë një rregull i thjeshtë ose një përgjigje automatike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në marrëdhënien me AI-në, sepse një sistem mund të ofrojë një përgjigje, por nuk mund të marrë përgjegjësi morale në vend të përdoruesit. Në këtë kuptim, AI mund të prodhojë një përgjigje, por nuk mund të bëhet moralisht përgjegjëse për të në të njëjtën mënyrë si një njeri. Pikërisht këtu shfaqet kufiri që artikulli e konsideron specifikisht njerëzor: karakteri nuk është vetëm ajo që dimë, por mënyra se si gjykojmë dhe veprojmë.

Duhet të kemi parasysh se tradita islame ka një koncept shumë më të gjerë për karakterin dhe qëllimin e tij përfundimtar. Karakteri në perspektivën islame nuk përfshin vetëm aspektet sekulare, por edhe ato fetare. Ashtu si për vetë Gazaliun, formimi i karakterit nuk mund të shkëputet nga një kuptim fetar i njeriut dhe i qëllimit të tij. Edukimi është i lidhur me pastrimin e vetes, marrëdhënien me Zotin dhe orientimin drejt një qëllimi që e tejkalon suksesin në këtë botë. Vepra dhe karakteri kanë një dimension shpirtëror që nuk reduktohet në mirëqenien individuale ose funksionimin e mirë të shoqërisë. Ai i shkruan nxënësit të tij: "Dija pa veprim me të është çmenduri, e vepra pa dije as nuk mund të ndodhë. Mos harro se vetëm dituria nuk është në gjendje të largojë nga veprat e këqija, e as të të udhëzojë në bindje, e as të të shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit. Nëse sot nuk punon sipas diturisë tënde dhe nuk mundohesh të kompensosh atë që të ka ikur në ditët e shkuara, nesër do të thuash: O Zot, na kthe në dynja, të bëjmë vepra të mira; por atëherë do të marrësh përgjigjen: I çmendur, po ti nga atje erdhe!"[5]

Grove dhe Harrison, nga ana tjetër, e ndërtojnë argumentin e tyre në një kornizë të etikës së virtytit dhe të suksesit njerëzor. Qëllimi është formimi i individëve që mund të jetojnë mirë, të gjykojnë me përgjegjësi dhe të kontribuojnë në të mirën publike. Karakteri ka një dimension moral dhe qytetar, por artikulli nuk e vendos atë në të njëjtin horizont teologjik që e gjejmë te Gazaliu dhe, në përgjithësi, te vetë tradita islame.

Ky dallim është i rëndësishëm, sepse tregon se nuk mund të transferojmë automatikisht konceptet nga një traditë në tjetrën. Për Gazaliun, pyetja "çfarë lloj njeriu duhet të bëhem?" nuk mund të ndahet nga pyetja "për çfarë qëllimi ekziston njeriu?". Në edukimin modern, pyetja është më shumë: "çfarë lloj qytetari dhe agjenti moral duhet të formojë universiteti në një botë të transformuar nga teknologjia?" Megjithatë, ky dallim nuk e dobëson domosdoshmërisht krahasimin. Përkundrazi, ai e bën atë më produktiv. Gazaliu i jep debatit bashkëkohor një dimension që ndonjëherë mungon: pyetjen nëse formimi i karakterit mund të reduktohet vetëm në aftësi për funksionim të mirë shoqëror. Nga ana tjetër, Grove dhe Harrison e përkthejnë shqetësimin për formimin moral në një gjuhë institucionale dhe pedagogjike që mund të aplikohet konkretisht në universitetet moderne.

Megjithatë, kontributi më i rëndësishëm i Gazaliut në këtë debat mund të jetë një pyetje edhe më radikale. Nëse arsimi bashkëkohor pranon se duhet të formojë karakterin, atëherë duhet të pyesë gjithashtu: çfarë është karakteri i mirë dhe mbi çfarë baze përcaktohet ai? Teknologjia mund të na detyrojë të rikthehemi tek edukimi i karakterit, por nuk mund të na japë automatikisht përgjigjen se çfarë karakteri duhet të kultivojmë. Këtu e shoh të domosdoshme që institucionet tona arsimore fetare që ofrojnë edukim fetar të luajnë një rol tejet kritik në këtë debat. Në një botë ku makinat mund të prodhojnë gjithnjë e më shumë informacion, argumente dhe tekste, ndoshta pyetja më e rëndësishme e edukimit nuk është më thjesht "çfarë mund të dijë njeriu?", por "çfarë lloj njeriu duhet të bëhet ai me atë që di?"

Në këto sfida që po kalon sistemi arsimor në mbarë botën, institucionet islame do të kenë rolin më të madh për t'u përfshirë në riorientimin e edukimit të së ardhmes. Tradita islame mund të japë një kontribut të rëndësishëm në riorientimin e edukimit bashkëkohor duke rikthyer idenë se arsimi nuk duhet të kufizohet vetëm në transmetimin e njohurive, zhvillimin e aftësive apo përgatitjen për tregun e punës, por duhet të synojë edhe formimin e njeriut në tërësinë e tij. Koncepti islam i *ta'lim*it lidhet ngushtë me *terbije*n dhe *te'dib*,[6] pra me edukimin, kultivimin dhe disiplinimin moral të individit. Në një kohë kur AI mund të prodhojë informacion dhe të imitojë disa forma të inteligjencës, tradita islame e zhvendos vëmendjen nga pyetja "sa di njeriu?" drejt pyetjes "çfarë lloj njeriu bëhet ai përmes dijes së tij?". Në këtë kuptim, mendimtarë si Gazaliu ofrojnë një perspektivë të vlefshme për arsimin bashkëkohor: dija duhet të shoqërohet me përgjegjësi, veprim, vetëdije morale dhe formim të karakterit. Kështu, tradita islame mund të kontribuojë në një konceptim më holistik të edukimit, ku njohuria, karakteri dhe përgjegjësia morale nuk trajtohen si dimensione të ndara, por si pjesë të së njëjtës përpjekje për formimin e njeriut.[7] Universiteti islam, medresetë dhe institucionet e tjera relevante te ne duhet ta shfrytëzojnë këtë traditë të pasur pedagogjike për t'iu përgjigjur sfidave të një revolucioni të ri digjital.

1 Sejjid Muhammed Nakib el Attas, Hyrje në metafizikën e Islamit/ Paraqitja e elementeve themelorë të botëkuptimit islam, (Shkup: Logos-A, 2011), 125.

2 Grove, Michael, and Tom Harrison. 2026. "Educating What AI Cannot: Character and the Future of Higher Education." British Journal of Educational Studies, June, 1–26. doi:10.1080/00071005.2026.2678972.

3 Muhamed ibën Ahmed el Gazzali et Tusi, Ejjuhe'l Veled, (Bejrut: Daru'l Menhexh, 2014, bot. dytë). Kjo vepër e shkurtër është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

4 Po aty, 44.

5 Po aty, 45-46.

6 Për raportin e këtyre dy koncepteve të shihet S.M. Nakib el Attas, The concept of Education in Islam, (Kuala Lumpur: ABIM, 1978).

7 Për një trajtim të të gjitha këtyre aspekteve në edukimin islam të shihet Zahra al Zeera, Tërësia dhe shenjtëria në edukim/Një perspektivë islame, (Tiranë: AIITC, 2019). Në këtë libër po ashtu trajtohet teoria e virtyteve dhe shpirtërores tek imam Gazzaliu. Shih faqe 59 e tutje.



Këshilla të sahabëve

KËSHILLA QË EBU BEKRI DHE OMERI R.A. UA JEPNIN NJERËZVE

Dr. Sedat Islami

Besimi dhe namazi janë dy shtylla themelore që e mbajnë gjallë lidhjen e besimtarit me Zotin. Në kohë të shkujdesjes shpirtërore, rikujtimi i tyre bëhet nevojë për zemrën dhe jetën e besimtarit. Këshilla e Ebu Bekrit dhe Omerit r.a. na rikthen pikërisht te këto dy themele të fesë.

HYRJE

Ngritja dhe rënia janë evidente edhe në çështjet shpirtërore. Njerëzit, kushdo qofshin, e përjetojnë një gjë të tillë. E kanë përjetuar edhe njerëzit më të mirë, sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Kjo ndodh për shkaqe të shumta dhe jo çdoherë negative. Ndonjëherë rënien shpirtërore, në kuptim të shkujdesjes dhe gafletit, e shkaktojnë edhe gjëra që në parim nuk janë mëkate, si marrja me punët familjare, fëmijët etj.[1] Për këtë arsye, rikujtimi kohë pas kohe është ilaç që ruan drejtpeshimin e shpirtit në rrugën drejt Zotit. Në Kuran, Zoti i Madhëruar na mëson: *"Por këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve."* (Dharijat, 55).

Abdurrahman bin Nasir Sadi thotë se këshilla apo rikujtimi është dy llojesh:

- Rikujtimi për gjërat që njihen përgjithësisht në bazë të natyrshmërisë dhe mendjes, por jo edhe detajisht, dhe
- Rikujtim për gjërat që dihen, por që nga gafleti harrohen. Përsëritja e tyre bëhet me qëllim që të përforcohen në mendje dhe që të këndellen e të veprojnë sipas asaj që këshillohen.[2]

Allahu i Madhëruar po na flet edhe për efektin e këshillës, e cila pranohet te besimtari, i cili ka besimin, përuljen, pendimin; i cili ndjek rrugën e kënaqësisë së Zotit. Kjo e bën besimtarin të dallohet nga të tjerët, të cilëve mendjemadhësia, kryeneçësia, fudullëku u bëjnë t'i refuzojnë këshillat. Allahu i Madhëruar thotë: *"Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme! Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut), e do t'i shmanget vetëm më i keqi."* (El Ala, 9-11).

> "Prandaj këshillo, nëse këshilla do të jetë e dobishme! Asaj do t'ia vërë veshin ai që (i) frikësohet (Allahut), e do t'i shmanget vetëm më i keqi." (El Ala, 9-11).

KËSHILLA QË DO T'UA PREZANTOJMË ËSHTË E KËSAJ NATYRE.

Nuk ka të bëjë me gjëra që nuk dihen ose që besimtarët nuk janë njoftuar me to, në një ose mënyrë tjetër. Ka të bëjë thjesht me rikujtimin e dy gjërave që kanë rëndësi të madhe në fe. Fjala është për besimin dhe namazin. E veçantë e kësaj këshille është se ajo vjen nga dy burrat më të mirë të këtij ymeti, Ebu Bekri dhe Omeri – Allahu qoftë i kënaqur me ta!

Muhamed bin Sirini ka thënë: Jam informuar se Ebu Bekri dhe Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të dy!, i mësonin (këshillonin) njerëzit duke u thënë: "Ta adhurosh Allahun dhe të mos i përshkruash ortakëri në asgjë, dhe ta falësh namazin e obliguar në kohën e vet, sepse në shpërfilljen e namazit ekziston rreziku i shkatërrimit."[3]

Rëndësia e kësaj këshille qëndron në përmbajtjen e saj, respektivisht në trajtimin e besimit dhe namazit, si dy gjërat më të rëndësishme në fe. Për ta kuptuar peshën dhe pozitën e tyre, Ebu Hurejre r.a. përcjell se një malësor arab paskësh ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i paskësh thënë: "Më udhëzo për një vepër që, nëse e bëj, hyj në Xhenet! Pejgamberi a.s. i kishte thënë: "Ta adhurosh Allahun dhe të mos i përshkruash ortak në asgjë, ta falësh namazin, ta japësh zekatin e obliguar dhe të agjërosh!"

Malësori tha: "Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të shtoj kësaj asgjë më shumë." Pejgamberi a.s. (kur dëgjoi këto fjalë) tha: "Kush ka dëshirë që ta shohë një banor të Xhenetit duke ecur, le ta shikojë këtë burrë!"[4]

KËSHILLA E PARË: RUAJTJA E BESIMIT

Besimi i pastër nënkupton që ta besosh, t'i bindesh dhe ta adhurosh Allahun e Madhëruar dhe ta adhurosh ashtu siç Ai na ka mësuar në Kuran ose ashtu siç i Dërguari i Tij, Pejgamberi Muhamed a.s., na ka mësuar në hadithet e tij. Se sa i rëndë-

sishëm është ky koncept, mësojmë edhe nga fakti se kushti i parë i besimit dhe shtylla e parë e Islamit janë pikërisht me këtë domethënie. Në hadithin e Xhibrilit, kur Pejgamberi a.s. ishte pyetur për imanin dhe Islamin, kishte thënë për kushtin e parë të imanit: "Ta besosh Allahun..." dhe për shtyllën e parë të Islamit: "Të dëshmosh se nuk ka zot të adhuruar me të drejtë përveç Allahut..."[5]

Namazi është shtylla e dytë e fesë dhe absolutisht një ndër çështjet më të ndjeshme të saj. Falja e tij në përputhje me rregullat dhe etikën ka dobi të shumta.

Siç kanë shpjeguar dijetarët, pa plotësimin e këtij kushti nuk vlen absolutisht asnjë vepër. Që të shpëtosh në botën tjetër, që ta fitosh Xhenetin, ashtu siç mësuam edhe nga hadithi i lartpërmendur, duhet të besosh Allahun e Madhëruar ashtu siç Ai kërkon. Nëse vepron ndryshe, ke bërë gabimin më të madh, i ke bërë vetes zullumin më të madh, sepse ke bërë gabimin më të madh. Kur Pejgamberi Muhamed a.s., u pyet për mëkatin më të madh tek Allahu, tha: "T'i përshkruash Zotit ortak ndërsa Ai të ka krijuar."[6]

Në fakt, është gabimi që nuk falet. Me tekst kuranor, gabimin e vetëm që Allahu i Madhëruar nuk e fal kurrë është shirku, t'i përshkruash Zotit ortak. *"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm."* (Nisa, 48).

Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë: "Kush vdes duke e lutur dikë pos Allahut, hyn në zjarr."[7]

T'i bësh ortak Zotit, d.m.th., të adhurosh idhujt, t'u lutesh atyre, të therësh kurbane për ta, të falesh apo agjërosh për idhujt, t'u lutesh të vdekurve dhe të kërkosh ndihmë prej tyre, t'u besosh fallxhorëve, etj.

Nga ajeti i lartpërmendur mund ta mësojmë se shirku nuk falet, sepse është shpifje e madhe ndaj Zotit, është të thuash për Zotin e të veprosh atë që Ai nuk e ka ligjësuar. Prandaj edhe është mëkat i këtillë çfarë është. Shirku i asgjëson veprat. Është material asgjësues i çdo të mire. Allahu i Madhëruar thotë: *"Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: "Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit."* (Zumer, 65).

Në Kuran ka dhe një përshkrim tjetër figurativ të dëmit që shirku i bën besimit. Bëhet fjalë për përmasat e shkatërrimit dhe dëmtimit. *"...Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur."* (Haxh, 31). Pra, zogu e rrëmben dhe e bën copë-copë ose era e hedh diku larg ku nuk ka kushte për jetesë dhe nuk mund të mbijetojë.[8] Kështu vepron shirku me besimin.

KËSHILLA E DYTË: PËRKUJDESJA PËR FALJEN E NAMAZIT NË KOHËN E VET

Këshilla e dytë ka të bëjë me faljen e namazit në kohën e vet. Namazi është shtylla e dytë e fesë dhe absolutisht një ndër çështjet më të ndjeshme të saj. Falja e tij në përputhje me rregullat dhe etikën ka dobi të shumta. Për shkak të ndikimit fetar që ka, te brezat e parë trajtesat për namazin janë bërë më shumë nga aspekti i përkujdesjes për rregullat dhe etikën, e më pak për mosfaljen e qëllimshme të tij, sepse nuk është paramenduar që myslimani të mos falet. Imami Ebu Tajjib Magrebiu ka thënë se, çështjen e mosfaljes së qëllimshme të namazit, dijetarët e kanë





ngritur vetëm hipotetikisht, ndryshe nuk ka ndodhur, ngase askush nga myslimanët nuk e braktis namazin qëllimisht.[9]

Përkujdesja për namazin është kërkesë kuranore. Allahu i Lartësuar thotë: *"Faleni rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin dhe qëndroni me devotshmëri para Allahut, duke iu lutur Atij."* (Bekare, 238).

Pejgamberi Muhamed a.s. po kështu na ka mësuar për t'u përkujdesur për namazet. Sahabiu i nderuar, Ubade bin Samiti r.a., përcjell se Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë: "Allahu ua ka bërë obligim robërve pesë namaze. Kush vjen me to ndërsa nuk ka humbur asgjë prej tyre, nga neglizhenca dhe shpërfillja ndaj tyre, ka premtim nga Allahu se do ta fusë në Xhenet..."[10]

Përkujdesja për namazet, duke përfshirë me theks të veçantë këtu kohën, është detyrim. Allahu i Madhëruar thotë: *"...sepse namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar."* (Nisa, 103).

Nga këtu, shpërfillja e namazit, duke bërë që të kalojë koha e tij, është mëkat. Në Kuran janë qortuar ashpër ata që veprojnë kësisoj.[11] Po kështu edhe në hadithe. Pejgamberi Muhamed a.s. ka përmendur se gjëja e parë prej veprave për të cilat merret në pyetje robi është namazi; nëse ka qenë në rregull, atëherë ajo që pason është e lehtë.[12] E me të qenit 'në rregull' nënkuptohet, përveç të tjerash, edhe falja e tij në kohën përkatëse.

Ndërsa falja e namazit në kohën e vet, veç përmbushjes së detyrimit, ka dhe shpërblim të veçantë. Konsiderohet ndër veprat më të mira. Abdullah bin Mesudi r.a., rrëfen se Pejgamberi Muhamed a.s. ishte pyetur për veprat më të mira, ndërsa kishte dhënë këtë përgjigje: "Namazi në kohën e vet, mirësjellja me prindërit dhe xhihadi në rrugën e Allahut!"[13]

PËRMBYLLJE

Besimi dhe namazi janë dy gjëra që përcaktojnë arsyen e ekzistencës sonë. Ne kemi ardhur në këtë botë për ta besuar Allahun dhe për t'iu bindur Atij. Kështu, ne e gjejmë vetveten dhe qëllimin e krijimit tonë. Kështu, luajmë rolin që duhet luajtur në këtë botë dhe shpëtojmë në botën tjetër.

1 Shih hadithin e Handhales r.a., në Sahihun e Muslimit, nr. 2570, në të cilin qëndron se si ai, bashkë me Ebu Bekrin r.a., ishin ankuar për faktin se, kur ishin me Pejgamberin a.s., ndiheshin ndryshe, ndërsa kur ktheheshin në shtëpi, nuk e kishin atë nivel besimi. Pejgamberi a.s. iu kishte treguar se vazhdimi me të njëjtën tempo ishte i vështirë prandaj e kishte këshilluar që të bëjë përputhjen ndërmjet aspektit shpirtëror dhe material duke ndarë kohë për secilën prej tyre.

2 Abdurrahman bin Nasir es Sadi, Tejsiru el Kerimi err Rrahman fi tefsiri Kelami el Mennan, red. shkenc. Abdurrahman bin Muala Luvejhak, (Bejrut: Muessesetu err Rrisale, 2000), f. 812.

3 Ebu Bekir Abdullah bin Muhamed bin ebi Shejbe, El Musannef, red. shkenc. Sad bin Nasir bin Abdulaziz ebu Habib el Shithri, (Rijad: Dar kunuz Ishbilija, 2015), nr. 3245, 3/191.

4 Buhariu, nr. 1397; Muslimi, nr. 14.

5 Shih: Buhariu, nr. 50; Muslimi, nr. 9.

6 Buhariu, nr. 4477; Muslimi, nr. 86.

7 Buhariu, nr. 4497; Muslimi, nr. 92.

8 Shih: Ismail bin Omer bin Kethir, Tefsiru el Kur'ani el Adhim, red. shkenc. Hikmet bin Beshir bin Jasin, (Arabi Saudite: Dar Ibën Xheuzi, 1431 h.),5/409.

9 Abdurrahim bin el Husejn Zejnuddin el Iraki, Tarhu ettethrib fi sherhi Ettakrib, (Demmam: Dar Ibën Xheuzi, 1438 h.), 2/14.

10 Ebu Davudi, nr. 425; Nesaiu, nr. 461; Ibën Maxheh, nr. 1401. Albani e ka saktësuar këtë hadith.

11 Shih: Maun: 5; Merjem: 59.

12 Shih: Ebu Davudi, nr. 864; Tirmidhiu, 413; Nesaiu, nr. 465.

13 Buhariu, nr. 7534; Muslimi, nr. 85.



Çfarë mësova nga jeta e Muhamedit a.s. dhe çfarë na mëson ajo sot?

Sadat Topanica

Jeta e Muhamedit a.s. nuk është vetëm histori për t'u kujtuar, por model për t'u jetuar. Mësimet e tij për durimin, mëshirën, familjen, dijen dhe moralin mbeten po aq të nevojshme edhe në kohën tonë. Dashuria për të merr kuptim të plotë vetëm kur reflektohet në sjelljen dhe ndryshimin tonë.

HYRJE

Muaji i Mevludit është një mundësi e veçantë për të kujtuar dhe për të mësuar më shumë për jetën e Muhamedit a.s., për sakrificat e tij, moralin, sjelljen dhe mënyrën se si ai u soll me njerëzit. Por, për mua, të flasësh për Muhamedin a.s. nuk do të thotë vetëm të tregosh ngjarje nga jeta e tij. Më e rëndësishmja është të kuptojmë se çfarë mund të mësojmë prej tij dhe si mund t'i zbatojmë këto mësime në jetën tonë. Allahu i Madhëruar thotë: *"Me të vërtetë, ju e keni shembullin më të mirë në të Dërguarin e Allahut..."* (El Ahzab, 21).

> një shoqëri e shëndoshë islame nuk duhet të kujdeset vetëm për ata që nuk kanë gjithçka, por duhet të kujdeset edhe për ata që kanë nevojë për dashuri, mbështetje dhe kujdes.

Kjo do të thotë se Muhamedi a.s. nuk është vetëm një figurë e historisë islame. Ai është model për besimtarin në çdo kohë. Prandaj, edhe pse jetojmë në vitin 2026, në një kohë të teknologjisë, rrjeteve sociale, komunikimit të shpejtë dhe ndryshimeve të mëdha shoqërore, mësimet e tij vazhdojnë të jenë të domosdoshme.

FËMIJËRIA E MUHAMEDIT A.S. – NJË FËMIJËRI ME SPROVA

Jeta e Muhamedit a.s. filloi me sprova. Babai i tij, Abdullahu, kishte ndërruar jetë para lindjes së tij. Ai u rrit si jetim dhe, kur ishte ende fëmijë, humbi edhe nënën e tij, Eminen. Më pas u kujdes për të gjyshi i tij, Abdulmutalibi, e pas vdekjes së gjyshit, kujdesin për të e mori xhaxhai i tij, Ebu Talibi. Kurani e përmend këtë pjesë të jetës së tij: *"A nuk të gjeti jetim e Ai –Allahu të dha strehë."*[2] (Ed Duha, 6).

Kjo pjesë e jetës së Muhamedit a.s. më mëson se një fëmijë nuk duhet të gjykohet nga rrethanat në të cilat është rritur. Jetimëria dhe vështirësitë nuk e penguan atë që të bëhej njeriu më i dashur dhe më i respektuar te njerëzit, e gjithsesi edhe tek Allahu.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e fëmijërisë së tij ishte qëndrimi te Halime es Sadije. Në traditën e asaj kohe, fëmijët e Mekës dërgoheshin për një periudhë në shkretëtirë, ku merrnin ajër më të pastër dhe mësonin gjuhë më të pastër arabe. Muhamedi a.s. kaloi vitet e para të fëmijërisë te familja e Halimes.[3]

ÇFARË MË MËSON KJO SOT?

Edhe në vitin 2026 ka shumë fëmijë që rriten pa njërin ose të dy prindërit, ka fëmijë që jetojnë në varfëri, në luftë, në familje të ndara ose në rrethana të vështira. Ne shpesh i shohim problemet e tyre, por harrojmë të mendojmë për zemrën e tyre. Jeta e Muhamedit a.s. na mëson të kemi më shumë kujdes për jetimët, fëmijët dhe njerëzit e dobët. Ai a.s. ka thënë: "Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në Xhenet kështu", dhe bëri shenjë me gishtin tregues dhe të mesmin.[4] Prandaj, një prej mësimeve që mora është se një shoqëri e shëndoshë islame nuk duhet të kujdeset vetëm për ata që nuk kanë gjithçka, por duhet të kujdeset edhe për ata që kanë nevojë për dashuri, mbështetje dhe kujdes.

MUHAMEDI A.S. DHE HATIXHEJA R.A. – BESNIKËRIA DHE FAMILJA

Para shpalljes, Muhamedi a.s. njihej ndër njerëzit e Mekës për ndershmërinë dhe besnikërinë e tij. Ai u quajt El Emin – i besueshmi. Ai u martua me Hatixhen r.a., e cila ishte një grua e ndershme dhe e respektuar. Martesa e tyre u bë një shembull i rëndësishëm i besnikërisë, respektit dhe mbështetjes familjare. Kur erdhi shpallja e parë dhe Muhamedi a.s. u kthye në shtëpi i shqetësuar, ishte Hatixheja r.a. ajo që e qetësoi dhe e mbështeti.



Ajo i tha se Allahu nuk do ta poshtëronte, sepse ai mbante lidhjet farefisnore, ndihmonte të varfrit, nderonte mysafirin dhe ndihmonte njerëzit në vështirësi.[5]

ÇFARË MË MËSON KJO SOT?

Në kohën tonë flasim shumë për familjen, por familja shpesh përballet me probleme të mëdha: mungesë komunikimi, mungesë kohe, ndikim të rrjeteve sociale dhe largim emocional mes anëtarëve të familjes. Jeta e Muhamedit a.s. dhe Hatixhes r.a. më mëson se familja duhet të jetë vend ku njeriu gjen qetësi, mbështetje dhe besim.

Allahu thotë: *"Dhe nga shenjat e Tij është se krijoi për ju bashkëshortet tuaja që të gjeni qetësi tek ato dhe mes jush vendosi dashuri dhe mëshirë."*[6]

Prandaj, mësimi nuk është vetëm të dimë se Muhamedi a.s. ishte i martuar me Hatixhen r.a., por të kuptojmë si duhet të ndërtohet një familje me respekt, besnikëri dhe mëshirë.

SHPALLJA – FILLIMI I NJË MISIONI TË MADH, NË QENDËR TË SË CILIT ISHTE ARSIMIMI

Kur Muhamedi a.s. ishte dyzet vjeç, në shpellën Hira i erdhi shpallja e parë nëpërmjet Xhibrilit a.s. Fjalët e para të shpalljes ishin: *"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi."*[7]

Këto fjalë kanë një rëndësi të madhe edhe për ne. Mesazhi islam filloi me leximin dhe diturinë. Kjo më bën të mendoj për pozitën e diturisë në jetën time. Sot kemi mundësi të mëdha për të mësuar. Me një telefon mund të kemi qasje në libra, ligjërata, Kuran dhe burime të ndryshme të diturisë. Por në të njëjtën kohë kemi edhe një problem: kemi shumë informacion, por jo gjithmonë kemi dituri të dobishme.

Në vitin 2026, një prej sfidave më të mëdha është të dallojmë të vërtetën nga e pavërteta. Në internet mund të përhapet një lajm brenda pak sekondash. Prandaj myslimani duhet të jetë i kujdesshëm me atë që lexon dhe atë që përcjell. Allahu thotë: *"O besimtarë! Nëse ndonjë i prishur ju sjell ndonjë lajm, verifikojeni..."*[8] Pra, mësimi i shpalljes së parë, Kuranit dhe jetës së Muhamedit a.s., Sunetit, janë shumë të rëndësishme edhe për jetën tonë moderne.

SAKRIFICAT E MUHAMEDIT A.S. – TË MOS DORËZOHEMI, TË JEMI TË VENDOSUR PËRBALLË SFIDAVE

Pas shpalljes, Muhamedi a.s. u përball me kundërshtime të mëdha. Ai dhe shokët e tij u përndoqën, u ofenduan dhe u torturuan. Myslimanët përjetuan edhe bojkotin në Mekë. Më vonë, Muhamedi a.s. shkoi në Taif për t'i ftuar njerëzit në Islam, por atje u prit me refuzim dhe dhunë. Megjithatë, ai nuk hoqi dorë nga misioni i tij. Kjo është një prej gjërave që më ka bërë më shumë përshtypje në jetën e tij: sa më të mëdha ishin sprovat, aq më e madhe ishte qëndrueshmëria e tij. Allahu thotë: *"Prandaj, bëhu i durueshëm, ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur."*[9]

> Jeta e Muhamedit a.s. dhe Hatixhes r.a. më mëson se familja duhet të jetë vend ku njeriu gjen qetësi, mbështetje dhe besim.

ÇFARË MË MËSON KJO NË VITIN 2026?

Sot shpesh duam rezultate të menjëhershme. Nëse një gjë nuk na ecën, dorëzohemi. Nëse kemi një problem në shkollë, punë, familje apo në jetën personale, mendojmë se nuk mundemi më. Jeta e Muhamedit a.s. më mëson se suksesi nuk vjen gjithmonë menjëherë. Muhamedi a.s. na mëson të kemi sabër, të punojmë, të lutemi dhe të vazhdojmë përpara edhe kur rruga është e vështirë.

Morali i Muhamedit a.s. – ajo që i mungon shumë kohës sonë

Një prej cilësive më të mëdha të Muhamedit a.s. ishte morali i tij. Allahu i Madhëruar thotë: *"Vërtet, ti je me një moral madhësh-tor."*[10] Kur Aisheja r.a. u pyet për moralin e Muhamedit a.s., ajo tha: "Morali i tij ishte Kurani."[11]

Kjo është një fjali shumë e madhe. Do të thotë se Kurani nuk ishte vetëm diçka që ai e lexonte, por diçka që shihej në sjelljen e tij. Ai ishte i mëshirshëm, i drejtë, i durueshëm, i thjeshtë dhe falës. Allahu xh.sh. thotë: *"Ti ishe i butë ndaj tyre me mëshirën e Allahut."*[12]

Sot, a nuk duhet të përvetësojmë tërë moralin e tij?

Në vitin 2026, kemi nevojë të madhe për këtë moral. Në rrjetet sociale njerëzit mund të ofendohen shumë lehtë. Një koment mund të shkaktojë konflikt. Një fjalë mund të prishë një miqësi. Shpesh njerëzit gjykojnë njëri-tjetrin pa u njohur ndërmjet vete.

Këtu më vjen një pyetje: A po duket morali islam në mënyrën se si flasim me njerëzit në internet? Sepse është e lehtë të jesh i sjellshëm në xhami, por sprova është të jesh i sjellshëm edhe jashtë xhamie dhe kur dikush të provokon. Muhamedi a.s. ka thënë: "I forti nuk është ai që mund të mposhtë të tjerët, por ai që e kontrollon veten kur zemërohet."[13]

Ky mësim është shumë i rëndësishëm sot. Ne nuk kemi nevojë vetëm për njerëz të ditur, por për njerëz që dinë ta kontrollojnë zemërimin, gjuhën dhe sjelljen e tyre.

Mëshira e Muhamedit a.s. – një mësim për një botë të përçarë

Muhamedi a.s. ishte njeri i mëshirës. Allahu e përshkruan atë duke thënë: *"Ne nuk të kemi dërguar ty veçse mëshirë për botët."*[14] Pra, mëshira e tij nuk ishte vetëm ndaj myslimanëve. Ai sillej me butësi me fëmijët, të varfrit, fqinjët dhe njerëzit në përgjithësi. Ai a.s. na mësoi se mëshira duhet të jetë pjesë e karakterit të besimtarit.

Butësia dhe falja, urgjencë e kohës

Në kohën tonë shohim luftëra, varfëri, uri, refugjatë, fatkeqësi natyrore dhe njerëz që kanë nevojë për ndihmë. Përballë këtyre problemeve, myslimani nuk duhet të bëhet indiferent. Muhamedi a.s. ka thënë: "Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet."[15] Prandaj, një mësim i rëndësishëm që marr nga jeta e tij është: mos u bëj indiferent ndaj dhimbjes së tjetrit.

Çfarë dua të ndryshoj tek unë, pasi që Muhamedi a.s. është modeli më i mirë për ndryshimin tim

Pas gjithë këtyre mësimeve, mendoj se pyetja më e rëndësishme nuk është: "Sa shumë di për Muhamedin a.s.?" Pyetja kryesore është: "Çfarë ka ndryshuar tek unë pasi mësova për të?"

Nëse kam mësuar për durimin e tij, duhet të bëhem më i durueshëm. Nëse kam mësuar për mëshirën e tij, duhet të bëhem më i mëshirshëm. Nëse kam mësuar për ndershmërinë e tij, duhet të jem më i sinqertë. Nëse kam mësuar për kujdesin e tij ndaj të tjerëve, duhet të kujdesem më shumë për njerëzit që kanë nevojë. Nëse kam mësuar se ai a.s. e kontrollonte zemërimin, atëherë edhe unë duhet të mësoj ta kontrolloj veten.

Kjo është ajo që, sipas meje, duhet të mbetet pas muajit të Mevludit: jo vetëm kujtimi i Muhamedit a.s., por ndryshimi i vetes sipas mësimeve të tij.

PËRFUNDIMI

Jeta e Muhamedit a.s. është një histori e mbushur me mësime: nga fëmijëria e tij si jetim, kujdesi i Halimes, humbja e prindërve, martesa me Hatixhen r.a., ardhja e shpalljes, sprovat, Hixhreti, sakrificat dhe deri te morali, mëshira dhe sjellja e tij me njerëzit.

Por këto nuk janë vetëm ngjarje të së kaluarës.

Edhe në vitin 2026 kemi nevojë për besnikërinë e tij, durimin e tij, mëshirën e tij, drejtësinë e tij dhe moralin e tij.

Bota ka ndryshuar shumë, por njeriu ende ka nevojë për të njëjtat vlera: dashuri, besim, drejtësi, mëshirë, familje, durim dhe respekt.

Prandaj, mësimi më i madh që mora nga muaji i Mevludit është se dashuria për Muhamedin a.s. nuk duhet të mbetet vetëm në fjalë. Ajo duhet të shihet në sjelljen tonë.

Nëse pas Mevludit bëhemi pak më të mirë me prindërit, më të mëshirshëm me të dobëtit, më të sinqertë me njerëzit, më të durueshëm në sprova dhe më të kujdesshëm në fjalët tona, atëherë kemi marrë një mësim të vërtetë nga jeta e Muhamedit a.s. Sepse ne nuk kemi nevojë vetëm të flasim për jetën e tij. Kemi nevojë ta sjellim moralin e tij në jetën tonë.

1. Ibën Hisham, Es Siretu en Nebevijje, pjesa mbi fëmijërinë dhe qëndrimin e Muhamedit a.s. te Halime es Sadije.
2. Sahih el Buhari, Kitab el Edeb, kapitulli për kujdesin ndaj jetimit; gjithashtu Sahihu i Muslimit, Kitab ez Zuhd ve er Rekaik.
3. Sahih el Buhari, Bedu el Vahj (Fillimi i shpalljes), hadithi i parë në koleksionin e Buhariut.
4. Er Rum, 21.
5. El Alek, 1.
6. El Huxhurat, 6.
7. El Ahkaf, 35.
8. El Kalem, 4.
9. Sahihu i Muslimit, Kitab Salatil Musafirin ve Kasriha, transmetimi i Aishes r.a. për moralin e të Dërguarit a.s.
10. Ali Imran, 159.
11. Sahih el Buhari, Kitab el Edeb, hadithi mbi kontrollimin e zemërimit; Sahihu i Muslimit, Kitab el Birr ve Sile vel Adab.
12. El Enbija, 107.
13. Sahih el Buhari, Kitab el Edeb, dhe Sahihu i Muslimit, Kitab el Fedail, hadithi: "Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet."



Misioni i imamëve dhe dialogu i tyre në revistën "Zani i Naltë" (1923-1928)

Haxhere Shabani

Roli i imamit nuk kufizohet në udhëheqjen e namazit, por shtrihet në edukim, komunikim dhe orientim shoqëror. Debatet e zhvilluara mes dijetarëve shqiptarë një shekull më parë tregojnë se imami kërkohej të ishte i përgatitur për nevojat e kohës, pa humbur lidhjen me parimet fetare. Kjo kërkesë mbetet po aq aktuale edhe sot.

HYRJE

Islami si vlerë botërore është ngritur mbi bazën e komunikimit të mirëfilltë, qoftë të sferës disiplinare apo ndërdisiplinare.[1] Qenësore në mësimet islame janë të drejtat themelore të komunikimit, duke përfshirë të drejtat për të ditur, për të lexuar, për të shkruar dhe për t'u shprehur (komunikuar). Nocioni i el ilm (njohuri) mbizotëron në të gjitha mësimet kuranore si parim themelor i gjithë vlerës dhe etikës së komunikimit në Islam. Fjala *"Ikre"* (lexim) është fjala e parë që iu shpall të Dërguarit të fundit, Muhamedit a.s., e që përçon idenë e ndërgjegjshme dhe të përgjithshme për të komunikuar.[2] Veprat historike e biografike janë përplot shembuj dhe qëndrime të tilla fisnike, me dialogje e polemika të kulturuara dhe me moral të lartë islam.[3]

Një udhëheqës i namazit nuk është patjetër të jetë edhe imam, ndërsa imami është gjithmonë edhe një udhëheqës i namazit.

ROLI I IMAMIT NË SHOQËRI

Në traditën islame, parimisht, termi imam ka një kuadër të gjerë referencash; ai është përdorur për t'iu referuar udhëheqësit suprem, siç është halifja, por edhe një lideri të thjeshtë, siç është prijësi i namazit me xhemat. Është me rëndësi të bëjmë diferencimin ndërmjet këtyre titujve të imamit, veçanërisht si udhëheqës i komunitetit dhe imamit si udhëheqës i namazit me xhemat. Ky i fundit është një person i emëruar nga bashkësia vetëm për të udhëhequr faljen e namazit. Ndërsa, imami si udhëheqës i komunitetit është një personalitet fetar i trajnuar, i cili ka të drejtën dhe është i autorizuar për udhëheqjen e lutjeve, namazeve, për predikimin e ditës së xhumasë dhe në fushën fetare-teologjike është i kualifikuar. Një udhëheqës i namazit nuk është patjetër të jetë edhe imam, ndërsa imami është gjithmonë edhe një udhëheqës i namazit.

Imami ideal – imamët duhet të jenë përfaqësues dhe zëdhënës të bashkësisë myslimane. Do të duhej të kenë aftësi për komunikim profesional me publikun; të komunikojnë me udhëheqësit e feve të tjera; të jenë organizatorë, ndërmjetësues të shkathët; të jenë oratorë, mësues, trajnerë të mirë dhe multiplikatorë të zellshëm, të kenë informacione mbi historikun e atij vendi dhe pozitën e tij gjeografike; ta njohin mirë gjuhën e popullit të cilit do t'i shërbejnë; të kuptojnë traditën e tyre, zakonet dhe mënyrën e tyre të jetesës. Një imam i xhamisë është një model, drejtues dhe përfaqësues i komunitetit të tij. Imami është personi kyç për problemet e individëve, familjeve dhe shoqërisë. Ai dallohet nga mjedisi i tij nëpërmjet njohurive të jashtëzakonshme dhe arsyes.

IMAMI – AUTORITET DHE LIDER NË KOMUNITET

Imami në cilësinë e dijetarit islam është trashëgimtar i Pejgamberit a.s. dhe atë në bazë të hadithit, i cili thotë: "Ulematë janë trashëgimtarë të pejgamberëve të Zotit."[4] Prandaj, roli i imamit, sa është i ndershëm dhe privilegj, po aq është i përgjegjshëm para njerëzve dhe Zotit. Kështu, që të ketë sukses në misionin e tij dhe që të jetë i mirëpritur dhe i mirëpranuar në xhemat dhe në bashkësi, imami duhet t'i kushtojë kujdes disa udhëzimeve dhe kritereve, të cilat janë të rëndësishme në ushtrimin e misionit të tij. Me këtë rast, do t'ju ofroj disa mendime dhe reflektime për të parë se kush do të duhej të ishte një punonjës në detyrën e imamit:

Në radhë të parë dhe para së gjithash, imami duhet të ketë besim të fuqishëm dhe siguri të brendshme që reflekton në cilësitë tjera pasuese, t'i respektojë xhematin që ta përfitojë respektin e tyre,

duhet të jetë besnik dhe i ndershëm, të punojë në ekip, të ketë vizion të qartë për qëndrimet dhe qëllimet e tij, të ofrojë zgjidhje të situatave dhe jo vetëm t'i komentojë ato, të trajtojë problemet dhe të mos i ngarkojë ato mbi individët, por vetëm t'i këshillojë. Ai duhet të ketë durim t'i dëgjojë ata që dëshirojnë ta dëgjojnë, pastaj të këshillohet me xhematin, ta ndiejë përgjegjësinë e detyrës dhe ta kryejë atë me kënaqësi, të mos ushtrojë autoritet, por të udhëheqë bashkë me të tjerët, t'i këshillojë dhe t'u ofrojë atë që ata duan, imami duhet të mbjellë besimin, shpresën dhe të ngrejë vullnetin e xhematit, sukseset t'i ndajë bashkë me ta. Ai çdo ditë zgjohet duke e falënderuar Allahun që i ofroi edhe një mundësi që edhe një ditë të bëjë punën e imamllëkut, duke i shërbyer Islamit, myslimanëve dhe njerëzve në përgjithësi.[5]

KOMUNIKIM NDËRMJET IMAMËVE GJATË VITEVE 1923 -1928 TË PARAQITUR NË REVISTËN "ZANI I NALTË"

Letra në vijim është e vitit 1924 dhe është e hapur për gjithë ulematë e Meshihatit që ndodhen në Shqipëri[6], si reflektim, brengë dhe meditim për gjithë hoxhallarët e asaj kohe:

Me qenë se ulemaja janë zëvendësit e hasreti Muhamedit a.s., për me dalë në shesh vërtetësia e gjitha sëmundjeve që i kemi edhe për me i tregu gjitha barnat e shërimit të tyre, duhet shkoqitur të gjitha një nga një. Gjithë e dinë se feja mbahet e ruhet vetëm me dituri. Aty ku ka dije lulëzon Islami. Dhe zhdukja e


ZANI I NALTË

RIVISTË FETARE

MESNET EDHE ME FILOSOFI, MORAL, LETRATURE KOMBËTARE E SOCJOLOGJI

LANDA

diturisë ka shkaktuar përmbysje për shumë popuj dhe mbretëri. Për njeriun më i madhi armik është padituria. Pa dituri s'mundet të mbahet as fe, as shtet, as shtëpia e vet.

Zoti diturinë e quajti ngjallje – gjallëri, ndërsa padiurinë vdekje. Feja është mbajt me anën e medreseve, ishte e kushtëzuar që ato të zotërojnë dituri që i kërkon nevoja dhe koha. Të mundohen të nxjerrin ulema si Fahrudin Rraziu, Sujutiu, Ibni Sina etj.[7] Ulemaja e vjetër, përveç gjuhës arabe, zotëronin edhe gjuhë të huaj dhe kishin njohuri në mjekësi dhe inxhinieri etj. Gjashtëdhjetë (60) vite më parë, Aritmetika, Algjebra, Kozmografia mësoheshin nga Hafiz Isaku.[8]

Na shqiptarët në Shqipëri mundemi me mbajt fenë, në qofshin se bijtë e bijave tona do t'u mësojmë Kuranin bashkë me kuptimin e tij. Të ndershëm ulema, nuk është koha me flejt, se shumë të rinj nuk dinë shehadetin, pastaj kush do t'i mbajë xhamitë. Porta e pejgamberisë është mbyll, por porta e vilajetit – evlijave – dhe e diturisë kurrë nuk mbyllen. Pra, rinia të edukohet në rrugën e pejgamberit dhe t'i armatosim me dituritë që e lyp koha.[9]

Na shqiptarët duhet për çdo katund nga një alim. Pikat që duhet bërë për kujdesin për brezin e ri:

Çunat e gocat mos t'ia dorëzojmë misionarëve, atyre t'ua mësojmë Kuranin, nëse i mbushin mbi 18 vjet, me dërgu në medrese. Të ndërtohen medrese me standard të lartë dhe të financuara nga populli. Aty të mësohet gjuha kombëtare dhe arabishtja, por edhe gjuhët e huaja tregtare, etj. Zoti na hapët sytë! H. Ali Korça.[10]

VEPRIMET E KËSHILLIT TË NALTË TË SHERIATIT DHE NEVOJAT E TRUPIT MYSLIMAN11

Këshilli hapi medresenë e naltë në një sistem fort të bukur, ku mësohet Kurani, arabishtja dhe dituritë e kohës – këshilli mundohet që medreseja t'i përngjajë medresesë Nizamije, prej së cilës dolën Ibni Ruzhdi, Ibni Sina dhe Fahredini etj.[12] Një dorë të kapim librin e Zotit që të zbukurojmë shpirtin e me tjetrën të kapim defterin e tregtisë që të mundim të rrojmë, ndërsa në zemrën tonë vetëm dashninë e Zotit. Të botohen revista fetare si: komentimi i të kaptinave të namazit, artikuj shoqërorë, moralë, ekonomikë, histori etj. Rregullore – mbi organizimin e vakëfeve, detyrave të nëpunësve të sheriatit, mbi të drejtat e burrit dhe gruas, etj.[13]

NEVOJAT E TRUPIT MYSLIMAN

Në Shqipëri, për fatkeq, në njëzet katunde ka një hoxhë-imam apo fare nuk ka. Për me mbajt shtetin, në popull duhet të rritet ndjenja fetare e kombëtare, na duhen së paku 2–3 mijë hatibë-imamë në Shqipëri. Çdo myfti të jetë edhe myderriz që t'i mësojë imamët e katundit. Shteti t'i japë rëndësi fesë dhe edukimit fetar që të ruhet Shqipëria moralisht dhe kombëtarisht. Të zgjidhet një grup shkrimtarësh që dinë arabishten, turqishten dhe persishten e të përkthejnë libra. Mjerisht, të zotët e



shkencës merren me politikë, nuk kemi histori, s'kemi gramatikë, s'kemi libra etj.[14]

DEKLARATË MBI NEVOJËN E REFORMAVE NGA SALI VUÇITËRNA[15]

Për ekzistencën e islamjetit, kemi nevojë të domosdoshme të bëjmë reforma. Fillimisht, autori shkruan për rregullin se gjithë jeta e popujve, e mbretërive dhe shteteve, ecën me përgatitjen e mjeteve në funksion të përparimit dhe nevojës së kohës dhe, e kundërta, nga gjumi dhe dembelia do të jenë të shtypur dhe të mbaruar.[16]

> Mjerisht, të zotët e shkencës merren me politikë, nuk kemi histori, s'kemi gramatikë, s'kemi libra etj.

Kemi një sheriat aq të bukur e të plotësuar, sa që principet e shëndosha të tij ka me mbajt në fuqi si një libër të shenjtë deri në të sosun të kësaj jete. Sa më shumë që të përparojë bota dhe të zhvillohet mendja e njeriut, aq më tepër i shtohet vlefta dhe rëndësia e parimeve të tija. E më pastaj nxitë në rregullimin e xhamive, medreseve, rregullimin e rrugëve etj.[17] Se myslimani duhet të jetë i interesuar për çështje tregtare, industriale, bujqësore dhe pika tjera të mjeshtërisë që shërben për ngritje ekonomike, për të shpëtuar njëherë e mirë nga zgjedha ekonomike e huaj. Të përmirësohet gjendja morale, shoqërore e ekonomike. T'i hapim sytë e të shohim si përparuan popujt e qytetëruar, e të ndjekim edhe na gjurmët e tyre... Me i bërë ballë nevojave të kohës me reforma të tilla që të ecim përpara.[18]

Ne xhemati Islamije në Shqipëri duhet të bëjmë reforma, ta themelojmë një institut modern për të përgatitë hoxhë të shquar dhe me dituri të gjerë. Të hapim shkolla për të varfër dhe jetimë, kështu që të mos mbesin rrugëve, por të pajisen me njohuri të jetës, po ashtu edukim dhe arsimimin e vajzave etj.[19] Ne xhemati Islamije në Shqipëri duhet të bëjmë reforma, ta themelojmë një institut modern për të përgatitë hoxhë të shquar dhe me dituri të gjerë. Të hapim shkolla për të varfër dhe jetimë, kështu që të mos mbesin rrugëve, por të pajisen me njohuri të jetës, po ashtu edukim dhe arsimimin e vajzave etj.[20]

Z. DREJTORIT TË REVISTËS "ZANI NALTË" NGA HAFIZ XHAFERI[21]

Brenda këtij debati kyçet Hafiz Xhaferi, i cili thoshte: Për deklaratën e Sali Vuçitërnit për reformat, duke e përkrahur për xhamitë edhe për medresetë, por me një kërkesë nga opinioni i jugut të vendit – Korçë, që të hapet një me internat dhe klasë për qytetet e jugut.[22]

Për reagimin nga Hafiz Xhaferi, Sali Vuçitërna, i përgjigjet:[23] Më të vërtetë, m'u kënaq shpirti nga ky zë i bukur që vjen nga naltësia e Korçës. Ai ajër i pastër i atij vendi, padyshim, ka ushqyer njerëz me mend të kulluar, me tru të shëndoshë dhe gjykime të thella, të cilat i kuptojnë fare mirë nevojat themelore që ka trupi mysliman. Sa i përket asaj që kam thënë, jam mbështetur në principin e dy gjërave: nxënësit dhe personeli, që i ka sjellë statistikat kështu që numri i nxënësve shkodranë prin me 121, pastaj Tirana me 66 e të tjerat kanë numër shumë të vogël; për të realizue atë, i nderuar, duhet buxhet, personel dhe nxënës ma shumë, e që këto nuk janë.[24] Pastaj, në këtë numër pason artikulli: "Një fjalë mbi deklaratën time".

Disa hoxhallarë të Shkodrës, si Z. Hafiz Isuf Karakaçi dhe Tahir Myftiu me shokë, nuk i paska pëlqye deklarata që kisha ba në numri 7, viti 1927, mbi nevojën e reformave; këta zotni më quajtën me këto deklarata se jam kundër sheriatit dhe kërkuan nga kryemyftiu refuzimin e kësaj deklarate, pasi e shikova prapë artikullin tim dhe vërtetova se asgjë nuk mundesh me sheriatin, u mbetët atyre të ndriçojnë se çka është kundër sheriatit në deklaratën time.[25]

Ndërsa, në numrat në vijim vazhdon debati mes këtyre protagonistëve, herë-herë kemi edhe artikuj në përkrahje të Sali Vuçitërnit, e në këtë vijë kemi edhe artikullin nga J. Latifi, i cili e ndan fenë në dy çështje kryesore: 1) Parimet dogmatike dhe 2) Bazat që sigurojnë marrëdhëniet në këtë jetë në mes njerëzve, e kjo e fundit jep dritën se reforma është shumë e nevojshme për përmirësimin e gjendjes ndërmjet njerëzve, që bota islame i ka përjetuar në periudhën e dekadencës; autori aty kritikon zotërit në fjalë, Tahir Myftiun dhe H. I. Karakaçin, duke i pyetur se ata a dojnë dritën apo terrin.[26]

Këtij debati i jep fund përgjigjja nga Këshilli i Naltë, ku thuhet: "Rëndësia e vakufit daton prej Ibrahimit a.s. deri te Muhamedi a.s. dhe është çështje shumë delikate. Të pranohet mendimi i Z. Sali Vuçitërnes, drejtor i përgjithshëm i vakufeve, përkitazi me reformat, nëse vërtetohet ekzistenca e njërës nga të tri mënyrat që shënohen këtu poshtë:

Nëse institucionet mirëbërëse, si xhami apo medrese etj., moralisht apo materialisht marrin teposhtën, bëhen të panevojshme, jofunksionale, sipas Imam Muhamedit kthehen në pasuri të thjeshtë dhe kështu përfitojnë myslimanët si pasuri e thjeshtë.

Ato vakufe të lëna nga pushteti apo sundimtarët e atij qarku, nëse nuk kanë dokumente që e vërtetojnë pronarin legal të tyre, mund të përdoren si nevojë të komunitetit mysliman.

Nëse ndihet nevoja shtrënguese për transferim të institucioneve bamirëse në një gjendje që pajtohet me nevojat e shekullit dhe, nëse nuk është e mundur, nëse nuk ka rrugë tjetër, pra, në fund, përmirësohet një pjesë e tyre duke e sakrifikuar pjesën tjetër.[27]

DEKLARATA E II E SALI VUÇITËRNËS, (E BOTUAR NË NUMRIN 3 DHE 4 TË VITIT 1928)

Historia është pasqyra e jetës të gjitha kombeve të botës. Ajo është gjykuesja e shoqërisë njerëzore, na tregon ngritjen dhe ramjen e popujve, shkaqet e përparimit ose të zhdukjes së tyre. Historia si do të na vlerësojë nesër? A do na lavdërojë apo do të na mallkojë. Historia na tregon se popujt që janë përpjekë janë naltësu, ndërsa ata që janë mjaftu me trashëgimin pa përpjekje janë poshtërue. Myslimanët e Shqipërisë që jetojmë duhet të hjekin mentalitetin që kemi në frazën arabe (Vexhedena eba-na – kështu i gjetëm të parët), të fillojmë punën, të çmojmë nevojat e kohës që të përparojmë.[28]

Rregull që të ecësh me nevojat e kohës është rregull i përparimit i të gjithë popujve; këtë e vërteton sheriati i Zotit i ardhur përmes pejgamberëve. Ai njeri, ai popull, ai shtet që s'është i përgatitur me kohën s'ka të drejtë me jetu mbi faqe të dheut, përveç si i shtypur. Kurani si sheriat i plotë dhe Muhamedi a.s. si vulë e profetëve nuk ka vënë kufi në kuptimin e Kuranit, pra përpjekja për studim do të vazhdojë në çdo kohë dhe çdo vend deri në kiamet.

Tani ne myslimanët e Shqipërisë që ndodhemi në gjumë të rëndë duhet të zgjohemi, sidomos ne që jemi të thirrur hoxhallarët, që t'i shohim dhe të veprojmë rregullat themelore për ringjalljen e popujve, duke u ba ballë rreziqeve të kohës e ndryshimeve të saj. Sa më shumë zhvillohet bota dhe plotësohet mendja e njeriut, aq më shumë i shtohet vlefta, shkëlqimi, kuptimi dhe rëndësia e sheriatit.

A nuk është turp të themi se respektojmë sheriatin, e sheriati na urdhëron bashkimin, vllaznin e dashnin mes veti, larg përçarjes dhe ndjenjës së ftohtë mes veti, ku nga dora dhe gjuha e myslimanit janë të sigurt të tjerët. A nuk është turp të rrimë dhe të jetojmë pa-angazhime, kurse sheriati na urdhëron punën, shkathësinë dhe zhvillimin. Sheriati na urdhëron pastërti në mendje, trup dhe shpirt; a nuk është turp me ecë në baltë ndërsa sheriati na thotë se pjesë e besimit është me largue pengesat nga rruga. T'i mbajmë xhamitë të pastra e të bukura, t'i mbajmë medresetë e shekullit XX me standarde të larta e jo të jenë si burgje të errëta. A nuk është turp që rrimë në gjumë e kotësi, humbje kohe nëpër kafe e vende të kota, ndërsa në Perëndim njerëzit jetojnë me plot energji dhe aktivitete të dobishme.

Të forcohemi në ekonomi, tregti e ushtri, të nxam çdo dituri e çdo mjeshtëri që të lirohemi nga çdo robëri e huaj. Liria politike është një strehë e një zhvillimi të drejtë të popullit, por ajo ecën edhe me pavarësi ekonomike. Nuk është turp me pa të metat tona që të përmirësohemi.[29]

Për një të huaj dhe për një mysliman të painformum, imazhi i myslimanit është jo i mirë; injorant, i pamoral, hipokrit, rrenacak, antikombëtar, nuk e don përparimin, i cili i duket mëkat me u civilizue, për një njeri që e quan bidat jetën e rregullume, që jeta e lumtur është veç jeta tjetër. Paria fetare duhet të kujdeset që ta pastrojë këtë imazh-titull me njollë të zezë, me vepra, jo me fjalë. Jemi mbetë mbrapa qytetërimit, shpikjes dhe mjeshtërive të reja. Të jemi prisa në çdo punë të mirë e të mbarë të njerëzisë.[30]

PËRFUNDIMI

Në përfundim të këtij punimi themi se detyra e imamit dhe prijësve fetarë është e një rëndësie jetike për popullin. Ata janë pishtarë ndriçues të rrugës, dritës, udhëzimit dhe shpëtimit njerëzor. Jeta dhe veprimtaria e tyre është e lidhur me ringjalljen dhe ngritjen e popullit, andaj të gjitha proceset e popullit, si kulturore, ekonomike dhe shoqërore etj., janë procese që imamët i përjetojnë në jetën e tyre. Duke parë rolin e tyre në shoqëri, themi se dialogu mes tyre është një proces sa i vështirë, aq edhe i rëndësishëm. Autorët e përfshirë në këtë dialog, si h. Ali Korça



me letrën drejtuar gjithë ulemasë në Shqipëri, pastaj deklaratat e Sali Vuçitërnës I dhe II, treguan kujdesin dhe përkushtimin e prijësve fetarë për ringjalljen e vlerave përmes reformave, të cilat reforma janë të përshtatshme me nevojat e kohës. Reforma këto të cilat janë gjithëpërfshirëse, por në theks të veçantë në fushën e edukimit dhe arsimit tek brezi i ri. Duke parë për së afërmi gjendjen jo të mirë të popullit në çdo aspekt, ata ngritën zërin e tyre të mbështetur në fjalën e Zotit, Kuranin e madhëruar dhe këshillat e Pejgamberit Muhamed a.s., që t'i hapim sytë e të shohim si përparuan popujt e qytetëruar, e të ndjekim edhe ne gjurmët e tyre në lëmenjtë e përparimit. Me i bërë ballë nevojave të kohës me reforma të tilla që të ecim përpara e të forcohemi në të gjitha lëmenjtë, si dhe të lirohemi nga çdo robëri e huaj. Nuk është turp me i pa të metat tona që të përmirësohemi – kështu vinte në konkluzion përfundimtar Sali Vuçitërna në deklaratën e dytë. Krejt në fund themi se ai preokupim i atyre prijësve fetarë për zhvillim dhe avancim para një shekulli, në paralelen e kohës dhe të hapësirës sonë, është aktual dhe ndjehet nevoja për dialog të tillë edhe në kohën tonë!

1 Edukata islame nr. 104, f.146.

2 Po aty, f.147.

3 Taha Xhabir el Ulvani, Kultura e dialogut në Islam, (Logos-A,), Shkup, 2000, f. 136.

4 Ibën Hiban el Bustij, Muhamed, Sahih (Bejrut, Dar Ibën Hazëm, 2012) 1/550.

5 Muhidin Ahmeti Trajnimi i imamit dhe sfidat e kohës | UAIS, i kyçur më 12.05.2024.

6 Zani i Naltë nr. 8 maj 1924). Vëmendje: Kemi bërë disa ndërhyrje për të lehtësuar dhe shkurtuar tekstin.

7 Po aty, f. 240.

8 Po aty, f. 243.

9 Po aty, f. 244.

10 Po aty, f. 245.

11 Zani i Naltë, nr. 3 maj 1925. U realizuan disa ndërhyrje lehtësuese dhe përmbledhëse në tekst.

12 Po aty, f. 459.

13 Po aty, f. 461.

14 Po aty, f. 464.

15 Zani i Naltë, nr. 7 viti 1927.

16 Po aty, f. 196.

17 Po aty, f. 197.

18 Po aty, f. 201.

19 Po aty, f. 203.

20 Po aty, f. 206.

21 Zani i Naltë, nr. 8 mars 1927.

22 Po aty, f. 255.

23 Zani i Naltë, nr. 9 prill 1927.

24 Po aty, f. 275.

25 Po aty, f. 273.

26 Zani i Naltë, nr. 11, qershor, 1927, f. 420.

27 Po aty, f. 409-412.

28 Zani i Naltë, nr. 3, viti 1928, f. 470.

29 Zani i Naltë, nr. 4, viti 1928, f. 503.

30 Po aty, f. 505.



Rregullimi i së drejtës për lirinë e ndërgjegjes dhe fesë në Hungari

Ejup Ramadani

Hungaria e ka ndërtuar lirinë fetare mbi një kuadër kushtetues e ligjor që njeh autonominë e bashkësive fetare dhe ndarjen e tyre nga shteti. Në të njëjtën kohë, legjislacioni parashikon forma bashkëpunimi, mbështetje financiare dhe të drejta të posaçme për komunitetet fetare. Ky model synon të ndërthurë lirinë e besimit me funksionimin institucional të fesë në shoqëri.

SFONDI KUSHTETUES DHE LIGJOR

Ligji Themelor i Hungarisë njeh dhe garanton në mënyrë të plotë të drejtën për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë rregullohet më tej nga Ligji Kardinal CCVI i vitit 2011 "Për të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, si dhe për statusin juridik të kishave, denominacioneve dhe bashkësive fetare", i cili përcakton kuadrin ligjor për ushtrimin e lirisë fetare dhe statusin juridik të organizatave fetare.

Ligji Themelor i Hungarisë njeh dhe garanton në mënyrë të plotë të drejtën për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Në vlerësimin e tij mbi versionin e Ligjit për Kishat, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2012, Komisioni i Venecias, megjithëse shprehu kritika lidhur me disa dispozita të tij, theksoi se ligji "përbën një kornizë bujare dhe liberale për ushtrimin e fesë".

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i publikuar më 1 mars 2013, nuk konstatoi cenim të së drejtës për lirinë e ndërgjegjes dhe fesë. Megjithatë, ai evidentoi mangësi në procedurat dhe rregullat që lidhen me njohjen juridike të kishave.

Raporti Ndërkombëtar për Lirinë Fetare i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara për vitin 2013, i publikuar më 28 korrik, arriti në përfundimin se Ligji Themelor dhe legjislacioni hungarez në përgjithësi garantojnë mbrojtjen e lirisë fetare. Gjithashtu, raporti vlerësoi se, pas ndryshimeve të vitit 2013 në Ligjin për Kishat, janë zvogëluar dallimet në trajtimin juridik të bashkësive fetare.

Respektimi i së drejtës për lirinë e ndërgjegjes dhe fesë në Hungari u konfirmua gjithashtu nga bashkësitë fetare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa statusin e Kishës së njohur zyrtarisht. Përfaqësuesit e Aleancës së Kishave të Lira Ungjillore dhe të Aleancës Ungjillore Hungareze e pohuan këtë gjatë takimit me ministrin e Burimeve Njerëzore më 26 shtator 2014.

Neni VII i Ligjit Themelor të Hungarisë, pas Amendamentit të Pestë, parashikon si vijon:

"(1) Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të zgjedhur ose ndryshuar fenë apo bindjet e tjera, si dhe për t'i shfaqur, ushtruar ose mësuar ato, individualisht ose së bashku me të tjerët.

(2) Personat që ndajnë të njëjtat parime të besimit mund të themelojnë bashkësi fetare për ushtrimin e fesë së tyre, të strukturuara në formën organizative të përcaktuar me një Ligj Kardinal.

(3) Shteti dhe bashkësitë fetare veprojnë të ndara nga njëratjetra. Bashkësitë fetare janë autonome.

(4) Shteti dhe bashkësitë fetare mund të bashkëpunojnë për arritjen e qëllimeve me interes për komunitetin. Me kërkesë të një bashkësie fetare, Kuvendi Kombëtar vendos për një bashkëpunim të tillë. Bashkësitë fetare që marrin pjesë në këtë bashkëpunim veprojnë si kisha të njohura (*established churches*). Shteti u siguron atyre privilegje të veçanta në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në përmbushjen e detyrave që shërbejnë për arritjen e qëllimeve me interes për komunitetin.



(5) Rregullat e përgjithshme që kanë të bëjnë me bashkësitë fetare, si dhe kushtet, kishat e njohura dhe rregullat e hollësishme që lidhen me to, përcaktohen me një Ligj Kardinal."

Deri më tani, Kuvendi Kombëtar ka njohur 32 bashkësi fetare si kisha të pranuara. Fillimisht, sipas ligjit, ai njohu kishat, e kaluara historike dhe integrimi i konsiderueshëm shoqëror i të cilave në Hungari përbënin arsye të mjaftueshme për një njohje të tillë. Më pas, ai njohu dhe shpalli si kisha të pranuara disa nga kishat kryesore neoprotestante me rëndësi ndërkombëtare (si metodistët, adventistët, pentekostalët, mormonët dhe Ushtria e Shpëtimit), si dhe përfaqësuesit autentikë hungarezë të feve kryesore botërore, si myslimanët, budistët dhe hindutë. Një praktikë e tillë nuk mund të konsiderohet e zakonshme as në nivel evropian.

STATUSI JURIDIK I BASHKËSIVE FETARE

Brenda një bashkësie fetare, kuadri organizativ për ushtrimin e të drejtës themelore kushtetuese për lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë realizohet përmes një kishe të njohur ose një organizate që ushtron veprimtari fetare.

Statusi juridik i bashkësive fetare përmblidhet si vijon:

- Ato veprojnë të ndara nga shteti. Shteti nuk mund të administrojë veprimtarinë e tyre dhe as të themelojë organe përgjegjëse për mbikëqyrjen ose drejtimin e tyre.
- Ato kanë të drejtë të organizohen dhe të funksionojnë në përputhje me parimet, normat dhe rregullat e tyre të brendshme, si dhe me rendin e riteve fetare.
- Ato mund të marrin pjesë në veprimtari që kontribuojnë në krijimin dhe promovimin e vlerave shoqërore.
- Veprimtaria e tyre fetare gëzon mbrojtje të posaçme juridike në kuadër të legjislacionit për kundërvajtjet dhe të legjislacionit penal.
- Ato gëzojnë mbrojtje juridike për emërtimin, simbolet dhe rendin e riteve të tyre fetare.
- Ato kanë të drejtë të përdorin termin "kishë" në emërtimin e tyre dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.
- Ato kanë të drejtë të përcaktojnë mënyrën e krijimit të marrëdhënies së anëtarësisë, strukturën organizative, si dhe kompetencat, përgjegjësitë dhe autorizimet e personave të ngarkuar për marrjen, mbikëqyrjen dhe zbatimin e vendimeve që kanë të bëjnë me organizatën që ushtron veprimtari fetare, duke devijuar nga rregullat e përgjithshme që zbatohen për shoqatat. Ato mund të marrin pjesë në marrëdhënie juridike civile pa asnjë kufizim.

TË DREJTAT E BASHKËSIVE FETARE NË USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TYRE

Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, bashkësitë fetare kanë të drejtë:

- Të përfitojnë nga një regjim tatimor më i favorshëm sesa ai që zbatohet për personat juridikë që ushtrojnë kryesisht veprimtari ekonomike ose tregtare, veçanërisht sa i përket tatimit mbi fitimin.
- Të jenë përfituese të 1% të tatimit mbi të ardhurat personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit për veprimtaritë arsimore, të arsimit të lartë, shëndetësore, bamirëse, të mbrojtjes sociale, të mbrojtjes së familjes, fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për veprimtaritë kulturore dhe sportive që zhvillojnë.
- Të lidhin kontrata të kursim-ndërtimit, në përputhje me legjislacionin përkatës.
- Të përdorin vepra muzikore gjatë riteve dhe ceremonive fetare pa detyrimin për pagesën e tarifave të së drejtës së autorit.
- Të përfitojnë nga kryerja e punës në interes publik në favor të tyre pa kufizime.
- Të ofrojnë shërbime kapelanike dhe kujdes pastoral në institucionet korrektuese dhe ato të ekzekutimit të sanksioneve penale.
- Të ushtrojnë lirinë e tubimit për zhvillimin e riteve, ceremonive, manifestimeve dhe procesioneve fetare pa kufizime.
- Të organizojnë mësimdhënie fetare në institucionet e arsimit të lartë që administrohen prej tyre.
- Të zhvillojnë mësimdhënien e parimeve të besimit dhe të katekizmit mbi bazë vullnetare.
- Të organizojnë ceremoni funerale dhe varrime sipas riteve të tyre fetare.
- Të pranojnë persona të dënuar për kryerjen e punës riparuese ose të punës në interes publik, të caktuar me vendim në procedurat penale.

Kështu, organizatat e angazhuara në veprimtari fetare mund të përdorin gjithashtu emërtimin "kishë", me ç'rast sigurohet mbrojtja e identitetit të këtyre komuniteteve. Organizata që ushtron veprimtari fetare është person juridik që vepron në bazë të së drejtës së asociimit, por themelohet për të ushtruar të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë dhe regjistrohet nga Gjykata Rajonale e Budapestit, në mënyrë që emërtimi "kishë" të mund të regjistrohet ndërkohë, me kërkesë të komunitetit fetar përkatës. Rregulloret ligjore sigurojnë kuadrin organizativ për ushtrimin e së drejtës së lirisë së ndërgjegjes dhe fesë dhe, brenda kësaj, pavarësinë e këtyre komuniteteve nga shteti në një masë të gjerë.

Komunitetet fetare të regjistruara më parë nga gjykatat si kisha mund të vazhdonin veprimtarinë e tyre me vazhdimësi juridike; ato ruajtën identitetin e tyre juridik, pasuritë dhe institucionet e tyre. Institucionet e tyre që kryejnë shërbime publike mund të vazhdojnë veprimtarinë me subvencione shtetërore (institucionet e tyre sociale marrin të ashtuquajturin subvencion standard shtetëror, pedagogët që punojnë në shkollat e tyre paguhen nga shteti dhe ministria kompetente ka lidhur marrëveshje me disa organizata të angazhuara në veprimtari fetare që mirëmbajnë dhe menaxhojnë shkolla, në bazë të së cilave atyre u jepet gjithashtu një subvencion i veçantë që korrespondon me subvencionet plotësuese të ofruara për kishat për funksionimin e tyre). Ato kanë të drejtë të marrin 1% të tatimit mbi të ardhurat personale që mund t'u ofrohet organizatave joqeveritare dhe, në Hungari, organizatat joqeveritare kanë të drejtë të përfitojnë nga një gamë e gjerë lehtësirash financiare, të cilat natyrisht mund t'u jepen edhe organizatave të angazhuara në veprimtari fetare. Aktet vjetore për buxhetin e shtetit përfshijnë një ndarje të veçantë buxhetore për mbështetjen e funksionimit të organizatave të angazhuara në veprimtari fetare.

Pas miratimit të Amendamentit të vitit 2013 të Ligjit për Kishat, organizatat e angazhuara në veprimtari fetare janë bërë të ngjashme me kishat e njohura si në emërtim, ashtu edhe sa i përket statusit të tyre juridik dhe funksionimit. Kjo është bërë mbi bazën e konsultimeve paraprake, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e disa komuniteteve fetare që nuk janë njohur si kisha, por që kanë si qëllim themelor ushtrimin e lirë të besimit të tyre. Përmes kësaj, Ligji ka përmbushur gjithashtu kërkesën e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese, sipas së cilës "Kuvendi Kombëtar duhet të miratojë rregulla të tilla që lidhen me formën specifike juridike të funksionimit të komuniteteve fetare, të cilat u lejojnë atyre më shumë liri në krijimin dhe rregullimin e organizimit të tyre të brendshëm sesa organizatave të tjera shoqërore të strukturuara në mënyrë demokratike."

Përveç kompetencave të mësipërme që u janë dhënë çdo komuniteti fetar, kishat e pranuara me status juridik publik gëzojnë të drejtat e mëposhtme:

- kanë të drejtë për mbështetje buxhetore në të njëjtën masë si institucionet shtetërore, për aktivitetet e tyre në shërbimet publike;
- mund të zhvillojnë mësime të teologjisë dhe etikës fetare që zëvendësojnë mësimin e detyrueshëm të etikës/moralit në shkolla;
- zyrtarët e tyre fetarë janë të përjashtuar personalisht nga pagesa e detyrimeve doganore;
- veprimtaria e tyre ekonomike (e lidhur me veprimtarinë e tyre fetare) nuk konsiderohet veprimtari biznesi ose sipërmarrëse;
- të ardhurat e tyre nga veprimtaritë fetare dhe përdorimi i tyre nuk mund të auditohen nga asnjë organ shtetëror (përfshirë 1% të tatimit mbi të ardhurat personale dhe shtesën buxhetore përkatëse, lehtësimin për pasuritë e paluajtshme dhe shtesën e tij);
- janë të përjashtuara nga pagesa e taksës për automjetet;
- nuk janë subjekte të taksave lokale (përveç taksës turistike);
- çdo përfitim me vlerë monetare i dhënë kishës së pranuar në lidhje të drejtpërdrejtë me një shërbim fetar është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- zbatohen rregulla të favorshme për kontabilitetin dhe deklaratat tatimore;
- donacionet me interes publik të dhëna për një kishë të pranuar janë të përjashtuara nga TVSh-ja.





Historia e pandarë shqiptare

Sadik Mehmeti & Ramadan Shkodra

Historia shqiptare nuk mund të ndahet sipas përkatësive fetare, politike apo ideologjike. Figurat kombëtare duhen kuptuar në kontekstin e kohës së tyre, mbi bazën e burimeve dhe jo të paragjykimeve të sotme. Skënderbeu, ashtu si trashëgimia jonë historike, është pjesë e një kujtese të përbashkët shqiptare.

KUNDËR PËRVETËSIMIT FETAR TË FIGURAVE KOMBËTARE – RASTI I SKËNDERBEUT

Kohëve të fundit, në hapësirën shqiptare, po shohim një përplasje rreth figurave historike që, në pamje të parë, mund të duket si debat i thjeshtë për një person ose për një periudhë të caktuar, por në të vërtetë problemi është shumë më i gjerë se kaq. Po shfaqet një prirje për t'i parë disa figura kombëtare përmes përkatësisë fetare, politike ose ideologjike dhe, mbi këtë bazë, për t'i afruar me një grup e për t'i larguar nga një tjetër. Në disa raste kemi përvetësim, në disa të tjera mohim, ndërsa në raste të tjera tentohet që një figurë historike t'i paraqitet një pjese të shqiptarëve si *"e tyre"*, me nënkuptimin se pjesa tjetër nuk ka të drejtë ta konsiderojë të tillë.

NGA MOHIMI I JASHTËM TE PËRÇARJA E BRENDSHME

Rasti i Skënderbeut është sot shembulli më i dukshëm i gjithë kësaj që po themi, por problemi nuk fillon me Skënderbeun dhe as nuk përfundon me të. Për ta kuptuar këtë dukuri, duhet të kthehemi pak mbrapa, sepse ajo ka një histori më të gjatë dhe lidhet me mënyrën se si është trajtuar historia shqiptare nga historiografi të ndryshme të fqinjëve tanë, nga nacionalizmat ballkanikë, nga ideologjitë politike dhe, në një periudhë më të vonshme, edhe nga vetë shqiptarët.

Në Ballkan, historia ka qenë për një kohë të gjatë pjesë e betejës për identitetin, territorin dhe legjitimitetin politik. Me formimin e nacionalizmave moderne, nuk mjaftonte më pretendimi mbi një territor, por duhej krijuar edhe një e kaluar që ta mbështeste atë pretendim. Për këtë arsye, në historiografitë e ndryshme të rajonit u zhvilluan rrëfime që, në raste të caktuara, e vendosën historinë në shërbim të projekteve kombëtare e politike.

Shqiptarët, për shkak të pozitës së tyre në Ballkan, të shpërndarjes së tyre në disa shtete dhe të historisë së ndërlikuar politike të rajonit, janë përballur vazhdimisht me këtë problem. Në periudha të ndryshme, pjesë të historiografive fqinje janë përpjekur të zvogëlojnë praninë historike shqiptare, ta paraqesin atë si të vonshme ose të ardhur, të mohojnë vazhdimësinë e saj apo të shkëpusin nga historia shqiptare figura që kanë luajtur role të rëndësishme politike, ushtarake, kulturore e intelektuale, duke krijuar kështu një narrativë që e dobëson vetëdijen historike të shqiptarëve dhe e bën më të lehtë nënshtrimin dhe sundimin e tyre.

Natyrisht, kjo nuk do të thotë se të gjithë historianët e rajonit dhe të vendeve të tjera e kanë parë historinë shqiptare në të njëjtën mënyrë. Problemi nuk qëndron te kombësia e historianit, por te mënyra se si shkruhet dhe interpretohet historia.



Ka studiues të huaj që kanë bërë punë të çmuar për historinë shqiptare dhe ka edhe historianë shqiptarë që kanë gabuar. Mirëpo, problemi fillon kur historia nuk kërkon më të vërtetën, por përdoret për të vërtetuar një përfundim të vendosur më parë.

Kështu, kur një figurë nuk mund të mohohet përballë dokumenteve dhe veprës që ka lënë pas, mund të provohet një rrugë tjetër: *përvetësimi*. Figura pranohet se ka ekzistuar, por mohohet ose zvogëlohet përkatësia e saj shqiptare, duke u përvetësuar dhe vendosur brenda një historie tjetër kombëtare, fetare apo kulturore.

Shembuj që e ilustrojnë këtë ka me shumicë. Dhe kjo dukuri nuk është shfaqur vetëm me një figurë. Në historiografinë dhe diskursin publik të rajonit janë diskutuar në mënyra të ndryshme figura shqiptare të politikës, ushtrisë, kulturës, artit e letërsisë, prej figurave më të hershme dhe sidomos atyre të periudhës osmane, të cilët janë shkëputur nga prejardhja, veprimtaria, lidhjet e tyre familjare, kulturore e shoqërore dhe raportet e tyre me hapësirën shqiptare, duke bërë që një pjesë e kontributit të tyre të mbetet jashtë vëmendjes së historisë shqiptare.

Ka studiues të huaj që kanë bërë punë të çmuar për historinë shqiptare dhe ka edhe historianë shqiptarë që kanë gabuar. Mirëpo, problemi fillon kur historia nuk kërkon më të vërtetën, por përdoret për të vërtetuar një përfundim të vendosur më parë.

Mirëpo, kjo nuk është vetëm një çështje që vjen nga jashtë. Përveç këtij problemi, shqiptarët kanë pasur edhe një problem të brendshëm, i cili e ka komplikuar edhe më tej këtë çështje.

HISTORIA SHQIPTARE DHE TRASHËGIMIA E NJË KORNIZE IDEOLOGJIKE

Për dekada, gjatë sistemit komunist, historia shqiptare u trajtua brenda një kornize të fortë ideologjike. Kjo shihet qartë në mënyrën se si u trajtuan periudha osmane, Mbretëria Shqiptare, lëvizjet nacionaliste dhe tradita politike antikomuniste. Periudha osmane, për shembull, u shpjegua kryesisht përmes kategorive të pushtimit, shfrytëzimit dhe prapambetjes, sa kohë që shqiptarët gjatë kësaj periudhe nuk jetonin jashtë historisë së Perandorisë Osmane. Ata ishin pjesë e saj në mënyra të ndryshme. Kishte shqiptarë në administratë, ushtri, diplomaci, arsim, tregti, jetën fetare dhe në strukturat politike të Perandorisë. Kishte familje shqiptare që patën ndikim të madh në jetën politike e shoqërore të shekujve XV - XIX, kishte dijetarë, myderrizë, poetë, klerikë, administratorë, ushtarakë etj. Kishte edhe kundërshtime, kryengritje, konflikte, kërkesa për autonomi dhe procese të ndryshme politike që, në rrethana të caktuara, çuan drejt formave më të qarta të vetëdijes kombëtare. Të gjitha këto janë pjesë e historisë shqiptare.

Në këtë aspekt duhet parë edhe përkatësia e madhe e shqiptarëve në Islam, e cila gjatë shekujve u bë pjesë e rëndësishme e jetës së tyre shoqërore, kulturore, arsimore dhe politike. Kjo prani nuk mbeti vetëm çështje e besimit individual, por u shpreh edhe përmes institucioneve dhe formave të ndryshme të jetës shoqërore. Xhamitë, medresetë, bibliotekat, mektebet, teqetë dhe vakëfet krijuan një hapësirë të gjerë institucionale, arsimore e kulturore, në të cilën vepruan dijetarë, myderrizë, imamë, poetë, administratorë dhe intelektualë shqiptarë. Një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë së shkruar shqiptare të shekujve osmanë u krijua pikërisht në këtë mjedis. Prandaj, kjo trashëgimi nuk mund të trajtohet si diçka e jashtme ndaj historisë shqiptare; përkundrazi, ajo është pjesë e saj dhe dëshmon për një dimension të rëndësishëm të jetës së shqiptarëve gjatë kësaj periudhe.

Prandaj, periudha osmane nuk mund të studiohet vetëm duke pyetur se si shqiptarët iu kundërvunë apo si e luftuan Perandorinë. Duhet të dimë edhe si jetuan brenda saj, çfarë institucionesh krijuan, çfarë roli luajtën, çfarë veprash lanë dhe si ndryshoi shoqëria shqiptare gjatë këtyre shekujve.

Historia shqiptare nuk ka ndodhur vetëm brenda kufijve të shtetit të sotëm shqiptar dhe as vetëm brenda hapësirës që përfytyrojmë sot si hapësirë shqiptare. Ajo është zhvilluar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Sanxhak, Çamëri, por edhe në qendra të tjera ku shqiptarët kanë jetuar dhe vepruar, si Stambolli, Bukureshti, Sofja, Kajroja dhe Selaniku. Këto qendra nuk janë pjesë e hapësirës shqiptare në kuptimin territorial, por janë pjesë e historisë shqiptare përmes pranisë dhe veprimtarisë së shqiptarëve atje.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për periudhën osmane, kur një pjesë e konsiderueshme e jetës politike, administrative, fetare, arsimore dhe kulturore të shqiptarëve u zhvillua brenda një hapësire shumë më të gjerë se ajo që përfytyrojmë sot si hapësirë shqiptare. Prandaj, kjo periudhë duhet të shihet me një horizont më të gjerë, me më shumë dokumente dhe me më pak paragjykime të trashëguara. Nuk bëhet fjalë këtu për ta idealizuar Perandorinë Osmane dhe as për të zëvendësuar një interpretim ideologjik me një tjetër.

Historia e shqiptarëve gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, në një pjesë të historiografisë shqiptare, është trajtuar mbi premisa dhe interpretime që, jo rrallë, kanë qenë të ndikuara nga qasje të caktuara të historiografive serbe dhe ruse, si dhe nga qasje të caktuara historiografike me orientim filokatolik. Një qasje e tillë ka ndikuar që periudha osmane të paraqitet pothuajse ekskluzivisht si burim i prapambetjes, dhunës dhe ndërprerjes së zhvillimit historik të shqiptarëve, ndërsa rrethanat e tjera historike nëpër të cilat kanë kaluar trojet shqiptare janë trajtuar me një standard krejtësisht tjetër.



Përndryshe, si shpjegohet që për pothuajse çdo dukuri negative në historinë shqiptare përgjegjësia t'i ngarkohet periudhës së Perandorisë Osmane, ndërsa historiografia dhe qarqe të caktuara flasin rrallë ose fare nuk flasin për ndikimet dhe pasojat e periudhës romake, bizantine dhe të sundimit të shteteve mesjetare serbe dhe, në veçanti, të periudhës së Stefan Dushanit?

Duhet pasur parasysh se këto periudha patën ndikime të rëndësishme në besimin dhe jetën fetare të popullsive të trojeve të këtyre hapësirave. Gjatë periudhës romake, krishterimi u përhap në këto hapësira dhe, pas ndryshimit të politikës së Perandorisë Romake ndaj krishterimit në shekujt IV–V, ai u shndërrua gradualisht në bazë të organizimit të ri fetar e shoqëror. Në periudhën bizantine, këto zhvillime u ndërthurën me ndryshimet në juridiksionet dhe organizimin kishtar, ndërsa më vonë trojet shqiptare u bënë hapësirë e ndërthurjes së ndikimeve të Kishës së Romës dhe të Kostandinopojës.

Edhe sundimi i shteteve mesjetare serbe solli ndryshime në organizimin fetar dhe në marrëdhëniet ndërmjet pushtetit dhe komuniteteve fetare. Një shembull i veçantë është periudha e Stefan Dushanit, gjatë së cilës zgjerimi politik u shoqërua me forcimin e organizimit kishtar ortodoks. "Kodi i Dushanit" përmban një numër të madh dispozitash për fenë, Kishën, klerin dhe jetën monastike; 38 nenet e para të Kodit i kushtohen drejtpërdrejt fesë dhe Kishës, ndërsa Kodi parashikon edhe masa kundër prozelitizmit dhe konvertimit nga ortodoksia në katolicizëm.

Këto zhvillime tregojnë se ndryshimet në besimin, strukturën kishtare, juridiksionet fetare dhe marrëdhëniet ndërmjet pushtetit dhe komuniteteve fetare kanë një histori shumë më të gjatë se periudha osmane. Për këtë arsye, ndikimet fetare të periudhave romake, bizantine dhe të sundimit mesjetar serb duhet të merren në konsideratë kur shqyrtohet historia fetare dhe shoqërore e shqiptarëve dhe nuk mund të lihet përshtypja se ndryshimet e thella në këtë fushë fillojnë vetëm me periudhën osmane.

Një historiografi serioze dhe e paanshme kërkon që çdo periudhë historike të shqyrtohet në kontekstin e saj, duke u mbështetur në burime dhe duke iu nënshtruar të njëjtit standard kritik. Vetëm një qasje e tillë mund të shmangë interpretimet selektive dhe të ideologjizuara, duke e trajtuar historinë shqiptare si një proces kompleks, të formësuar nga periudha, pushtete dhe rrethana të ndryshme historike.

Kjo është një prej arsyeve pse kemi ende nevojë për studime të reja, sidomos mbi periudhën osmane dhe mbi figurat që për shumë kohë janë parë vetëm nga njëra anë.

NGA NDIKIMET E TRASHËGUARA TE PROBLEMI QË PO KRIJOJMË VETË

Këtyre ndikimeve të trashëguara u shtohet edhe një problem i brendshëm, të cilin po e krijojmë vetë. Në një kohë kur kemi më shumë mundësi se kurrë për të hyrë në arkiva, për të konsultuar dokumente të ndryshme, për të krahasuar historiografi dhe për të rishikuar përfundime të vjetra, po shfaqet një paradoks: *në vend që ta zgjerojmë historinë shqiptare, po fillojmë ta ngushtojmë atë nga brenda.*

Nëse dikur dikush nga jashtë përpiqej të na thoshte se kjo figurë nuk ishte shqiptare, sot po ndodh që një shqiptar, i mbështetur jo rrallë në interpretime spekulative dhe paragjykime fetare e ideologjike, t'i thotë një shqiptari tjetër se kjo figurë nuk është heroi yt.

Një gjë është ta kritikosh një figurë historike dhe krejt tjetër gjë është t'ia mohosh një pjese të shoqërisë të drejtën për ta konsideruar atë pjesë të historisë së vet.

Këtu duhet të jemi të qartë: figurat kombëtare shqiptare nuk mund të vlerësohen sipas dogmave fetare apo ideologjike të atij që i gjykon, as sipas interesave të politikës së ditës dhe as sipas nevojave të një grupi që kërkon të ndërtojë identitetin e vet duke ia mohuar një figure përmasën e saj të përbashkët.

Kjo vlen edhe për ata që, në emër të një "rikthimi në identitet" apo të një "rikthimi në fenë e të parëve", përpiqen ta shohin historinë shqiptare vetëm përmes një përkatësie fetare. Kontributi i shqiptarëve të krishterë në historinë tonë është evident dhe nuk ka nevojë të mbrohet duke lënë në hije rolin e shqiptarëve myslimanë. Po kështu, kontributi i shqiptarëve myslimanë nuk mund të përdoret për të lënë në hije atë të shqiptarëve të krishterë. Të dyja janë pjesë e historisë sonë.

Në të njëjtën mënyrë, prania myslimane nuk është një shtresë e jashtme e historisë shqiptare që mund të pranohet ose të refuzohet sipas bindjeve të sotme, por ajo është një pjesë historike e formimit dhe zhvillimit të shoqërisë shqiptare, me institucionet, personalitetet, veprat dhe trashëgiminë e saj.

Prandaj, edhe ndaj disa qëndrimeve të skajshme në diskursin fetar mysliman duhet të zbatojmë të njëjtin standard kritik. Nëse Skënderbeu paraqitet vetëm si luftëtar kundër myslimanëve dhe, mbi këtë bazë, shqiptarëve myslimanë u mohohet e drejta ta shohin atë si hero kombëtar, atëherë një figurë historike po gjykohet përmes ndarjeve fetare të kohës sonë, në vend që të vlerësohet në kontekstin e saj historik. Por po aq problematike është edhe përpjekja e disa qëndrimeve të skajshme në diskursin katolik për ta lidhur shqiptarësinë kryesisht me katolicizmin dhe për ta paraqitur Skënderbeun, apo figura të tjera kombëtare, si pronë të komunitetit katolik.

Të dyja këto qasje bëjnë të njëjtin gabim: marrin një dimension të identitetit të një figure historike dhe e paraqesin atë si tërësinë e saj. *Por historia nuk funksionon kështu.*

SKËNDERBEU NUK ËSHTË PRONË E ASKUJT

Se historia nuk funksionon kështu, më së miri e tregon rasti i Skënderbeut. Skënderbeu është një figurë historike e dokumentuar, që i përket një kohe dhe një hapësire të caktuar dhe që, me veprimtarinë e tij, ka lënë gjurmë të rëndësishme në historinë shqiptare dhe më gjerë. Jeta e tij duhet parë dhe studiuar në tërësinë dhe kompleksitetin e saj: origjina dhe përkatësia e tij etnike e fetare, lidhjet me botën osmane, përvoja ushtarake, kthimi në Krujë, marrëdhëniet me fuqitë e kohës, luftërat kundër Perandorisë Osmane, si dhe lidhjet politike e fetare me botën evropiane. Asgjë nga këto nuk ka arsye të fshihet. Përkundrazi, pikërisht këto duhet t'i studiojmë dhe t'i kuptojmë në kontekstin e kohës.

Nëse dikush e quan Skënderbeun "atlet të Krishtit" dhe këtë shprehje e përdor për ta bërë figurën ekskluzivisht të një komuniteti, atëherë e tejkalon kufirin e një vlerësimi historik. Por edhe nëse dikush e sheh atë vetëm si luftëtar kundër një perandorie islame dhe, mbi këtë bazë, kërkon t'ua mohojë shqiptarëve myslimanë të drejtën ta konsiderojnë hero, atëherë po bën të njëjtin gabim, vetëm nga ana tjetër.

Perandoria Osmane ishte një perandori me karakter të fuqishëm islam, me institucione, norma dhe një legjitimitet politik të lidhur me Islamin, por njëkohësisht ishte edhe një perandori shumetnike dhe shumëgjuhëshe. Përplasjet e saj me principatat dhe fuqitë e kohës nuk mund të shpjegohen thjesht si një përballje "myslimanësh kundër të krishterëve". Në marrëdhëniet e asaj kohe ndërthureshin politika, dinasti, territore, interesa ekonomike, aleanca dhe fe.

Edhe më e rëndësishme është kjo: nëse një figurë historike do të gjykohej vetëm nga feja e shtetit kundër të cilit ka luftuar, atëherë si do t'i vlerësonim shqiptarët myslimanë që, gjatë shekujve, sidomos në shekujt XVIII - XX, kundërshtuan pushtetin osman, u ngritën kundër administratës së tij, luftuan kundër ushtrive osmane dhe kërkuan autonomi apo ndryshime politike? A do t'ua mohonim edhe atyre vendin në historinë shqiptare vetëm pse kundërshtuan një shtet me karakter islam? Sigurisht që jo. Atëherë, pse duhet ta bëjmë këtë me Skënderbeun?

Pikërisht për këtë arsye, një figurë historike duhet të vendoset në kohën dhe rrethanat e veta dhe të vlerësohet në tërësinë e veprimtarisë së saj, jo vetëm përmes kategorive fetare të ditëve tona.

FIGURAT DHE HERONJTË KOMBËTARË NUK NDAHEN SIPAS FESË

E njëjta gjë vlen edhe, fjala vjen, për Fan Nolin, Gjergj Fishtën, Papa Kristo Negovanin, dom Nikollë Kaçorrin dhe shumë të tjerë. Përkatësia e tyre fetare është pjesë e pandashme e jetës dhe veprimtarisë së tyre dhe nuk ka arsye të fshihet apo të zbehet. Por as nuk mund të përdoret për t'u thënë shqiptarëve të tjerë se ata nuk janë pjesë e historisë sonë.

Në të njëjtën mënyrë, një figurë shqiptare myslimane nuk mund të përvetësohet vetëm nga myslimanët. Haxhi Ymer Prizreni, Dervish Cara, Haxhi Zeka, Bajram Curri dhe Isa Boletini nuk janë vetëm të atyre që pajtohen me ta në pikëpamje politike. Hasan Prishtina nuk është pronë e një krahu politik. Adem Demaçi nuk mund të vlerësohet vetëm përmes interpretimeve politike që janë bërë për të gjatë jetës së tij. Adem Jashari, Hamëz Jashari dhe figurat e tjera të luftës së fundit nuk mund të përvetësohen nga një parti apo grup politik. Me çfarë të drejte ia ndajmë njëri-tjetrit këto figura? Askush nuk na e ka dhënë këtë të drejtë.

KRITIKA ËSHTË E DOMOSDOSHME, POR MOHIMI NUK ËSHTË KRITIKË

Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se figurat historike duhet të mbrohen nga kritika. Përkundrazi, një shoqëri e pjekur nuk ka nevojë t'i shohë heronjtë si të pagabueshëm. Një hero nuk është shenjtor dhe një figurë historike nuk është e paprekshme. Ne duhet t'i studiojmë figurat tona mbi bazën e dokumenteve dhe të kemi guximin të korrigjojmë edhe atë që mund të jetë ekzagjeruar nga tradita jonë ose nga një histori e ndërtuar mbi premisa ideologjike.

Por këtu qëndron dallimi i madh: kritika historike nuk është e njëjtë me mohimin. Kritika nis nga burimet dhe e ndjek argumentin aty ku të çon. Mohimi, përkundrazi, shpesh nis nga një përfundim i paracaktuar dhe më pas kërkon vetëm ato të dhëna që mund ta mbështesin.

Një historian mund të kritikojë, fjala vjen, Marin Barletin, të diskutojë burimet për Skënderbeun, të rishqyrtojë një betejë apo një ngjarje. Kjo është pjesë e punës historiografike. Por nëse një figurë mohohet që në fillim vetëm sepse nuk i përshtatet një bindjeje fetare, politike apo ideologjike, atëherë nuk kemi më të bëjmë me kritikë historike.

Pikërisht për këtë arsye, duhet të jemi kritikë edhe ndaj disa historianëve tanë, disa klerikëve dhe disa intelektualëve kur interpretimet e tyre nisen nga bindje të paracaktuara dhe jo nga burimet dhe argumentet historike. Shkurt thënë: figurat historike nuk duhet të mbrohen apo të rrëzohen mbi bazën e autoritetit të atij që flet, por mbi bazën e argumentit dhe të burimeve.

NUK MUND TË MOHOHET NJË FIGURË, AQ MË PAK NJË PERIUDHË E TËRË E HISTORISË SONË

Këtu duhet thënë edhe diçka shumë e rëndësishme për historinë shqiptare: nuk mund të mohohet një figurë shqiptare e dokumentuar vetëm sepse nuk na përshtatet. Aq më pak mund të mohohet një periudhë e tërë prej rreth pesë shekujsh të historisë sonë, siç po përpiqen të bëjnë disa.

Periudha osmane është pjesë e historisë sonë, pavarësisht se si e vlerësojmë politikisht atë sistem. Nuk mund ta fshijmë nga historia dhe as ta paraqesim vetëm si një periudhë në të cilën shqiptarët kanë qenë viktima, pa veprimtari politike, pa institucione, pa personalitete dhe pa krijimtari. Por, po ashtu, nuk kemi arsye ta romantizojmë këtë periudhë. Detyra e historianit është ta studiojë atë në tërësinë e saj, mbi bazën e burimeve.

Gjatë kësaj periudhe u shquan familje, dinasti lokale dhe personalitete shqiptare që meritojnë të rishikohen seriozisht. Bushatlinjtë, Ali Pashë Tepelena, Mehmet Ali Pasha i Egjiptit, Mahmutbegollajt, Vlorajt, Kurtpashajt, Asllanpashalitë, Toptanajt, Rrotllajt, Gjinollët, Dërrallajt dhe shumë familje e personalitete të tjera luajtën role të rëndësishme në jetën politike të Perandorisë Osmane dhe të rajonit. Disa prej tyre u përplasën



me pushtetin qendror osman, ndërtuan pushtete lokale dhe ndoqën politika që, në rrethana të caktuara, prekën edhe çështjen e autonomisë.

Nuk po themi se të gjithë këta duhet të shpallen automatikisht heronj kombëtarë. Kjo do të ishte një tjetër mënyrë për ta thjeshtuar historinë. Po themi se duhet t'i studiojmë dhe t'i kuptojmë në kontekstin e kohës së tyre.

Nëse Skënderbeu është i rëndësishëm edhe për shkak të përballjes së tij me Perandorinë Osmane, atëherë nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes edhe shqiptarët që, edhe para Skënderbeut e edhe shekuj më vonë, e sfiduan atë perandori nga brenda, ndërtuan pushtete lokale dhe luajtën role të rëndësishme në zhvillimet politike që i paraprinë zgjimit kombëtar. Edhe përplasjet e tyre me pushtetin osman, përfshirë luftërat që zhvilluan kundër tij, janë pjesë e historisë dhe duhet të studiohen si të tilla.

Në vend që të merremi vetëm me pyetjen se kujt i përket një figurë historike, duhet të shkojmë te burimet dhe të zbulojmë edhe ata njerëz e ngjarje që ende nuk i kemi studiuar sa duhet. Në arkivat dhe bibliotekat e vendeve që kanë pasur marrëdhënie me shqiptarët ruhen dorëshkrime, dokumente, kronika, defterë dhe shumë burime të tjera. Kjo është një pasuri e madhe dokumentare që ende kërkon të hulumtohet dhe të ndriçohet nga studiuesit.

ÇFARË ËSHTË HEROI?

Dhe këtu shtrohet një pyetje e rëndësishme: *çfarë e bën dikë hero? Heroi nuk është njeriu që nuk ka gabuar kurrë dhe as ai që duhet të përputhet me bindjet tona të sotme. Një figurë bëhet e rëndësishme në*

histori për atë që ka bërë, për rolin dhe ndikimin që ka pasur, por edhe për mënyrën se si është kujtuar dhe vlerësuar nga brezat pasardhës. Me kalimin e kohës, mënyra se si e shohim një figurë mund të ndryshojë. Mund të rrëzohet një mit, të korrigjohet një datë, të zbulohet një dokument i ri ose të rishikohet një interpretim i mëparshëm. Kjo është pjesë e natyrshme e punës së historianit. Por ndryshimi i një vlerësimi duhet të mbështetet në burime dhe argumente, jo në dëshirën për ta përshtatur të kaluarën me bindjet e së tashmes.

Në këtë kuptim, me interes është edhe fjala e Adem Demaçit në iftarin e Ramazanit të vitit 2000, në hotelin "Iliria" në Prishtinë, gjatë promovimit të librit "Skicë e mendimit politik shqiptar" të Hysamedin Ferajt. Në prani të më shumë se dyqind të pranishmëve, Demaçi, duke folur për mënyrën se si trajtoheshin disa figura kombëtare, tha: *"Populli shqiptar është popull i vogël, është popull i ndarë, është popull që çështjen e vet nuk e ka të zgjidhur akoma, prandaj dhe si i tillë nuk ka heronj për të gjuajtur, nuk ka heronj për të mohuar dhe për të përbuzur e përbaltur."*

Kjo fjalë e Demaçit ka një kuptim që shkon përtej rastit në të cilin u tha. Një popull që ka kaluar nëpër përpjekje të gjata për ta mbrojtur historinë dhe kujtesën e vet nuk duhet ta kthejë sot të kaluarën në një fushë për përplasje të reja, ku figurat historike përdoren për të ndarë shqiptarët nga njëri-tjetri. Por Demaçi nuk duhet kuptuar sikur kërkonte që figurat historike të mos kritikohen. Përkundrazi, ato duhet të studiohen, të shqyrtohen dhe, kur burimet e kërkojnë, edhe të rivlerësohen. Ajo që duhet shmangur është mohimi pa argument, përbaltja dhe përdorimi i figurave historike si mjet për të goditur njëri-tjetrin. Kritika historike na ndihmon ta kuptojmë më mirë të kaluarën; përbaltja vetëm e shtrembëron atë.

HISTORIA SHQIPTARE ËSHTË TRASHËGIMI E PËRBASHKËT

Në fund, çështja nuk është vetëm Skënderbeu. Ai është rasti më i dukshëm i një problemi që po shfaqet gjithnjë e më shumë në shoqërinë shqiptare. Nëse dikush përpiqet ta përvetësojë një figurë për shkak të fesë dhe t'ia mohojë atë pjesës tjetër të shqiptarëve, duhet ta kundërshtojmë. Po njësoj duhet të kundërshtojmë edhe përpjekjen për ta mohuar një figurë vetëm sepse nuk përputhet me bindjet fetare të dikujt. Nëse një historian e deformon një figurë për arsye ideologjike, duhet ta kritikojmë; nëse një klerik e përdor atë për një qëllim fetar që shkon përtej asaj që dëshmojnë burimet, duhet ta themi; po kështu, duhet të jemi kritikë edhe kur një politikan e përdor historinë për nevojat e ditës.

Kriteri duhet të jetë i njëjtë për të gjithë. Nuk mund të mbajmë anën e një grupi kundër një tjetri, qoftë në emër të fesë, politikës apo bindjeve të tjera. As historianët nuk kanë të drejtë të përjashtojnë klerikët nga debati vetëm për shkak të përkatësisë së tyre, as klerikët historianët për shkak të profesionit të tyre. Ajo që duhet të na udhëheqë janë burimet, argumentet dhe ajo që mund të dëshmohet.

Shkurt: historia shqiptare nuk është pronë e të krishterëve, as e myslimanëve; nuk është pronë e komunistëve, e nacionalistëve, e një partie politike apo e ndonjë grupi intelektualësh a klerikësh. Ajo është trashëgimi e përbashkët shqiptare dhe, si e tillë, duhet trajtuar me përgjegjësi dhe mbi bazën e burimeve.

PËRFUNDIMI

Në fund të kësaj trajtese, bëhet e qartë se rreziku nuk qëndron vetëm te mënyra se si të tjerët e kanë mohuar, tjetërsuar apo përvetësuar historinë shqiptare. Rreziku më i madh do të ishte që ne vetë të fillojmë ta ndajmë atë sipas bindjeve politike, ideologjike apo fetare.

Nëse Skënderbeu bëhet vetëm hero i shqiptarëve të krishterë, ndërsa figurat e traditës islame vetëm të shqiptarëve myslimanë, atëherë nuk po krijojmë një histori më të drejtë, por dy histori shqiptare: një "tonën" dhe një "të tyren". Në këtë mënyrë nuk ndahen vetëm figurat, por edhe kujtesa dhe trashëgimia jonë e përbashkët.

Historia shqiptare është ndërtuar nga njerëz të besimeve të ndryshme, në kohë dhe rrethana të ndryshme. Këto dallime janë pjesë e historisë sonë dhe nuk duhet të shndërrohen në kufij mes shqiptarëve.

Mund t'i kritikojmë figurat tona, të mos pajtohemi me veprimet e tyre dhe t'i shohim nga këndvështrime të ndryshme. Por pyetja nuk duhet të jetë se cilit shqiptar i përket një figurë, por çfarë vendi zë ajo në historinë tonë të përbashkët.

Për ne, si shqiptarë, Skënderbeu është hero kombëtar. Këtë të drejtë nuk kemi nevojë të na e japë askush dhe askush nuk ka të drejtë ta kushtëzojë atë me përkatësinë fetare. Shqiptari mysliman nuk duhet të ndihet i detyruar të heqë dorë nga Skënderbeu për shkak të besimit të tij, as shqiptari i krishterë të heqë dorë nga trashëgimia e shqiptarëve myslimanë për shkak të përkatësisë së tyre fetare.

Po kështu, nuk mund të mohohen pesë shekuj të historisë sonë vetëm sepse ajo periudhë nuk përputhet me një interpretim të sotëm të shqiptarësisë. Ajo periudhë ka ndodhur dhe shqiptarët kanë jetuar e vepruar brenda saj. Prandaj, ajo duhet studiuar dhe kuptuar, jo fshirë.

Kjo nuk është vetëm përgjegjësi e historianëve. Është përgjegjësi e studiuesve, intelektualëve, klerikëve, politikanëve dhe e shoqërisë shqiptare në përgjithësi që historia të mos përdoret për të na përçarë. Në këtë frymë duhet kuptuar edhe ky shkrim: si një përpjekje për ta parë historinë shqiptare në tërësinë e saj, pa e ndarë sipas përkatësive dhe pa e bërë pronë të njërit apo të tjetrit.

Historia shqiptare është e jona. Është e të gjithëve. Është e përbashkët. Është një. Dhe pikërisht për këtë arsye, nuk duhet ta bëjmë pronë të askujt.



Vështrim historik mbi kontributin e revistës “Dituria Islame” në historiografinë shqiptare

PhD cand. Agon Krasniqi

“Dituria Islame” nuk ka qenë vetëm një revistë fetare, por edhe një hapësirë e rëndësishme e mendimit kulturor, historik dhe kombëtar shqiptar. Në periudha të vështira për Kosovën, ajo dokumentoi zhvillimet, ruajti kujtesën historike dhe nxori në pah figura e trashëgimi të lëna shpesh në margjinë. Kështu, revista u bë pjesë e vetë historisë që synonte ta dëshmonte.

HYRJE

Revista “Dituria Islame” u themelua në vitin 1986, në një periudhë kur shqiptarët e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare përballeshin me sfida të shumta politike, kulturore dhe ideologjike. Në këto rrethana, botimet islame nuk kishin vetëm karakter fetar, por shërbenin edhe si platforma intelektuale dhe shkencore për ruajtjen e vetëdijes historike e kombëtare. Përmes artikujve, studimeve, dokumenteve arkivore, biografive të figurave të rëndësishme dhe trajtesave historike, revista krijoi një hapësirë ku historia shqiptare trajtohej nga një këndvështrim më i gjerë kulturor dhe civilizues.

REVISTA “DITURIA ISLAME” NË KONTEKSTIN KRONOLOGJIK

Në fazën e parë, gjatë viteve 1986–1990, revista u përball me rrethana të vështira pune. Krahas entuziazmit dhe vullnetit për të kontribuar, mungonin mjetet e nevojshme për botimin e saj, ndërsa pushteti i atëhershëm përpiqej të pengonte çdo përpjekje për një rizgjim islam të popullit të Kosovës.1 Kjo fazë përfshinte numrat 1–17. Organizimi i revistës ishte: kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës: Jetish Bajrami; Këshilli redaktues: Jetish Bajrami, Sherif Ahmeti, dr. Rexhep Boja, Emin Behrami, Avni Aliu, Resul Rexhepi dhe Rexhep Luma; lektor: Mehmet Halimi; korrektor: Rexhep Luma; redaktor teknik: Ali Govori.[2]

Përmes artikujve, studimeve, dokumenteve arkivore, biografive të figurave të rëndësishme dhe trajtesave historike, revista krijoi një hapësirë ku historia shqiptare trajtohej nga një këndvështrim më i gjerë kulturor dhe civilizues.

Në fazën e dytë, e cila përfshinte periudhën 1991–1996, revista hyri në një proces konsolidimi, me përfshirjen e kuadrove dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, me nr. 18 – 84. Kryeredaktor ishte mr. Qemajl Morina. Këshilli botues përbëhej nga dr. Rexhep Boja, Jetish Bajrami, Sherif Ahmeti, mr. Iliaz Rexha, Hajrullah Hoxha, Asllan Murati dhe Nehat Krasniqi. Në Këshillin redaktues bënin pjesë dr. Feti Mehdiu, dr. Muharrem Pirraku, mr. Shemsi Ajvazi, mr. Shemso Shaqiroviq (Emin Behrami), Qazim Qazimi, Naim Tërnava, Nexhat Ibrahimi, Elez Osmani dhe mr. Qemajl Morina. Lektor ishte mr. Mehmet Halimi, redaktor teknik: Shemsi Gërguri dhe korrektor: Sabit Jaha. Më vonë, në detyrën e korrekturës u angazhuan Hasan Emërllahu, Mejreme Mehmeti, Jusuf Gashi dhe Qemajl Selishta. Dizajni i revistës u realizua nga Nysret Simnica, ndërsa nga nr. 50 (1993) redaktor teknik ishte Hanefi Berisha.3

Faza e tretë u karakterizua nga një stabilitet më i madh institucional dhe nga bashkëpunimi me



autorë të fushave të ndryshme, por njëkohësisht përkoi me vitet më të vështira për mbijetesën e revistës. Gjatë kësaj periudhe u thelluan zhvillimet politike që i paraprinë luftës së fundit në Kosovë dhe veprimeve të dhunshme të Serbisë ndaj popullsisë shqiptare. Rrethanat politike sollën vështirësi materiale dhe pakësim të bashkëpunëtorëve, megjithatë revista vazhdoi veprimtarinë, ruajti stafin dhe bashkëpunëtorët e saj dhe arriti të mbijetonte gjatë luftës, duke rifilluar punën pas saj.[4] Në këtë fazë, kryeredaktor ishte Sabri Bajgora për numrat 85–124 (1996–2000). Në redaksi bënin pjesë: Ahmet Sadriu, Emin Behrami, Elez Osmani, Hajrullah Hoxha, Nehat Krasniqi dhe Sulejman Osmani. Lektor ishte Mehmet Halimi dhe, nga nr. 86 (1996), Isa Bajçinca; redaktor teknik Hanefi Berisha; korrektor Skender Rashiti; dizajn kompjuterik Nysret Simnica; ndërsa nga nr. 123 (2000), operator kompjuterik ishte Nuhi Simnica. Elez Osmani shërbeu si sekretar i redaksisë nga nr. 100–109 (1998), ndërsa Bashkim Mehani u angazhua për kopertinën nga nr. 107 (1998) dhe më pas si redaktor teknik nga nr. 110 (1999).

Në mandatin e dytë, për numrat 107–124 (1998–2000), redaksia përbëhej nga Ahmet Sadriu, Emin Behrami, Elez Osmani, Hajrullah Hoxha, Nehat Krasniqi dhe Sulejman Osmani. Nga nr. 107 (1998) iu bashkuan redaksisë edhe Qemajl Morina, Naim Tërnava dhe Xhabir Hamiti. Lektor ishte Isa Bajçinca, redaktor teknik Hanefi Berisha dhe korrektor Skender Rashiti.[5]

Faza e katërt përfshin vitin 2000 e tutje dhe karakterizohet nga profesionalizimi i mëtejshëm i revistës dhe nga kontributi i saj në aspektin fetar, kulturor e kombëtar.[6] Për numrat 125–175 (2000–2005), kryeredaktor ishte Ahmet Sadriu. Në redaksi bënin pjesë Ali Vezaj, Bahri Simnica, Ferid Agani, Flamur Sofiu, Idriz Bilalli, Rexhep Lushta, Sabri Bajgora dhe Sulejman Osmani. Lektor ishte Isa Bajçinca, korrektor Skender Rashiti, redaktor teknik Bashkim Mehani dhe operator kompjuterik Nuhi Simnica. Nga numrat 127–128 (2001), revista u shoqërua edhe me uebsajt.

Në mandatin e dytë, për numrat 151–175 (2003–2005), redaksia përbëhej nga Ekrem Simnica, mr. Fahrush Rexhepi, Jakup Çunaku, mr. Musa Vila, mr. Rrahim Aliu, Sabri Bajgora, Sadik Mehmeti dhe dr. Zija Abdullahu. Lektor ishte Isa Bajçinca, korrektor Skender Rashiti, redaktor teknik Bashkim Mehani dhe operator kompjuterik Nuhi Simnica. Sekretar i redaksisë ishte Hajrullah Hoxha, ndërsa kopertinat, nga nr. 162 (2004), i realizonte Ymridin Trinaku.[7] Periudha deri në pavarësinë e Kosovës përfshinte numrat 176–223 (2005–2009), me Bahri Simnicën si kryeredaktor. Në redaksi bënin pjesë Agim Hyseni, Burhan Hoxha, Hajrullah Hoxha, Isa Memishi, Jakup Çunaku, Muharrem Tërnava, Muhamed Hoxha, Nexhmi Maksuti, Rexhep Suma dhe Sabri Bajgora. Lektor ishte Isa Bajçinca, korrektor Skender Rashiti, ndërsa kopertinën dhe redaktimin teknik i realizonte Ymridin Trinaku. Operator kompjuterik ishte Nuhi Simnica, ndërsa nga nr. 201 (2007) në redaksi u angazhua edhe gazetari Ramadan Shkodra.

Në mandatin e dytë, për numrat 201–223 (2007–2009), redaksia përbëhej nga Agim Hyseni, Burhan Hoxha, Jakup Çunaku, Miftar Ajdini, Muharrem Tërnava, Rexhep Lushta, Sabri Bajgora dhe Zaim Baftiu. Lektor ishte Isa Bajçinca, korrektor Skender Rashiti, ndërsa Ymridin Trinaku merrej me kopertinën dhe redaktimin teknik. Operator kompjuterik ishte Nuhi Simnica dhe gazetar i redaksisë Ramadan Shkodra.[8]

KONTRIBUTI I REVISTËS "DITURIA ISLAME" NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE NDËR VITE

Revista "Dituria Islame" paraqet një ndër institucionet më të rëndësishme të mendimit fetar, kulturor dhe intelektual shqiptar në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare. Kryeredaktori i parë i saj, haxhi Jetish efendi Bajrami, nën drejtimin e të cilit u botuan shtatëmbëdhjetë numrat e parë, në përvjetorin e njëzetë të revistës e theksonte karakterin e saj informativ, duke e përcaktuar objektivin kryesor si "informimi i drejtë dhe objektiv i besimtarëve".[9] Në periudha të caktuara, ky funksion informativ e tejkaloi tematikën e ngushtë fetare dhe përfshiu edhe çështje me karakter shoqëror e politik, veçanërisht gjatë fundit të viteve '80 dhe fillimit të viteve '90 të shekullit XX, kur shqiptarët e Kosovës përballeshin me represion sistematik nga pushteti serb.

Pas ndalimit të mediave shqiptare të shkruara dhe elektronike, ndër to edhe gazetës Rilindja, shqiptarët e Kosovës u përballën me një mungesë të theksuar të informacionit në gjuhën shqipe.[10] Në këto rrethana, "Dituria Islame", brenda mundësive të saj, mori një rol të rëndësishëm informativ dhe shoqëror, duke pasqyruar zhvillimet politike e shoqërore dhe duke ofruar një hapësirë për transmetimin e informacionit në gjuhën shqipe.

Vetëdija kombëtare dhe institucionale e redaksisë dhe e Bashkësisë Islame të Kosovës u reflektua edhe në mënyrën se si revista trajtoi raportin ndërmjet lirisë fetare dhe lirisë kombëtare e politike. Numrat e "Diturisë Islame" të kësaj periudhe dëshmojnë për një dimension të saj përtej atij fetar. Në faqet e revistës pasqyroheshin raste të ndryshme të dhunës dhe represionit serb ndaj shqiptarëve, si helmimet e nxënësve shqiptarë në shkolla,[11] largimet nga vendet e punës, ndalimi i mediave shqipe, burgosja e deputetëve shqiptarë, plaçkitja ekonomike dhe shkatërrimi i objekteve fetare islame. Ndër rastet e veçanta ishte edhe publikimi i lajmit për akuzimin e fëmijës pesëvjeçar Fidan Asllani nga policia serbe për kinse sulm ndaj saj, rast që revista e paraqiti si

dëshmi të trajtimit absurd dhe diskriminues ndaj shqiptarëve.[12]

Përveç dokumentimit të represionit serb, revista botonte qëndrimet e subjekteve politike shqiptare, organizatave kulturore e shoqërore dhe deklaratat e tubimeve popullore që mbështesnin pavarësinë e Kosovës dhe kundërshtonin masat represive të regjimit serb. Edhe gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në vitet 1997–1999, "Dituria Islame" vazhdoi të pasqyronte zhvillimet dramatike të kohës dhe çështjen e lirisë së Kosovës. Në rrethana kur vihej në pikëpyetje vetë ekzistenca e popullsisë shqiptare, një pjesë e konsiderueshme e hapësirës editoriale iu kushtua çështjes kombëtare. Ky transformim u realizua me mbështetjen e udhëheqjes së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të redaksisë së revistës.[13]

Ky orientim u shfaq edhe në paraqitjen vizuale të revistës. Në numrin 85 të vitit 1996 u paraqit flamuri kombëtar dhe përkujtimi i pavarësisë së Shqipërisë. Në numrin 101 të vitit 1998 u paraqit shtëpia e Adem Jasharit me mbishkrimin "Drenica – Kurban i Lirisë". Në numrat 108–109 të vitit 1999 u paraqitën pamje nga varrimi pas masakrës së Reçakut, ndërsa në numrat 129–130 të vitit 2001 u trajtua dëbimi i shqiptarëve nën sloganin "Shqiptarofobia sllave". Këta janë disa nga shembujt që dëshmojnë për hapësirën e veçantë që revista i kushtoi historisë kombëtare dhe çështjeve me rëndësi për shqiptarët.

Përveç rolit në afirmimin e çështjes kombëtare, "Dituria Islame" u shndërrua në një tribunë për prezantimin e vlerave identitare të kulturës shqiptare. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, hapësirat për publikime shkencore dhe publicistike në gjuhën shqipe ishin ngushtuar ndjeshëm. Në këtë situatë, revista u bë një platformë e rëndësishme për vazhdimin e veprimtarisë intelektuale dhe shkencore të studiuesve shqiptarë.

Një ndër kontributet e rëndësishme të "Diturisë Islame" ishte trajtimi i marrëdhënies ndërmjet trashëgimisë fetare dhe asaj kombëtare. Në faqet e revistës, këto dy dimensione paraqiteshin si pjesë të një tërësie historike dhe kulturore. Përmes analizave dhe trajtimeve të mbështetura në burime dokumentare, revista solli në vëmendje kontributin fetar dhe atdhetar të shumë figurave shqiptare, duke kontribuar edhe në rikthimin e disa prej tyre në diskursin historiografik.

Një shembull domethënës është figura e myderriz Ymer Prizrenit, e cila ishte margjinalizuar në disa interpretime të mëhershme historiografike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.[14] Përmes trajtimit të figurave të tilla, revista argumentonte se anashkalimi i personaliteteve me rol të rëndësishëm në jetën fetare e kombëtare mund të ndikojë edhe në kuptimin e plotë të ngjarjeve historike.

Në faqet e saj u trajtuan periudha të ndryshme të historisë shqiptare, nga Beteja e Kosovës e vitit 1389 deri te zhvillimet bashkëkohore. Vëmendje të veçantë morën ngjarje dhe periudha vendimtare, si Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe pushtimi sllav i vitit 1912. Revista trajtoi gjithashtu figura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe personalitete të tjera me rëndësi kombëtare, ndër të cilët hoxha Hasan Tasini, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Abdyl Frashëri, Ibrahim Dalliu, hafëz Ali Korça, Vehbi Dibra, Hoxhë Voka dhe Xheladin Vesel Guta.[15]

Një tjetër dimension i rëndësishëm ishte kontributi në nxjerrjen në dritë të trashëgimisë kulturore shqiptare, veçanërisht të letërsisë alhamiado-shqipe. Punimet e studiuesve kontribuuan në plotësimin e mozaikut të trashëgimisë shkrimore shqiptare të realizuar me alfabet arab.[16]

Revista pati rëndësi edhe në aspektin gjuhësor. Duke qenë e orientuar drejt lexuesit shqipfolës, ajo përdori gjuhën standarde shqipe si faktor të kohezionit kulturor dhe historik. Njëkohësisht, trajtoi trashëgiminë shpirtërore dhe materiale shqiptare me shtresim islam. Në këtë kuadër dallohen kontributet e Adem Zejnullahut dhe Shefqet Pllanës për elementet islame në folklorin shqiptar, si dhe studimet e Sadik Mehmetit dhe Ramadan Shkodrës për monumentet materiale islame.[17]

Një karakteristikë tjetër e rëndësishme ishte angazhimi publicistik dhe shoqëror i revistës. Editorialet dhe reagimet lidhur me zhvillimet politike e shoqërore pasqyronin qëndrimet e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe trajtonin sfidat e kohës. Në këtë aspekt dallohen kontributet e autorëve si Qemajl Morina, Naim Tërnava, Rexhep Boja dhe Resul Rexhepi.[18]

1 Revista "Dituria Islame" nr. 197, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës), 3.
2 H. Jetish Bajrami, "Fillimi i Diturisë Islame", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 9.
3 Qemajl Morina, "Jubileu që na gëzon", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 10.
4 Revista "Dituria Islame" nr. 197, 3.
5 Sabri Bajgora, "Vitet që bënë historinë", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 11.
6 Revista "Dituria Islame" nr. 197, 3.
7 Ahmet Sadriu, "Dituria Islame" vazhdon me hapin e kohës", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 12.
8 Bahri Simnica, "Dituria Islame" pjesë e familjes shqiptare", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 12.
9 Hysen Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", revista "Dituria Islame", nr. 300, (Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2015), 14.
10 Krasniqi, Agon. 2024. "Arsimi në Ferizaj gjatë viteve '90-të të shek. XX". Kosova 48 (48). Prishtinë, Kosovë: 201. https://doi.org/10.62609/ks.v48i48.3725.
11 Krasniqi, "Arsimi në Ferizaj gjatë viteve '90-të të shek. XX", 205.
12 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 14.
13 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 15.
14 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 14.
15 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 15.
16 Isa Memishi: "Kontributi i dr. Mehdi Polisit në revistën "Dituria Islame III", marrë nga: https://www.radiokosovaelire.com/isa-memishi-kontributi-i-dr-mehdi-polisit-ne-revisten-dituria-islame-iii/
17 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 16.
18 Matoshi, "Dimensioni kombëtar i revistës "Dituria Islame", 16.



Kriteret e paraqitjes së hoxhallarëve në emisionet televizive

Granit Sadiku

Në një kohë kur mediat shpesh e kthejnë fjalën publike në spektakël, përgjegjësia e hoxhës bëhet edhe më e madhe. Fjala e tij ka peshë, prandaj edhe vendi, mënyra dhe arsyeja e paraqitjes publike duhet të zgjidhen me kujdes. Ruajtja e integritetit është po aq e rëndësishme sa vetë mesazhi që përcillet.

Është thënë se teknologjia aktuale ka arritur ta afrojë botën, e në këtë pikë, unë do të shtoja: më tepër se ç'duhet. Për ta thënë këtë kam disa arsye. Fillimisht, konsideroj se zhvillimi teknologjik, që ka rezultuar nga zhvillimi shkencor e intelektual i disa gjeneratave, presupozon se duhet të ketë një zhvillim të përafërt edhe pala tjetër e gjeneratave që e përdor. Në të kundërtën, qasja në botën e zhvillimit teknologjik pa përgatitje intelektuale nënkupton disproporcion. E disproporcioni shkakton një lëmë prirjesh, pak a shumë si kjo që e kemi sot, ku asnjëri nuk e kupton rolin e vet në shoqëri. Ky është një problem në rritje dhe, për çudi, efekti i teknologjisë, që në kushte normale do të duhej të ishte i dobishëm për njeriun, është shndërruar në kundërefekt. Një nga hapësirat më të gjera të manipulimit të informacionit sot për sot janë mediat.

Botës mediale nuk i kanë ndryshuar vetëm mjetet e informimit, por edhe qëllimet. Nëse dikur ishte qëllim parësia dhe shpejtësia e informacionit, sot qëllimi është përhapja e dezinformatave – të cilat mjafton të tingëllojnë interesante. Dikur raportohej për një vendim apo për një ngjarje të vërtetuar nga organet e rendit, ndërsa sot raportohet lajmi vetëm duke qenë gojëdhënë. Dhe kështu, hap pas hapi, ama sigurt, mediat janë kthyer në gjykatës, policë të rendit e, pse jo, edhe në inkuizitorë. Mjafton të hidhet një akuzë ndaj dikujt dhe të shpallet nga mediat supreme si "i fajshëm". Në të njëjtën kohë, mjafton të shfaqet diku një budalla lokal dhe mediat supreme ta afirmojnë si "të rëndësishëm". Dhe njerëzit, aq tolerantë dhe aq të mësuar me këto gjykime mediale, nuk bëjnë gjë tjetër veçse dredhin kryet e dëgjojnë serinë e gjykimit final medial. Kjo situatë e hidhur na e ka kthyer botën në një sistem universal të antivlerave, ku të jesh i ditur do të thotë të jesh i prapambetur, ndërsa të jesh idiot do të thotë të jesh atraktiv dhe karizmatik. Këtë sistem vlerash e kemi krejt dhuratë nga mediat tona.

> Hap pas hapi, ama sigurt, mediat janë kthyer në gjykatës, policë të rendit e, pse jo, edhe në inkuizitorë.

Përkrah kësaj vorbulle mediatike, në popullin tonë ende vazhdon të ruhet vlera e kultivimit të fesë. Është fakt i pamohueshëm se toleranca fetare është vlerë e madhe e kombit tonë. Kjo vlerë duhet të ruhet, të kultivohet dhe t'u përcillet brezave të rinj. Toleranca fetare nuk duhet të shihet si dobësi, por si një pasuri shoqërore që duhet mbrojtur me përgjegjësi. Në asnjë rrethanë nuk duhet të lejojmë që ajo të dëmtohet nga gjuha përçarëse, paragjykimet, instrumentalizimi i fesë apo sulmet ndaj besimit dhe identitetit fetar të tjetrit. Vlerat gjithmonë atakohen nga armiqtë, andaj kjo është një mënyrë e mirë për t'i matur kësisoj. Fakti se populli ynë ka përqindjen më të madhe të besimtarëve të besimit islam domethënë se predikuesit e besimit islam kanë përgjegjësi më të madhe në ruajtjen e kësaj harmonie sesa ata të besimeve të tjera. Domethënë, po të donin myslimanët të shkaktonin përçarje në popull, askush nuk do të mund ta unifikonte atë. Arsyeja pse myslimanët janë kaq tolerantë ndaj besimeve të tjera nuk është falë leximit – fatkeqësisht –, por falë marrjes së mesazheve fetare të vazhdueshme nga hoxhallarët. Nuk thuhet kot: ashtu siç është hoxha, është edhe xhemati.

Populli ynë, ashtu siç ka bërë për shekuj me radhë, ende e ruan shenjtërinë e fjalës së hoxhës.



Hoxhallarët respektohen, çmohen e dëgjohen. Efekti i fjalëve të hoxhës në popullin tonë është shumë më i madh sesa efekti i fjalëve të të tjerëve. Andaj, hoxhallarët duhet të jenë të vetëdijshëm se fjalët e tyre ndikojnë fuqishëm në mentalitetin e popullit. Kësisoj, për një hoxhë ka shumë rëndësi mënyra se si i qaset popullit, në çfarë hapësire dhe me çfarë arsye. Në këtë plan, dua të përmend disa aspekte të rëndësishme që ndërlidhen me këto tri parime.

E para: një hoxhë duhet ta ketë të kufizuar numrin e paraqitjeve publike në medie! Dëshira për të folur publikisht është tundim që jo rrallë i kaplon hoxhallarët. Mirëpo, prononcimet publike të shpeshta e për çështje të ndryshme e zbehin seriozitetin dhe vlerën e një hoxhe. Askush nuk mund të ketë mendim për gjithçka, vetëm gjykim. E gjykimet për "çdo gjë" janë zakonisht të gabuara.

E dyta: një hoxhë duhet të zgjedhë që në emision të ketë panelistë vetëm të rangut të tij! Kriteri i vetëm për të dalë publikisht në medie sot është të jesh karizmatik – pa përfillur mënyrën se si. Të qenët karizmatik vihet re në rast të pyetjeve provokative, banale e shpesh edhe private, të cilat e bëjnë njeriun e papjekur të dalë nga vetvetja e të harrojë se është duke u paraqitur para mijëra njerëzve. Një prijës fetar – hoxhë duhet të ketë kujdes që asnjëherë të mos bjerë nën tundimin e ligë të gazetarëve/eve, të cilët e çmojnë vetëm rritjen e shikueshmërisë, por jo edhe atë të kualitetit. Andaj, kur shkoni në emisione, shkoni me kriteret tuaja dhe mos pranoni kompromise në këmbim të uljes së integritetit!

E treta: një hoxhë nuk duhet asnjëherë të shkojë në emisione "show"! Tipi i emisioneve argëtuese, që përmbajnë muzikë, lojë, aktrim, provokime e kamera të fshehura, nuk ka të bëjë asgjë me atë që duhet të predikojë një hoxhë. Kur një hoxhë zgjedh të shkojë në një emision të tillë, duhet ta pranojë se është "një ndër të ftuarit", të cilët janë aty vetëm për ta luajtur një rol të caktuar në kuadër të rritjes së shikueshmërisë së emisionit. Kohëve të fundit kemi parë disa herë akësh emisione, të cilat, me qëllimet e tyre të liga, kanë ndikuar në denigrimin e figurave të hoxhallarëve. Një udhëheqës emisioni që fton në emision një hoxhë, një anëtar nga "Lëvizja e Deçanit", një ateist, një magjistar dhe një këngëtar, përveçse është idiot për vete, nxit idiotësinë dhe përçarjen edhe në masën e gjerë. E di se disa hoxhallarë e përligjin pjesëmarrjen e tyre në këto emisione me qëllimin e tyre të mirë, por duhet të pajtohemi se qëllimi s'e arsyeton mjetin. Andaj, duhet patjetër që çdo emision "show" ta refuzoni kategorikisht, në qoftë se s'doni të përdoreni si objekt talljeje!

E katërta: fuqizojeni ndikimin e Bashkësisë Islame duke u prononcuar nëpërmjet mediumeve të saj! Duke qenë se Bashkësia Islame është institucion, ajo ka edhe hapësirën e saj mediatike. Kësisoj, prononcimet e hapura ndaj fenomeneve shoqërore apo ndaj rreziqeve që i kanosen shtetit duhet të thuhen haptazi nëpërmjet mediumeve apo platformave të BIK-ut, të cilat i plotësojnë kriteret për një transmetim të efektshëm të mesazhit fetar. Duhet të largohet energjia për debat destruktiv e të shfrytëzohet energjia për ligjërim konstruktiv. Duke iu shmangur mediumeve të kota rritet niveli i kredibilitetit dhe, duke iu referuar popullit përmes mediumeve të BIK-ut, qëndrimi i hoxhallarëve unifikohet dhe institucionalizohet.

Këto aspekte të përgjithshme që i përmendëm nuk kanë qëllime didaktike. Efekti i tyre qëndron në ngritjen e një çështjeje shqetësuese, që në këto kohë ka filluar të përhapet tej mase. Na dhemb zemra kur e shohim një imam të vlerave të larta të jetë pjesë e një emisioni të ulët, i cili ka lënduar vlerat e tij. Na dhemb zemra kur dëgjojmë të diskutohen çështje delikate fetare në emisione ku promovohet shthurja, muzika e, herë pas here, edhe imoraliteti. Mbi të gjitha, na dhemb zemra kur shohim se sot hoxhallarët ftohen në emisione të tilla jo për t'u kuptuar, por për t'u keqkuptuar. Ftohen për të dhënë deklarata, të cilat nxirren qëllimisht nga konteksti dhe bëhen shkak i urrejtjes ndërfetare në popull. Ftohen vetëm për t'u përdorur si mjet i rritjes së shikueshmërisë, e më së paku ftohen për vlerën e fjalës së tyre. Gjëja më e rëndësishme në jetë është respektimi i vetvetes. Kush e ka thënë bukur e ka thënë: Ku s'të vlerësojnë, mos rri! Hoxhallarët tanë kanë vlerë të madhe, si në kontributin fetar ashtu edhe në atë kombëtar. Hoxha i vërtetë është një margaritar që s'duhet t'i shfaqet çdokujt. Andaj, përmes këtij artikulli u drejtohem me thirrje direkte: Për hir të Zotit, mos merrni pjesë në secilin emision që ju ftojnë!



Drejt gjurmëve të dijes – studentët bursistë të BIK-ut në seminarin njëjavor në Turqi

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Çështjeve të Jashtme të DIJANET-it, u realizua një vizitë e veçantë studimore dhe kulturore në Republikën e Turqisë, me pjesëmarrjen e studentëve bursistë të Bashkësisë Islame, të cilët ndjekin studimet në Universitetin e Ez'herit në Kajro të Egjiptit dhe në Fakultetin e Fikhut Hanefi në Aman të Jordanisë.

Studentët, të udhëhequr nga kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, zhvilluan një program njëjavor me karakter edukativ, akademik, kulturor dhe shpirtëror, duke vizituar institucione të rëndësishme fetare e arsimore, universitete prestigjioze, monumente të trashëgimisë islame dhe qendra të dijes e kulturës në Stamboll dhe Bursa.

Kjo vizitë ishte më shumë se një udhëtim; ajo ishte një mundësi për të njohur nga afër historinë, qytetërimin dhe traditën e vakëfit në Turqi, si dhe për të kuptuar më thellë rolin që institucionet fetare dhe arsimore kanë luajtur ndër shekuj në ruajtjen dhe përcjelljen e dijes, kulturës dhe vlerave islame.

MIRËPRITJA DHE KËSHILLAT PËR RRUGËTIMIN E DIJES

Gjatë qëndrimit në Stamboll, studentët kosovarë u pritën nga myftiu i Stambollit, dr. Emrullah Tuncel, i cili u shprehu mirëseardhje të përzemërt dhe zhvilloi një bashkëbisedim me ta.

Në këtë takim, studentët patën mundësinë të dëgjojnë këshilla dhe porosi të rëndësishme mbi rrugëtimin e tyre akademik, profesional dhe shpirtëror. Në veçanti, u vu në pah përgjegjësia që mbart brezi i ri i dijetarëve dhe intelektualëve myslimanë, i cili nesër do të jetë në shërbim të komunitetit dhe shoqërisë.

Studentët u takuan gjithashtu me ish-kryetarin e DIJANET-it, dr. Ekrem Keleş, si dhe me drejtorin e Departamentit për Arsim dhe Kulturë të DIJANET-it, dr. Nurullah Karakaş. Përmes një seminari dhe bashkëbisedimi të hapur, studentët përfituan nga përvojat, këshillat dhe perspektivat e tyre mbi arsimin fetar, zhvillimin intelektual dhe përgjegjësinë e dijetarit në kohën bashkëkohore.

Takimet me personalitete të tilla përbënë një prej momenteve më të rëndësishme të vizitës, duke u ofruar studentëve mundësinë të shkëmbejnë mendime dhe të marrin këshilla nga njerëz me përvojë të gjatë në fushën e dijes dhe të shërbimit institucional.

MUNDËSI TË REJA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

Një prej qëllimeve të rëndësishme të kësaj vizite ishte edhe njohja e studentëve me mundësitë akademike që ofrojnë universitetet dhe institucionet arsimore të Turqisë, veçanërisht në nivelin e studimeve pasuniversitare.

Në kuadër të programit u vizituan Universiteti Marmara në Stamboll, Universiteti 29 Maji në Stamboll, Universiteti Uludağ në Bursa, si dhe Akademitë Qendrore Pasuniversitare të DIJANET-it në Stamboll dhe Bursa.

Gjatë këtyre vizitave, studentët u njohën me programet studimore, mundësitë e specializimit dhe hapësirat akademike që ofrohen për studentët ndërkombëtarë. Për të rinjtë tanë, këto takime përbëjnë një mundësi të rëndësishme për të menduar dhe planifikuar hapin e radhës në rrugëtimin e tyre akademik.





NË GJURMËT E HISTORISË SË STAMBOLLIT

Programi i vizitës përfshiu edhe monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë islame dhe kulturore të Stambollit.

Studentët vizituan Xhaminë Sulltan Ahmet, të njohur si Xhamia Blu, Ajasofjen, Xhaminë Fatih dhe Xhaminë Sulejmanije, duke pasur mundësi të njihen nga afër me veprat monumentale të arkitekturës islame dhe me historinë e qytetit që për shekuj ka qenë një prej qendrave më të rëndësishme të botës islame.

Për studentët që studiojnë shkencat islame, këto vizita nuk ishin thjesht njohje me monumente historike. Ato shërbyen si një mundësi për të parë nga afër gjurmët e një qytetërimi të ndërtuar mbi dije, vakëf, arsim, arkitekturë dhe shërbim ndaj shoqërisë.

BURSA – QYTETI I DIJES, VAKËFIT DHE TRASHËGIMISË OSMANE

Pjesë e rëndësishme e programit ishte edhe vizita në qytetin e Bursës, një prej qendrave më të rëndësishme historike, shpirtërore dhe kulturore të Turqisë.

Në Bursa, studentët kosovarë u pritën nga myftiu i Bursës, dr. Yavuz Selim Karabayır, i cili u shprehu mirëseardhje dhe zhvilloi një takim me delegacionin kosovar. Gjatë takimit, studentët u njohën me misionin e Myftinisë së Bursës, si dhe me projektet dhe aktivitetet që zhvillohen në shërbim të komunitetit.

Në ditët në vijim, studentët vizituan disa prej monumenteve më të rëndësishme të trashëgimisë islame të Bursës, ndër to Kompleksin e Ullu Xhamisë, Xhaminë e Gjelbër, Xhaminë Emir Sultan, Kompleksin Muradije, si dhe Muzeun Panorama të çlirimit të Bursës në vitin 1326.

Përmes këtyre vizitave, studentët patën mundësi të njihen nga afër me historinë e Bursës, zhvillimin e qytetërimit islam, traditën e vakëfeve dhe trashëgiminë e pasur të qytetit.

NJË PËRVOJË QË LË GJURMË

Në përfundim të vizitës, studentët kosovarë shprehën mirënjohjen e tyre për DIJANET-in dhe të gjithë organizatorët e këtij projekti për mundësinë e ofruar, për mikpritjen e jashtëzakonshme dhe për kujdesin e treguar gjatë gjithë qëndrimit të tyre në Turqi.

Ata veçanërisht vlerësuan takimet me udhëheqësit dhe përfaqësuesit e institucioneve fetare e akademike, të cilat, sipas tyre, ishin një përvojë e veçantë dhe frymëzuese që do të mbetet gjatë në kujtesën e tyre.

Një falënderim i veçantë iu shpreh DIJANET-it edhe për projektet dhe përkrahjen e vazhdueshme që ofron për studentët nga Kosova, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e tyre akademik, profesional dhe njerëzor.

Kjo vizitë dëshmoi edhe një herë se bashkëpunimi institucional në fushën e arsimit, dijes dhe kulturës është një urë e fuqishme që lidh brezat dhe shoqëritë.

Për studentët tanë, të cilët sot ndjekin studimet në qendrat më të rëndësishme të dijes islame në Kajro dhe Aman, kjo vizitë ishte një mundësi për të parë nga afër një tjetër dimension të botës së dijes islame: atë të institucioneve të zhvilluara, të traditës së vakëfit, të trashëgimisë së ruajtur dhe të investimit në brezat e rinj.

Nga Kajroja dhe Amani në Stamboll e Bursa, ky udhëtim ishte një takim i dijes me historinë, i së kaluarës me të ardhmen dhe i brezit të ri me përgjegjësinë që e pret.

Në fund të këtij rrugëtimi mbetet një mesazh i qartë: dija nuk është vetëm ajo që mësohet në libra, por edhe ajo që përjetohet, dëshmohet dhe përcillet nga një brez te tjetri.

Dhe pikërisht në këtë frymë, studentët kosovarë u kthyen nga Turqia me përvoja të reja, njohuri të çmuara dhe motivim edhe më të madh për të vazhduar rrugëtimin e tyre në shërbim të dijes, fesë dhe shoqërisë.

Mustafë Dallku

Myftiu Tërnava mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Përpjekjet e Mbretërisë së Arabisë Saudite në përballjen me devijimet e mendimit”

Më 27 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Përpjekjet e Mbretërisë së Arabisë Saudite në përballjen me devijimet e mendimit”, e cila u mbajtë në Medinë. Kjo Konferencë dyditore u organizua nga Universiteti Islamik i Medinës, teksa u hap nga emiri i Rajonit të Medinës, Princi Salman bin Sultan bin Abdulaziz.



Në këtë Konferencë morën pjesë ministra, përfaqësues të institucioneve të fetvasë dhe studiues nga e gjithë bota.

Në seancën e parë, Myftiu Tërnava theksoi se fetvatë e devijuara janë një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. Duke folur për Kosovën, ai shprehu qëndrimin e tij kundër fetvave të importuara që nuk e marrin parasysh realitetin e vendit dhe u bëri thirrje të rinjve ta marrin fenë nga dijetarë dhe institucione të besueshme.

Myftiu Tërnava është anëtar i Akademisë së Jurisprudencës Islame pranë Ligës Botërore Islame dhe për më shumë se një dekadë renditet ndër 500 personalitetet më me ndikim në botën islame.

Në këtë Konferencë, Myftiu Tërnava u shoqërua nga shefi i kabinetit, Besim ef. Mehmeti.

Myftiu Tërnava kërkoi nga Prokuroria Speciale zbardhjen e plotë të dokumentit të pretenduar si “Top Secret 2”

Më 4 shtator 2026, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, përmes përfaqësuesit ligjor të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i është drejtuar me një kërkesë zyrtare Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për zbardhjen e plotë të çështjes së dokumentit të pretenduar si “Top Secret 2”, i cili, sipas pretendimeve të bëra publike, është nxjerrë nga telefoni i të pandehurit Fatmir Sheholli.



Në kërkesën zyrtare drejtuar kryeprokurorit të Shtetit, z. Blerim Isufaj, thuhet:

“Në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), përmes kësaj kërkese zyrtare, kërkojmë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës zbardhjen e plotë të çështjes së dokumentit të pretenduar si “Top Secret”, përfshirë origjinën, autenticitetin, mënyrën e sigurimit dhe publikimit të tij, si dhe rrethanat e nxjerrjes së pretenduar nga telefoni i të pandehurit Fatmir Sheholli.”

Më tej, në kërkesën e Myftiut të Kosovës thuhet se përmbajtja e këtij dokumenti dhe pretendimet e shfaqura në hapësirën publike e paraqesin Bashkësinë Islame të Kosovës në një dritë të rreme, duke e cilësuar atë gjoja si një institucion nën ndikimin e shërbimeve të huaja të sigurisë, ndërsa xhamitë dhe medresetë si institucione të financuara për qëllime destabilizuese.

“Këto janë akuza jashtëzakonisht të rënda dhe të papranueshme, të cilat cenojnë rëndë integritetin, kredibilitetin dhe dinjitetin e institucionit tonë, të imamëve, teologëve dhe besimtarëve tanë”, thuhet në kërkesë.

Andaj, me qëllim të njohjes së plotë të së vërtetës, eliminimit të çdo dyshimi dhe sqarimit të të gjitha rrethanave që lidhen me këtë çështje, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës kërkon nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbardhjen e plotë të origjinës, autenticitetit dhe përmbajtjes së dokumentit të pretenduar si “Top Secret”, si dhe të mënyrës së sigurimit dhe publikimit të tij.

Myftiu Tërnava priti në takim drejtorin e Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Katarit, Muhamed al Menai

Më 7 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, priti në takim drejtorin e Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Shtetit të Katarit, Muhamed al Menai.



Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnava e njohu mysafirin me punën, aktivitetet dhe angazhimin e vazhdueshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës në shërbim të besimtarëve dhe shoqërisë kosovare. Prezantimi ofroi një pasqyrë më të gjerë të veprimtarisë së këtij institucioni dhe të përkushtimit të tij për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit.

Me këtë rast, Myftiu Tërnava, përmes z. Muhamed al Menai, shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e tij për Shtetin e Katarit dhe institucionet e tij për kontributin e vazhdueshëm që kanë dhënë për Kosovën në përgjithësi dhe për Bashkësinë Islame të Kosovës në veçanti.

Në takim u vlerësuan lart bashkëpunimi dhe mbështetja ndërmjet institucioneve, si dhe u shpreh gatishmëria për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Ky vlerësim i ndërsjellë përbën një bazë të rëndësishme për forcimin e lidhjeve institucionale, ruajtjen e komunikimit dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet palëve.

Nga ana e tij, drejtori Al Menai falënderoi Myftiun Tërnava për pritjen dhe për gatishmërinë e institucionit që ai drejton për bashkëpunim me Shtetin e Katarit.

Vizita në Shoqatën Humanitare Bamirëse "Bereqeti"



Gjatë qëndrimit në Kosovë, më 7 shtator 2026, drejtori i Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Shtetit të Katarit, Muhamed al Menai, së bashku me delegacionin shoqërues, vizitoi Shoqatën Humanitare Bamirëse "Bereqeti". Në këtë vizitë, delegacioni u shoqërua nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë vizitës, drejtori Muhamed al Menai u njoh nga afër me punën dhe angazhimin humanitar të Shoqatës "Bereqeti", si dhe me aktivitetet e saj në mbështetje të familjeve në nevojë dhe kategorive të ndryshme të shoqërisë. Ai gjithashtu u njoh me kontributin e "Bereqetit" në fushën e humanizmit dhe solidaritetit shoqëror, duke vlerësuar rëndësinë e këtyre aktiviteteve në shërbim të qytetarëve. Një veprimtari e tillë, krahas ndihmës konkrete, përcjell mesazhin e përkujdesjes për dinjitetin njerëzor dhe të përgjegjësisë së përbashkët ndaj atyre që përballen me vështirësi.

Kujtojmë se objekti i Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti" është ndërtuar dhe financuar nga Shteti i Katarit, si një nga kontributet e rëndësishme të këtij shteti në mbështetje të punës dhe veprimtarisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të qytetarëve të Kosovës. Kjo mbështetje krijon kushte më të mira për zhvillimin e veprimtarisë humanitare dhe përmbushjen e misionit të shoqatës në shërbim të komunitetit.

Vizita në Këshillin e Bashkësisë Islame të Malishevës



Më 7 shtator 2026, drejtori i Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Shtetit të Katarit, Muhamed al Menai së bashku me delegacionin e tij shoqërues, i shoqëruar edhe nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnava dhe bashkëpunëtorët e tij vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Malishevës, ku u prit në takim nga kryetari i Këshillit, Sead ef. Paqarizi.

Kryetari Paqarizi fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me punën dhe aktivitetet e Këshillit, si dhe me angazhimin e tij në shërbim të besimtarëve dhe komunitetit. Ai me këtë rast i njohu mysafirët edhe me projektin e Xhamisë së Gurit në Malishevë, duke prezantuar rëndësinë e këtij projekti dhe ecurinë e realizimit të tij.

Inaugurohet objekti i ri i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan

Më 8 shtator 2026, është inauguruar objekti i ri i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, një investim i rëndësishëm i financuar nga Shteti i Katarit, i cili synon të krijojë kushte më të mira për zhvillimin dhe organizimin e veprimtarisë fetare, arsimore, kulturore dhe shoqërore në këtë qytet.



Në ceremoninë solemne të inaugurimit morën pjesë drejtues të Bashkësisë Islame të Kosovës, përfaqësues të institucioneve lokale të Gjilanit, zyrtarë të Shtetit të Katarit, si dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, vlerësoi rëndësinë e këtij projekti, duke theksuar se veprimtaria e Bashkësisë Islame të Kosovës nuk kufizohet vetëm në hapësirat e xhamive, por shtrihet në të gjitha fushat në të cilat kontribuohet për të mirën e besimtarëve dhe të shoqërisë.

"Bashkësia Islame e Kosovës nuk është e mbyllur vetëm brenda mureve të xhamisë, por është aktive në të gjitha sferat e jetës, ashtu siç na mëson feja dhe atdheu ynë. Objekte si ky janë dëshmi e këtij përkushtimi, sepse në to kultivohet feja, mësohet Islami dhe kultivohet dashuria për atdheun", tha Myftiu Tërnava.

Ai shprehu mirënjohjen për Shtetin e Katarit për mbështetjen e vazhdueshme ndaj projekteve të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar se investime të tilla përbëjnë një kontribut të drejtpërdrejtë në forcimin e jetës fetare dhe në krijimin e hapësirave të përshtatshme për shërbimin ndaj komunitetit.

Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim ef. Aliu, tha se objekti i ri do të jetë në shërbim të Këshillit dhe të gjithë besimtarëve të Gjilanit. Ai theksoi se ky objekt përbën një investim afatgjatë, i cili do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve dhe shërbimeve të Këshillit në fusha të ndryshme.

Sipas tij, hapësirat e reja do të krijojnë kushte më të mira për zhvillimin e jetës fetare, kulturore, arsimore dhe shoqërore, duke i shërbyer jo vetëm strukturave të Këshillit, por edhe komunitetit të gjerë të besimtarëve.

Rëndësinë e këtij investimi e vlerësuan edhe drejtuesit e Komunës së Gjilanit. Kryetari i Gjilanit z. Alban Hyseni, theksoi se puna dhe angazhimi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan kanë qenë të vazhdueshme dhe se një objekt i tillë do t'u shërbejë shumë qytetarëve.

"E dimë punën dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Në veçanti, në rolin prej kryetarit që jam tash, e shoh që kjo punë e heshtur, por shumë e madhe e KBI-së në Gjilan, ka pasur nevojë për një objekt të tillë, ku do të përfitojnë të gjithë besimtarët", tha kryetari Hyseni.

Në ceremoninë e inaugurimit ishte i pranishëm edhe ambasadori i Shtetit të Katarit në Tiranë, z. Jabor Ali Hussein al Hawashela al Dosari, i cili shprehu kënaqësinë që ndodhej në Gjilan në një ditë të rëndësishme për inaugurimin e këtij vakëfi. Ai theksoi se objekti do të mundësojë zhvillimin e aktiviteteve të shumta me karakter social dhe në fusha të tjera, duke vlerësuar se projekte të tilla i japin një dimension të ri bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Katarit.

"Ky projekt në vete bart aktivitete të shumta, si sociale, ashtu edhe shumë mundësi të tjera. Padyshim se bashkëpunime të tilla e forcojnë edhe më shumë bashkëpunimin mes dy vendeve", tha ambasadori i Katarit.

Ndërkaq, Muhamed al Menai, drejtor i Çështjeve Fetare në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare Islame të Shtetit të Katarit, e vlerësoi objektin si një nga projektet e rëndësishme të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Ai bëri të ditur se objekti i ri është katërkatësh, me një sipërfaqe prej mbi 5 mijë metrash katrorë dhe me një vlerë investimi prej më shumë se 2 milionë eurosh.



"Bëhet fjalë për një objekt katërkatësh, me mbi 5 mijë metra katrorë dhe me vlerë mbi 2 milionë euro", tha al Menai.

Inaugurimi i këtij objekti shënon një hap të rëndësishëm për Këshillin e Bashkësisë Islame në Gjilan, duke i ofruar atij një hapësirë moderne dhe funksionale për ushtrimin e veprimtarisë së tij dhe për ofrimin e shërbimeve për besimtarët.

Ky investim njëherësh dëshmon edhe për vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të Shtetit të Katarit, bashkëpunim i cili ndër vite ka sjellë projekte të rëndësishme në shërbim të komunitetit mysliman në Kosovë.

Myftiu Tërnava priti në takim z. Rashid el Axhmi nga Shoqata "Joud" e Kuvajtit

Më 7 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim një delegacion të Shoqatës "Joud" nga Kuvajti, të kryesuar nga dr. Rashid el Axhmi.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnava u shprehu mirëseardhje mysafirëve nga Kuvajti dhe vlerësoi lart bashkëpunimin dhe kontributin e organizatave humanitare në mbështetje të besimtarëve myslimanë në Kosovë.

Në takim u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Shoqatës "Joud", si dhe për mundësitë e realizimit të projekteve të përbashkëta në fushën humanitare, sociale dhe fetare.

Myftiu Tërnava falënderoi dr. Rashid el Axhmin dhe Shoqatën "Joud" për angazhimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar rëndësinë e forcimit të



mëtejshëm të bashkëpunimit dhe të projekteve në shërbim të qytetarëve dhe komunitetit.

Nga ana e tij, dr. Rashid el Axhmi shprehu falënderimet e tij për mikpritjen, si dhe më pas konfirmoi gatishmërinë e Shoqatës "Joud" për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnava priti në takim përfaqësuesit e "Liria ka emër"

Më 9 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim përfaqësuesit e organizatës "Liria ka emër", të kryesuar nga deputetja e Kuvendit të Kosovës, znj. Eliza Hoxha.



Gjatë këtij takimi u bisedua për marshin e 12 shtatorit në Prishtinë, në mbështetje të ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët po mbahen në paraburgim në Hagë.

Përfaqësuesit e "Liria ka emër" e njohën Myftiun Tërnava lidhur me organizimin dhe qëllimin e këtij marshi, i cili synon të përcjellë mesazhin e mbështetjes dhe solidaritetit me ish-pjesëtarët e UÇK-së dhe familjet e tyre.

Myftiu Tërnava shprehu mbështetjen e tij për këtë nismë dhe ofroi përkrahjen e nevojshme për mbarëvajtjen e marshit, duke theksuar rëndësinë e solidaritetit dhe të unitetit qytetar në mbështetje të vlerave të luftës së UÇK-së.

Myftiu Tërnava priti në takim imamin Jusuf ef. Bolajn

Më 9 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim imamin e njohur të komunitetit shqiptar në Qendrën Shqiptare Islame në Queens të Nju Jorkut, Jusuf ef. Bolajn, i cili shoqërohej nga imami nga Ulqini, Rifat ef. Jusufi.



Myftiu Tërnava e falënderoi për vizitën dhe çmoi lart kontributin e imamit Jusuf ef. Bolajt në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe traditave tona në komunitetin shqiptar në ShBA.

Ndërsa imami Jusuf ef. Bolaj shprehu kënaqësinë e tij që, pas një kohe të gjatë, ndodhet sërish në Prishtinë dhe pati mundësinë të informohet nga afër për zhvillimet dhe të arriturat në Kosovë, veçanërisht për zhvillimet në Medresenë ku u arsimua.

Të dy imamët e nderuar janë me origjinë nga trevat e Krajës dhe të dy janë ish-nxënës të Medresesë "Alauddin", në breza të ndryshëm.

Myftiu Tërnava pa nga afër punimet në ndërtimin e Këshillit në Mitrovicë dhe xhamisë "Haxhi Veseli"

Më 10 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, Fatmir ef. Iljazi, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Mitrovicës, ku u prit nga administrata dhe stafi i tij.



Gjatë vizitës, Myftiu Tërnava u njoh nga afër me aktivitetet dhe angazhimet e Këshillit, si dhe me punën për realizimin e projekteve të rëndësishme për komunitetin mysliman të kësaj ane.

Ai pa nga afër punimet për ndërtimin e objektit të ri të Këshillit dhe të xhamisë "Haxhi Veseli", duke u njohur me ecurinë dhe dinamikën e realizimit të këtyre projekteve. Myftiu Tërnava shprehu kënaqësinë për punën e deritanishme dhe ecurinë e punimeve, duke vlerësuar angazhimin e të gjithë atyre që po kontribuojnë në këto projekte. Ai theksoi rëndësinë e këtyre objekteve për zhvillimin e jetës fetare dhe të shërbimeve të Këshillit të Bashkësisë Islame në Mitrovicë. Në përfundim, Myftiu Tërnava u shprehu përfaqësuesve të Këshillit mbështetjen e tij për vazhdimin e punës dhe realizimin me sukses të projekteve të nisura.

Në të gjitha xhamitë e Kosovës u bë thirrje për pjesëmarrje në marshin e 12 shtatorit

Më 11 shtator 2026, me rekomandim të kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnava, në të gjitha xhamitë e Kosovës, në hytben e xhumasë, u bë thirrje për pjesëmarrje në marshin e 12 shtatorit në Prishtinë, në përkrahje të ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po mbahen në Hagë.



Myftiu Tërnava, duke shprehur përkrahjen e tij për këtë nismë, ka rekomanduar që besimtarët të marrin pjesë në marshin e organizuar në shenjë solidariteti dhe përkrahjeje për ish-ushtarët e UÇK-së.

"Ky është një tubim qytetar në mbështetje të lirisë, drejtësisë, dinjitetit dhe kujtesës sonë kombëtare, si dhe në përkrahje të ish-krerëve të UÇK-së. Le të jemi të bashkuar, të qetë dhe dinjitozë. Le ta dëshmojmë se nuk harrojmë sakrificën e atyre që kontribuuan për lirinë e Kosovës dhe se kërkesa jonë është drejtësia dhe trajtimi i drejtë" – u tha ndër të tjera në mesazhin e hytbes së xhumasë.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt

Më 15 shtator 2026, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e saj të rregullt të cilën e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnava.



Gjatë kësaj mbledhje Kryesia diskutoi për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare në Kosovë, për të cilën anëtarët e Kryesisë u njohën nga Myftiu Tërnava.

Në rend dite diskutimi Kryesia pati edhe fillimin e vitit të ri shkollor 2026-2027 në Medresenë "Alauddin", si dhe për fillimin e vitit të ri akademik 2026-2027 në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Në këtë mbledhje u diskutuan edhe pika të tjera të rëndësishme dhe u morën vendime në bazë të kompetencave të Kryesisë.

Kryesia e BIK-u merr vendim që të gjitha institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës të stolisen me flamurin e UÇK-së

Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më 15 shtator 2026, ka marrë vendim që të gjitha institucionet e Bashkësisë Islame të stolisen me flamurin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në prag të shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Me këtë vendim, në objektet e xhamive dhe mesxhideve, përveç hapësirave të rregullta, flamuri i UÇK-së do të vendoset edhe në minaret e tyre.

Në vendim thuhet se ky veprim shërben si shenjë organizimi, solidariteti dhe nderimi për luftën e drejtë të UÇK-së, duke iu bashkuar urimit dhe shpresës që të gjithë të akuzuarit të lirohen nga aktakuzat e ngritura ndaj tyre dhe të shpallen të pafajshëm. Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar të gjitha Këshillat e Bashkësisë Islame, drejtuesit e institucioneve arsimore, si dhe imamët dhe nëpunësit e xhamive në mbarë vendin. Vendimi, i nënshkruar nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, hyn në fuqi menjëherë.



Qendra e Mbretit Salman për Ndihmë nënshkroi programin ekzekutiv të përbashkët për kujdesin ndaj jetimëve me BIK-un



Më 20 shtator 2026, Qendra e Mbretit Salman për Ndihmë dhe Punë Humanitare nënshkroi një program ekzekutiv të përbashkët me Bashkësinë Islame të Kosovës, për zbatimin e projektit të kujdesit ndaj jetimëve në të gjitha komunat e Kosovës për vitin 2026, nga i cili do të përfitojnë 700 jetimë.

Programin e nënshkroi së pari ndihmësmbikëqyrësi i përgjithshëm i Qendrës për operacione dhe programe, inxhinier Ahmed bin Ali al Baiz, ndërsa pas tij nënshkroi Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, në cilësinë e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Menaxheri i projektit, Besim Mehmeti, njëherësh shefi i kabinetit, njoftoi për ecurinë e deritanishme të programit dhe detajet e zbatimit të tij, duke theksuar se struktura e ndihmës do të përfshijë shpërndarjen e kujdestarive mujore për familjet e jetimëve, organizimin e udhëtimeve argëtuese, si dhe sigurimin e çantave shkollore dhe veshjeve dimërore për fëmijët përfitues në të gjitha komunat e përfshira në projekt.

Gjithashtu, ai njoftoi se numri i jetimëve përfitues ka njohur rritje të vazhdueshme: nga rreth 500 jetimë të mbështetur në periudhën 2024–2025, projekti pritet të arrijë tani në 700 përfitues për vitin 2026, një shtim që reflekton zgjerimin e vazhdueshëm të mbulimit dhe rritjen e mbështetjes financiare të siguruar nga Qendra e Mbretit Salman.

Kjo vjen në kuadër të përpjekjeve humanitare dhe të ndihmës që ofron Mbretëria e Arabisë Saudite përmes krahut të saj humanitar, Qendrës së Mbretit Salman për Ndihmë, në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnava mori pjesë në festimin e Ditës Kombëtare të Mbretërisë së Arabisë Saudite

Më 23 shtator 2026, me ftesë të ambasadorit të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, z. Turki bin Ibrahim al Madi, Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga sekretari i Përgjithshëm i BIK-ut, Fatmir ef. Iljazi, dhe shefi i kabinetit, Besim ef. Mehmeti, mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e Ditës Kombëtare të Arabisë Saudite, e cila u mbajt në Tiranë, ku i ftuar nderi ishte presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bajram Begaj.

Në pritje morën pjesë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të qeverisë, zyrtarë të lartë të institucioneve shtetërore, personalitete të njohura të botës akademike e universitare, ambasadorë dhe drejtues të misioneve diplomatike të akreditуara në Tiranë, si dhe shkrimtarë, artistë, drejtues të komuniteteve fetare dhe përfaqësues të mediave.



Në Gjilan u mbajt Simpoziumi shkencor “Muhamedi a.s. në kujtesën dhe traditën shqiptare”

Më 23 shtator 2026, në kuadër të manifestimit të Muajit të Mevludit, në Gjilan u organizua simpoziumi shkencor “Muhamedi a.s. në kujtesën dhe traditën shqiptare”, me temë boshte “Mesazhi profetik, trashëgimia dhe aktualiteti”.

Në këtë aktivitet morën pjesë studiues, profesorë, dijetarë dhe njohës të fushave të ndryshme të fesë, historisë, letërsisë dhe kulturës, ndërsa përmes katër seancave shkencore u prezantuan gjithsej 27 referate kushtuar jetës, misionit dhe trashëgimisë së Pejgamberit Muhamed a.s.

Simpoziumi trajtoi aspekte të ndryshme të figurës së Muhamedit a.s., nga jeta dhe misioni i tij profetik, ndikimi i mësimeve të tij në jetën fetare e shoqërore, deri te mënyra se si dashuria dhe tradita profetike janë ruajtur e përcjellë ndër shqiptarë.

Në hapje të simpoziumit u theksua rëndësia e studimit të kësaj figure jo vetëm në kontekstin historik, por edhe në raport me vlerat që vazhdojnë të kenë aktualitet në shoqërinë bashkëkohore.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, theksoi se personaliteti i Muhamedit a.s. nuk ka mbetur vetëm një figurë e largët historike islame, por është bërë pjesë e rëndësishme e jetës shpirtërore të besimtarëve.

Myftiu Tërnava tha se për shekuj me radhë emri i Muhamedit a.s. është përcjellë brez pas brezi përmes familjes, xhamisë, medresesë, letërsisë dhe traditës gojore. Për besimtarin shqiptar, ai nuk përfaqëson vetëm një mesazh fetar, por edhe një model përmes të cilit besimi shndërrohet në moral, dija në përgjegjësi dhe drejtësia në parim.

Ndërsa, Naim ef. Aliu, kryetar i Këshillit të BI-së së Gjilanit, tha se një nga qëllimet kryesore të simpoziumit ishte të trajtohej raporti i shqiptarëve me të Dërguarin dhe trashëgiminë e tij. Në fokus, sipas tij, ishte mënyra se si është ruajtur kjo trashëgimi, si është përcjellë dashuria për Muhamedin a.s. dhe çfarë ndikimi ka pasur ajo në formësimin fetar, moral dhe kulturor të shqiptarëve.



Edhe kryetari i Gjilanit, z. Alban Hyseni, e vlerësoi studimin e jetës dhe veprës së Muhamedit a.s. si një mundësi për të reflektuar mbi vlerat e përcjella përmes mësimeve të tij. Ai theksoi rëndësinë e mbështetjes së dijes, arsimit, kulturës dhe trashëgimisë si përgjegjësi ndaj brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

Në katër seancat e simpoziumit u prezantuan gjithsej 27 referate, të cilat trajtuan një gamë të gjerë temash.

Në referatet e tyre, studiuesit u ndalën në vazhdimësinë e figurës së Muhamedit a.s. edhe pas më shumë se 14 shekujsh, në dimensionin historik dhe tejhistorik të misionit të tij, si dhe në vlerat e paqes, mëshirës, dialogut, bashkëjetesës dhe etikës që burojnë nga mësimet profetike.

Një pjesë e rëndësishme e punimeve u përqendrua në mënyrën se si trashëgimia profetike është ruajtur në hapësirën shqiptare. U trajtuan dorëshkrimet, përkthimet, veprat letrare, mevludet dhe tradita gojore, përmes të cilave është shprehur dhe përcjellë dashuria për Muhamedin a.s. Në këtë kuadër u trajtua edhe tradita e Mevludit ndër shqiptarët, veçoritë letrare dhe poetike të veprave të autorëve shqiptarë, si dhe ndikimi i tyre në ruajtjen e kujtesës dhe traditës profetike.

Referuesit u ndalën gjithashtu në ndikimin e mësimeve të Muhamedit a.s. në edukimin e familjes dhe rinisë, respektin ndaj prindërve, komunikimin me fëmijët, etikën mediatike, lirinë e shprehjes dhe ndjeshmërinë religjioze.

Një tjetër dimension i rëndësishëm ishte diaspora shqiptare, me referate që trajtuan ruajtjen e trashëgimisë profetike, identitetin fetar e kulturor dhe rolin e institucioneve e manifestimeve të Mevludit në komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Në përfundim, simpoziumi solli në një vend qasje historike, fetare, letrare, kulturore dhe shoqërore mbi figurën e Muhamedit a.s., duke e trajtuar trashëgiminë e tij si pjesë të rëndësishme të historisë dhe kulturës shpirtërore të shqiptarëve.

Simpoziumi u përmbyll pas një dite të plotë me referime dhe diskutime, në kuadër të aktiviteteve të Muajit të Mevludit, duke vënë në fokus lidhjen ndërmjet mesazhit profetik, trashëgimisë së ruajtur ndër breza dhe aktualitetit të saj në jetën e shqiptarëve.



Myftiu Tërnava priti në takim delegacionin e "Qatar Charity" nga Katari

Më 24 shtator 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur në takim delegacionin e "Qatar Charity" nga Katari, të kryesuar nga Ahmad al Amadi.



Në takim u diskutua për bashkëpunimin mes Bashkësisë Islame të Kosovës dhe "Qatar Charity", si dhe për projektet e përbashkëta të realizuara dhe ato që janë në proces. Myftiu Tërnava dhe mysafiri nga Katari diskutuan edhe për nisma të reja që synohet të realizohen në të ardhmen. Vëmendje të veçantë mori edhe projekti i ndërtimit të xhamisë në qendër të Lipjanit, i cili u vlerësua si i rëndësishëm për besimtarët myslimanë të këtij qyteti.

Në përfundim, Myftiu Tërnava dhe kryesuesi i delegacionit të "Qatar Charity", Ahmad al Amadi, shprehën gatishmërinë për ta thelluar edhe më tej bashkëpunimin, përmes projekteve të reja në fusha të ndryshme.

Në Lipjan u përurua Xhamia e Re

Më 24 shtator 2026, në Lipjan u përurua Xhamia e Re, ndërtimi i së cilës u realizua me mbështetjen financiare të shtetit të Katarit. Hapja e saj shënon realizimin e një kërkese të kamotshme të besimtarëve të kësaj komune dhe zgjerimin e infrastrukturës fetare në këtë komunë.



Ceremonia solemne e përurimit u zhvillua në praninë e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnava, përfaqësuesve të shtetit të Katarit, përfaqësuesve të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, Komunës së Lipjanit, Policisë së Kosovës, deputetëve, përfaqësuesve të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, shoqatave të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, si dhe qindra besimtarëve.

Në fjalën e tij, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnava, vuri në pah rëndësinë e lirisë, sakrificën e dëshmorëve dhe mundësinë që populli i Kosovës, në vendin e vet, të ndërtojë institucione fetare, arsimore e shëndetësore. Ai theksoi se liria e fituar me sakrificë përbën një përgjegjësi të përbashkët për ruajtjen dhe zhvillimin e vendit.

"Falë gjakut të derdhur për liri të bijve dhe bijave tona, të dëshmorëve tanë, të cilët e ujitën këtë tokë pëllëmbë pas pëllëmbe me gjakun e tyre të njomë, sot kemi mundësi të ndërtojmë xhami, edhe shkolla, edhe kisha për vëllezërit tanë të fesë tjetër. Kemi mundësi të ndërtojmë edhe spitale, kemi mundësi të bëjmë gjithçka që dëshirojmë si popull, sepse jemi në vendin tonë. Dëshirë e Zotit ka qenë dhe është që ne të jetojmë në këtë vend. Jemi banorë të këtyre trojeve, andaj nuk kemi vatan tjetër. Ky është vatani ynë dhe këtë duhet ta ruajmë", u shpreh ndër të tjera Myftiu Tërnava, duke vlerësuar edhe kontributin e imamëve dhe hoxhallarëve gjatë luftës.

Përfaqësuesi i shtetit të Katarit, Ahmad al Amadi, shprehu lutjen që Allahu i Madhërishëm ta pranojë këtë kontribut dhe xhaminë ta bëjë qendër të mirësisë e bujarisë.

"E lusim Allahun xh.sh. që t'i pranojë këto vepra dhe ta bëjë këtë qendër të mirësisë dhe bujarisë", tha Al Amadi.

Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Bashkësisë Islame të Kosovës u vlerësua edhe nga përfaqësuesit komunalë dhe ata të subjekteve politike, të cilët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit institucional në realizimin e projekteve me interes për qytetarët dhe komunitetin fetar.

Në anën tjetër kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, Zaim ef. Baftiu, shprehu mirënjohje për të gjithë ata që kontribuuan në realizimin e projektit, duke vënë në pah kapacitetin dhe funksionalitetin e objektit të ri.

"Kjo xhami, me kapacitetin që ka, arrin të jetë ndër xhamitë me kapacitetin më të madh për namazfalës në Kosovë. Ajo i bashkëngjitet vargut të xhamive të tjera, ndërsa hapësirat administrative dhe sallat e bëjnë këtë objekt një qendër kulturore islame, krahas funksionit të tij si xhami", tha Baftiu.

Me përurimin e Xhamisë së Re, Lipjani pasurohet me një objekt të rëndësishëm të infrastrukturës fetare, i cili, përveç shërbimeve të adhurimit, ofron edhe hapësira për veprimtari administrative e kulturore islame. Kjo është xhamia e 36-të e ndërtuar në komunën e Lipjanit pas vitit 2000.

Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së BIK-ut, Fatmir ef. Iljazi takoi sekretarët e Këshillave të BI-së



Më 28 shtator 2026, sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Fatmir ef. Iljazi, ka mbajtur një takim me sekretarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Takimi i mbajtur në selinë e Kryesisë së BIK-ut ishte takimi i parë njoftues dhe informues me sekretarët e Këshillave, pas marrjes së detyrës së sekretarit të përgjithshëm nga Fatmir ef. Iljazi.

Në fillim të takimit, sekretari Iljazi falënderoi sekretarët për punën dhe angazhimin e tyre në Këshillat e Bashkësisë Islame ku veprojnë, duke vlerësuar kontributin e tyre në mbarëvajtjen e veprimtarisë së Këshillave dhe duke kërkuar që ky angazhim të intensifikohet edhe më tej.

Qëllimi i takimit ishte njohja më e afërt me përgjegjësit dhe sekretarët e Këshillave, si dhe diskutimi i çështjeve që lidhen me punën dhe funksionimin e tyre.

Gjatë takimit u diskutua për rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarëve të Këshillave të Bashkësisë Islame, me theks të veçantë në rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Kryesisë së BIK-ut dhe Këshillave të Bashkësisë Islame.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua edhe problemeve dhe sfidave me të cilat përballen Këshillat e Bashkësisë Islame në punën e tyre të përditshme.

Në takim u theksua rëndësia e komunikimit të vazhdueshëm, koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet sekretarëve të Këshillave dhe Kryesisë së BIK-ut, me qëllim të avancimit të punës dhe përmbushjes së përgjegjësive institucionale.

Shtëpia Botuese "Dituria Islame" pjesëmarrëse në Samitin Ndërkombëtar të Botuesve Islamë të mbajtur në Stamboll



Në Stamboll u mbajt Samiti Ndërkombëtar i Botuesve Islamë, një ngjarje ndërkombëtare që mblodhi përfaqësues të botimeve islame nga 67 shtete, me synim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e sfidave dhe mundësive që po sjellin zhvillimet e reja në fushën e botimeve.

Aktiviteti u zhvillua më 25-27 shtator, në Universitetin Istanbul Sabahattin Zaim, nën organizimin e Unionit Ndërkombëtar të Botuesve Islamë, me mbështetjen e institucioneve turke, ndër të cilat DIJANET-i, Ministria e Kulturës dhe Turizmit dhe TIKA. Në këtë takim morën pjesë më shumë se 250 përfaqësues, duke e shndërruar Stambollin në një pikëtakim të rëndësishëm për botues, studiues dhe përfaqësues institucionesh të lidhura me fushën e botimeve islame.

Në këtë ngjarje ndërkombëtare dhe në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Unionit Ndërkombëtar të Botuesve Islamë mori pjesë edhe Shtëpia Botuese "Dituria Islame" nga Prishtina, si përfaqësuesja e vetme nga Kosova. "Dituria Islame" u përfaqësua nga drejtori Ramadan Shkodra, së bashku me z. Tanseli Rogova dhe dr. Besir Neziri. Pjesëmarrja në këtë forum ndërkombëtar përbënte një mundësi të rëndësishme për prezantimin e veprimtarisë së botimeve islame në Kosovë, si dhe për krijimin e kontakteve të reja dhe vendosjen e bashkëpunimeve me shtëpi botuese dhe përfaqësues të botimeve nga vende të ndryshme.

Një nga momentet e rëndësishme të takimit ishte Asambleja e Përgjithshme e Unionit Ndërkombëtar të Botuesve Islamë, ku u zhvilluan punimet për aktivitetet e Unionit, objektivat dhe planet për të ardhmen. Gjatë Asamblesë u zhvilluan edhe procedurat për zgjedhjen e Këshillit Drejtues, kryetarit të Këshillit dhe Këshillit Mbikëqyrës të Unionit, duke përcaktuar kështu strukturat e tij drejtuese për periudhën e ardhshme.

Gjatë tri ditëve të samitit u zhvilluan diskutime të shumta mbi çështjet më të rëndësishme që lidhen me të ardhmen e botimeve islame. Në fokus ishin bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet botuesve, të drejtat e autorit, përkthimet, botimet digjitale, zhvillimi i inteligjencës artificiale, ruajtja e trashëgimisë.

Drejtori për Diasporë në BIK, Ekrem ef. Simnica zhvilloi aktivitete dhe takime me komunitetin shqiptar në Gjermani

Më 25 dhe 26 shtator 2026, në kuadër të angazhimeve për forcimin e bashkëpunimit me qendrat islame shqiptare në diasporë, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, zhvilloi një vizitë në Gjermani, ku mori pjesë në aktivitete fetare, kulturore dhe edukative të komunitetit shqiptar.



Gjatë vizitës në Qendrën Islame Shqiptare Sindelfingen – Böblingen, drejtori Simnica fali namazin e xhumasë dhe mbajti hytben para xhematit. Në fjalën e tij, ai përshëndeti të gjithë të pranishmit, duke përcjellë përshëndetjet dhe falënderimet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Myftiut Naim ef. Tërnava.

Drejtori Simnica vlerësoi kontributin e mërgatës shqiptare dhe rolin e xhamive dhe qendrave islame në diasporë, jo vetëm si hapësira të adhurimit, por edhe si qendra të edukimit, organizimit dhe bashkimit të komunitetit. Në këtë kuadër, ai i njohu të pranishmit edhe me veprimtarinë e institucioneve edukativo-arsimore të BIK-ut, si dhe me aktivitetet humanitare të Shoqatës "Bereqeti".

Gjatë takimit u diskutua për jetën fetare të bashkatdhetarëve në diasporë, aktivitetet e xhamive dhe qendrave islame, sfidat me të cilat përballet komuniteti, si dhe rëndësia e ruajtjes dhe përcjelljes së vlerave fetare e kombëtare te brezat e rinj.

Në kuadër të vizitës, më 26 shtator, drejtori për Diasporë mori pjesë edhe në promovimin e dy librave të hoxhë Rexhep ef. Sulejmanit, "Të mësojmë Islamin – Rruga e besimit" dhe "Den Islam verstehen – Der Weg des Glaubens", të botuara përkatësisht në gjuhën shqipe dhe gjermane. Promovimi u mbajt në Qendrën Islame Shqiptare në Stuttgart, në praninë e kryetarit të Unionit të Qendrave Islame të Gjermanisë, Mensur ef. Alili, kryeredaktorit të librit, prof. dr. Musa Musai, përfaqësuesve të bashkësive islame nga vendlindja, hoxhallarëve që veprojnë në Gjermani dhe një numri të madh besimtarësh.

Drejtori Simnica theksoi rëndësinë e literaturës fetare në gjuhën shqipe dhe gjermane, veçanërisht për edukimin fetar të brezave të rinj në diasporë.

Drejtori Simnica vizitoi Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Stuttgart të Gjermanisë

Më 28 shtator 2026, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga kryetari i Qendrës Islame Shqiptare të Stuttgartit, Driton ef. Morina, vizitoi Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, ku u prit nga udhëheqësi i konsullatës, z. Hamdi Berbatovci.



Gjatë takimit, Ekrem ef. Simnica falënderoi z. Berbatovci për pritjen dhe përcolli përshëndetjet e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnava. Ai e përgëzoi për punën dhe bashkëpunimin me qendrat islame shqiptare në Gjermani, duke i uruar suksese dhe mbarësi në angazhimet e tij.

Nga ana e tij, z. Hamdi Berbatovci i uroi mirëseardhje drejtorit Simnica dhe e njohu me punën dhe angazhimet e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stuttgart.

Gjatë bashkëbisedimit u theksua rëndësia e vazhdimit dhe forcimit të koordinimit ndërmjet konsullatës dhe qendrave islame shqiptare në Gjermani, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve dhe avancimit të bashkëpunimit në shërbim të komunitetit shqiptar.

SIMPOZIUM SHKENCOR

MUHAMEDI a.s.
në kujtesën dhe traditën shqiptare

Mesazhi profetik, trashëgimia dhe aktualiteti

Gjilan, 23 shtator 2026

















